

Betim  
Muço

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

SH-32

17198

SKICA E TREGIME

EKSPRES

814-52

14198

BETIM MUÇO

# EKSPRES

— Skica e tregime —



20/5

SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## SHËRBIMI NË N.

Shiu derdhej mbi pardesynë time. Ndonjë pikë më hynte në qafë dhe kjo ishte e bezdisshme. Ecja ngadalë nga hoteli tek ai «bar» i vogël që më pëlqente shumë. U futa brenda, Fshiva flokët.

— Një kafe me pak — i thashë. Ç'është e vërteta, kafeja më pëlqente më tepër e ëmbël, por ja që kisha ca mendime, sigurisht nga sa kisha parë, se burrat e vërtetë e pinin kafënë të hidhur. Pija dhe ndiqja rrëketë e shiut që gjarpëronin në xhamet e mëdha të «barit». Papritur e ndjeva veten të qetë e të kënaqur. Kalova ca minuta kështu. Pastaj m'u kujtua shkrimi që duhej të bëja dhe u shqetësova. Gjithmonë në fillim më mbërthente një ndjenjë e pasigurt për të kapur temën, pastaj ecja mirë. Kisha dy ditë dhe kisha fare pak material. «Nejse, do bëjmë si do bëjmë,» i thashë vetes. Pastaj diç i thashë kamerierit, për atë që binte shi dhe që klientë kishte pak. Ky kamerier më pëlqente. Kur dje mori vesh se isha gazetar, m'u afrua:

— S'është puna te shiu, i dashur, joo, — tha duke e theksuar fort jo-në — lagjja e jashtme e qytetit është përmbytur, qamet i madh ky... edhe fshatrat përreth. U dha alarmi, është shpallur aksion

rrufe. E diel, e diel, po njerëzit janë atje — dhe nxori me fshesë ujin që kishte hyrë te dera. Heshta.

«Si s'mora vesh?» shava veten. Pagova. Pas pak ecja me hapa të mëdhenj duke kapërcyer gropat e rrugës të mbushura me ujë. Qe shi me rrebesh dhe pardesyja ime kërkëllinte si teneqe. Pikat në qafë tani s'i ndieja më. Në këpucë më kishte hyrë ujë.

— Alarm! — thashë. — Uji në hambar! — dhe shpejtova hapat. Një gumëzhitje makine. Një «Gaz» kërcente mbi gropat duke hedhur anash ujin e tyre të verdhë. Fshiva buzët dhe hundën me pëllëmbë. «Siç duket do të kem një pamje për të ardhur keq, mendova, meqë ndaloj.» Kur u ula në ndenjese, e ndjeva plotësisht kontaktin me rrobat e lagura. Pa-pa, sa gjë e keqe është kjo!

— Qenke lagur, shok, — tha burri që rrinte përpara, veshur me një xhakëtë e kasketë lëkure — ku shkon?

— Atje, — bëra me dorë — ku janë të gjithë. — S'më foli më.

— A telefonoi Tefiku? — pyeti njërin prej atyre që rrinin pas.

— Jo, shoku Pipi, — tha ai — dërguam një njeri.

«Qenka sekretari!» thashë dhe e pashë me vërejtje.

— Traktorët kanë dy orë që janë nisur, — tha burri tjetër pas — do të kenë bërë goxha punë tani. — Fjalët e fundit i shqiptoi të ndara në rrokje, pasi «Gazi» ra në një gropë dhe kërcëu disa herë. Shoferi qe përkulur mbi timon dhe, kohë pas kohe, fshinte me një leckë xhamin përbrenda. Iu afruam lumit. Atëherë shqova zinxhirin e gjatë të njerëzve.

— Mbaje, — thirra — do të zbres... ju lutem —

shtova pastaj. Kisha dalluar punëtorët e ofiqinës ku pata qenë një ditë më parë.

— Ama me këta çapajevët qenke ti? Hajde, punë të mbarë, shok! — Sekretari më përshëndeti me dorë. Shiu kërkëlliste prapë mbi pardesynë time.

— Oh, — tha njëri nga punëtorët — po ti?!

Kujtesën e kisha mirë: «Ky është Gjon Nika», thashë me vete. Toka duart me të e me nja dy-tre të tjerë.

S'prita shumë, rrëmbeva një lopatë. Djemtë u panë në sy. Tundën kokat. Balta ngjitej e të këpuste krahët. Më mërzi pardesyja, «fësh-fësh, fësh-fësh», le që s'durohej me atë kërkëllitjen nga shiu. E hopa. Pranë nesh ujët e lumit rritej. Qe një rritje e ngadalshme, por kërcënuese. Herë pas here i hidhja sytë mbi atë hapësirë të gjerë që lëvizte, me ujin e verdhë, ku shfaqeshin trungje, degë, trarë shtëpish, bile dhe një djep fëmijësh pashë. Kjo e fundit më bëri të mendoja se lumi ngjante me një bollë të verdhë e të neveritshme, megjithëse, pas kësaj, zura të vrisja mendjen se a ka bollë të verdhë. Erdhi një makinë me gurë. Zumë ta shkarkonim.

— Jo aty, — u thirra punëtorëve në krahun tonë — uji po sulmon këtu... o burra, këtu! — Hezitan.

— Mirë e ka djali, atje, — u hodh një burrë i vjetër flokëbardhë — po çau aty, na shkon dëm gjithë puna. — Një këmbë m'u fut në baltë gjer në gju. Merrja frymë me vështirësi. U lodha. «Ë, qerrata, thashë, ke kohë që s'ke punuar.» Dikush po më thoshte se i pëlqente shumë një shkrimi im. Më kujtohej ky djalë. Skuqej si çupë dhe shkruante vjer-sha, më duket.

— Ëhë — i thashë. Atë çast shkava. Dikush

thirri. Më zgjatën një bisht lopate dhe dola nga lumi. Shfryva ujin nga hundët. Më erdhi për të qeshur me veten dhe me shiun. Më hodhën një peliçe krahëve. S'di si u ndodh dhe shoku Pipi aty.

— Ee... — qeshi — bëre banjë, ë? — Iu kthye dikujt: — Thuaji Mitit ta shpjerë shokun në shtëpi e të vijë aty tek ura.

— Jo, — i thashë — mirë jam, faleminderit.

Do të ftohesh kështu... po ti, mor i uruar, çof ke ardhur dhe me këto rroba!... — qeshi. Tunda dorën.

— Nejse — thashë. Shkova afër Gjon Nikës. Sekretari eci tej me pantallonat e përbaltura. Zhvesha bluzën dhe e shtrydha. Më detyruan të vishja një xhup pambuku. Lumi kishte mbetur si i shtangur nën pritë dhe, atje ku çikej me atë masë balte e gurësh, rruazat e shkumës e tregonin të tërbuar, të neveritshëm, të pafuqishëm përpara nesh. Ai djali i vjershave sëç më tha diçka tjetër:

— Vjet e ke shkruar, — tha — ...s'më kujtohet titulli, ... eh...

— Lëre, — i thashë — në drejt të vejë! — dhe m'u bë qejfi që një gur i madh që hodha, ra tamam atje ku duhej. Ngrita kokën. Njerëzit nxinin deri larg, anës lumit. Atje gulçonin dhe buldozerët. Në fshatin përtej ushtarët po ndihmonin për shpërnguljen e familjeve të përmbytura. Sekretari i partisë po dukej prapë për këtej. Bënte me dorë dhe diç i thoshte atij që kishte në krah. U afruan. Qe llangosur i tëri me baltë. U pamë në sy dhe qeshëm.

— Ja, — tha — shkruaj për këtë çapajevin, megjithëse kishte ardhur si për dasmë — qeshi e bëri me dorë nga unë. S'e kuptova. Ktheva kokën

pas. Dëgjova që më thirrën në emër. U pamë në sy me Andrenë dhe ia dhamë gazit të dy, unë me gjithë shpirt, ai i habitur me pamjen time.

— Andrea, po ti? — i thashë. E kisha shok dhe koleg Andrenë. Gjon Nika diç i thoshte për mua dhe shoku Pipi qeshi me të madhe.

— Ha, ha... pa shih, pa shih!...

— Ç'kemi andej? — pyeta Andrenë, që akoma s'i qe zhdukur habia e s'qe sqaruar.

— Hiç, — tha — shefi të ka sharë.

— Më ka sharë, ë?... — Mirë, or, mirë — krova kokën e lagur. Shiu po pakësohej. Qesha. Diç po më thoshte Andrea. Unë tundja kokën. Dhe mendoja se si do të thahesha në hotel, dhe mendoja se si sportelistja e mirë ndoshta mund të më gjente një hekur rrobash, dhe mendoja se do të bëja një shkrim të mirë. Pastaj e ndjeva veten mirë.

## HEROIKISHT

Kur u largua tymi, krismat kishin heshtur. Ana tjetër e shtëpisë akoma digjej.

— Hände hoch! — u dëgjua po ai zë.

Selfoja ngau mustaqet.

— S'kam dëgjuar më pis zë se ky, për ideal... ç'thua ti, Rrapi, ë? — foli.

Rrapi luajti shulin e pushkës.

— Edhe dy fishekë na mbetën... për vete. —

U panë në sy. Selfoja buzëqeshi.

— Sille një, atë që çirret kështu, do ta dërgoj në të s'ëmës, ti mbaja atij që hidhte granatat te qoshja, ja... ja tek duket firauni.

Selfoja u var duke rënkuar nëpër trarët. Rrapi shtiu. Dikush klithi andej. Pastaj një mori armësh u përgjigj. Katër pesë gjermanë kapërcyen avllinë nga pas shtëpisë. Selfoja tërhoqi këmbëzën. Krismë. Pastaj një helmetë u përpoq me tringëllimë pas gurit. Selfoja u ngjiti sipër.

— Ashtu... — tha — se, për ideal, më gërryente zorrët e barkut ai zë.

Pastaj u panë në sy. Rrapi ishte i ri, djalë qyteti, Selfoja fshatar; përtej të dyzetave.

— E, ore, u mërzite, o Rrapi, e pse, o derë-



bardhë, të vrisnim veten... le të na vrasë gjermani, po të jetë për të vvarë, gjermani ka fishekë boll.

Selfoja qeshi, pastaj u shëmtua nga dhembja e plagës. U panë në sy.

— E po, mirë luftuam, ë, Rrapi?

— Mirë luftuam, o Selfo.

— A puthemi një herë, o Rrapi? — Dhe u puthën buzë më buzë. Pastaj Selfoja i rrahu gjurin shokut e ia dha të qeshurit.

— O-ho-ho... të mora për çapaçul, kur erdhe në çetë, o Rrapi. «Ky të luftojë», thashë, por qenke trim e përtej trimave, ore, për ideal.

Fishkëllyen plumbat. Cifla dërrasash kërcyen nëpër dhomë. Poshtë dëgjoheshin zëra gjermanësh. Rrapi zuri pushkën nga gryka.

— Shshsht!... — bëri Selfoja. — Dëgjo, s'kemi kohë, mës kundërshto, Rrapi, do të të lidh e do të hiqesh si hafieja e Ethem beut, që vramë. Ata s'dinë gjë, se edhe zoti Ethem u bën selam andej...

— Selfo, ç'bën, Selfo?! Më lër, bashkë luftuam, bashkë do... lërmë pra, Selfo!

— Rri urtë, mor, jahu, sh.... sht, e provojmë një herë de, s'bëhet qameti.

Selfoja, duke u rrudhur herë pas here nga dhembja, e lidhi me një litar të trashë.

— Dëgjo, t'u thuash se partizanët janë në Qafë të Gjarprit që, kur të venë këta gjer te gryka e t'u rrokullisin shkëmbin, ta mbushin honin me atë «Hail Hitlerin» e tyre, hë...

Rrapi s'mundi të fliste. Kur Selfoja i futi në gojë një leckë me erë të athët, ai ndeju mustaqet e tij të ashpra ta çiknin në fytyrë, pastaj hapat e tij që rendën poshtë. Sytë iu mbushën me lotë.

— Selfo, Selfo! — gulçonte ai. Poshtë u bë zhurmë. Klithma. Ashtu shtrirë mbi dyshe-menë e copëtuar, Rrapi dëgjonte të sharat e mbytura të Selfos. U përpoq të ngrihej. Shpatulla i theri. Ra.

\* \* \*

Oto Krigeli shikonte përtej xhamit.

— Ja, ky është një fshat shqiptar, fshat i bukur, por ka diçka të egër. Thonë se ka kaluar Bajroni këtej. — Dhe mendoi se ç'vargje mund të hidhte në bllokun e tij nga kjo krahinë. Ishte poet Oto Krigeli, shkruante vjersha. Por ishte dhe kapiten Oto Krigeli dhe digjte fshatra me batalionin e tij. Lëshoi perden dhe eci nëpër dhomë. Ia nguli sytë një fotografie në mur. Një burrë i vrazhdë, me mustaqe e feste, mbështetur mbi një pushkë të vjetër, e shikonte që andej.

— Popull i egër — tha Oto Krigeli dhe u mendua. — Ky partizan na vrau shumë dhe është i qetë... sa i qetë! Interesant... dhe e di se fare pak jetë ka për të... Racë e çuditshme.

— Kurt! — thirri. Një ushtar hyri dhe përplasi çizmet. — Të niset i lidhuri me një shoqërues në komandë. Një motoçiklist të shpjerrë këtë letër te major Shelge, urgjent. Qartë?

— Javol! — Kurti përplasi takat.

— Prit... sillni partizanin dhe përkthyesin.

Përsëri përplasje takash. Kurti doli... Kur hyri te dera, Selfoja u kërrus. Pa një karrige dhe u ul. Gjermani që rrinte pas, e goditi me automatik në brinjë: ,

— Steh auf du schwein!¹)

— Lass — bëlbëzoi Oto Krigeli. — Lass!²) — E pa gjatë. Selfoja u shtriq mbi karrige dhe me dorën e shëndoshë ngau mustaqet.

«Nga ky s'ke ç'nxjerr, mendoj Oto Krigeli, ky nuk shtiret, por është vërtet i qetë e gjakftohtë.»

«Shih, shih si kapardiset, kodoshi, mendonte Selfoja, pa të të zinin ne... ore, po ky... Çeçoja të jetë vallë?» Selfoja hodhi sytë nga fotografia e varur në mur. Oto Krigeli i zgjati një cigare. E mori. U përkul. Ngriti nja dy kongjij nga vatra dhe e ndezi. Oto Krigeli ngriu ashtu me çakmakun në dorë dhe ndjeu t'i dridhej mishtë duke parë ata kongjij të kuq në atë pëllëmbë të ashpër si shollë këpuce.

— Ç'di ti për partizanët? Ku janë ata? — Dhe, pasi u mendua pak: — Kam respekt për burrin dhe stoicizmin tënd, por a nuk tingëllon e gjithë kjo si diçka absurde tani?! Njerëzit përpiqen, luftojnë, vënë përpara idealet e tyre, por të gjitha këto i bëjnë që të jetojnë më mirë, pra në fund të fundit... që të jetojnë. Sprich, ich will dieh horen.³)

Përkthyesi, një burrë koskëdalë me një pamje të trembur, ndreqi syzet dhe përktheu shpejt sikur po e ndiqnin. Selfoja heshti. Pastaj thithi cigaren. Heshti.

— Pa pyete njëherë, ç'gradë ka ky zotni? — Zëri i tij u davarit i trashë e i ngadalshëm nëpër dhomë. Përkthyesi u zverdh. — Hë de, pyete, ç'më sheh si lugat?

---

1) Çohu, derr!

2) Lëre.

3) Fol, unë dua të të dëgjoj ty.

Përkthyesi diç foli gjermanisht. Oto Krigeli u përgjigj shpejt dhe një buzëqeshje i shkau buzeve.

— Përpara jush është kapiteni i ushtrisë së Rajhut, Oto Krigel. — Kur tha kështu përkthyesi, Oto Krigeli u ngrit dhe buzëqeshja iu ndeh në gjithë bardhësinë e fytyrës së tij.

— Ashtu ë?... — Dhe thithi fort cigaren. — Thuajë këtij çapaçuli se unë jam mësuar të flas vetëm me gjeneralë e lart, dëgjove, kështu thuaji, hë... — Selfoja hodhi këmbën mbi këmbë e ngau mustaqet.

\* \* \*

Rrapi merrte frymë me zor. Kur vrau gjermanin që e shoqëronte, një mendim i lëvizte si rrufe në tru: «Duhet shpëtuar Selfoja.» Por e pa që s'bënte dot gjë. Dhe qau. Kafshoi buzën dhe qau. Dhe tani rendte në krye të shokëve të çetës dhe gëlltiste lotët. Rendte dhe në gjithë pamjen e luginës që i dukej ashtu e mjegulluar, i shfaqej ai, i madh dhe i dashur, duke ngarë mustaqet e zeza e të varura dhe duke i thënë: «E, o derëbardhë... ç'mërzitësh kot, or, t'u mbylltë...» dhe qeshte. Rrapi rendte. «Ndosh-ta unë u bëra trim aty te shtëpia e Velos, vetëm se isha pranë teje. Selfo. Ti e shikoje vdekjen aq i qetë, aq i patrembur.» Dhe kështu i diltë përpara përsëri ai, me trikon e dhirtë, me lëvizjet e ngadalshme, por të sigurta. Vrap. «Selfo, Selfo!» Vrap. Rendte midis atij peizazhi të ngrysur e të ftohtë, ku retë kishin zbritur aq poshtë, sa çiknin pothuaj majat e aheve të gjata e të heshtura. Zëri i komandantit. Çeta u nda më dysh e iu var fshatit.

• • •

Selfoja qe shtrirë nën fikun e madh. Mbi trikon e dhirtë, njolla të mëdha gjaku. Kishte shtatë të tilla. Një pizgë e hollë i qe piksur që nga leshrat gjer poshtë nën mjekër. Dhe dukej sikur qeshte.

Rrapi qau prapë.

— Mos, — tha komandanti — s'bën kështu, Rrapi. — Ai u end prapë nëpër fshat. Te çesmat një plak diç u tregonte dy-tre partizanëve.

— Selfo e thoshin, thatë, ë? Selfo... E po trim qe, or djem, të tillë trim s'më kishin parë sytë. Ai jeziti, kumandari, ia mbajti koburen. Me të parën nuk i ndezi. «E, or, t'u mbylltë, i thirri ai, sikur ta kesh top e jo kobure që s'e shkrep dot.» Trim, or, trim... Selfo thatë, ë... ngaha ishte vallë?...

...Diku andej pranë Shkodrës, pranë një oficeri të vrarë, një partizan gjeti një bllok të bukur me fletë të holla e të lëmuara. Në kapak, me një shkrim të bukur, shënohej: «Oto Krigel». S'dinte të lexonte ai partizan. Letra qe e mirë dhe ai, gjer në Jugosllavi, e drodhi cigare. Në fletën e fundit që i kishte mbetur, shkruhej: «E gjithë kjo ngjarje më trembi. Unë qëlloja dhe ai qëndronte në këmbë. Mein gott! Ndjeva një angushti të madhe në gjoks. Mbështetur mbi atë sfond malesh e shkëmbinjsh të egër, das Kopf trögte er hoch...<sup>1)</sup> heldenhaft<sup>2)</sup>... heldenhaft.»

---

1) Kokën e mbante lart.

2) Heroikisht.

## YZEIRI

Për të shkuar në shkollë, ne kalonim nëpër ca kopshte me pemë. Andej kishte gardhe dhe ne mbli-dheshim kruspull e futeshim nëpër vrimat që kishim hapur. Pastaj, më vonë, e ndiem që ishim rritur dhe s'na kishte më lezet të futeshim nën gardhe; i binim rrugës drejt. E kam shumë të turbullt atë kohë, më kujtohet vetëm që në pranverë mbrëmjeve mblihdh-nim xixëllonja dhe ua jepnim vajzave. I ndiqnim xixëllonjat ferrave e hithrave, sa këmbët e duart na bëheshin gjak, por në gjumë binim të lumtur. Atë kohë në klasën tonë erdhi Yzeiri. Ai kishte ardhur nga fshati, te xhaxhai i tij. Yzeiri kishte kokë të madhe dhe një gisht flokë mbante gjithë vitin. Vish-te një xhup prej leshi të dendur, pastaj i blenë një xhaketë, por çorapet e lështa s'i hoqi kurrë. Ishte fjalëpak, bile të pëlciste sa e nxirrte llafin. Shumë nga djemtë e klasës qeshnin me të, por, kur ai i përkuli dorën Gencit që mbahej më i forti prej nesh, e pamë me tjetër sy. Genci atëherë i tha:

— Ma bëre me hile... po... — pastaj shikoi llë-rën e bardhë të Yzeirit — po karrigen e ngre dot nga këmba e përparme, ë?

Yzeiri s'tha gjë.

— Hë, e ngre dot? — thoshte Genci.

— S'kemi pasur si këto në shtëpi, në fshat —  
pëshpëriti Yzeiri.

— Posi, s'e ngre dot dhe thua... s'keni pasur?!  
Pse, ku rrinit ju?

— Në poste rrinim — pëshpëriti Yzeiri.

— Ua, poste, ç'është kjo poste?! — tha Neta.

Yzeiri u skuq e përsëri nuk tha gjë. Më kujtohet ajo ditë se që atëherë në filluam të mësonim bashkë, unë dhe Yzeiri; ai kishte mjaft dobësi dhe shtabi i kompanisë më ngarkoi mua të kujdesesha për të. Shpejt ne u mësuam me njëri-tjetrin. Studjonim veç e veç, pastaj unë i kërkoja të ma thoshte mësimin. Njëherë ai më solli një copë kulaç që ia kishin dërguar nga fshati. Mua m'u duk pak i fortë, por i thashë se ishte shumë i mirë dhe atij i shkëlqyen sytë. Kur mësonim botanikën, e kuptoja që kënaqej dhe, ndërsa ma thoshte mësimin, dilte nga tema dhe zinte e fliste për lloj-lloj bimësh. Kur ishte i mërzitur, merrej vesh përnjëherësh. Kur e merrte malli për shtëpinë, fytyra i merrte një shprehje të veçantë dhe kuptohej lehtë.

Një ditë, gjatë shpjegimit të mësimin, mësuesi i gjeografisë ndali:

— Kush shkruan kështu në hartë? — tha dhe u përkul mbi një pikë boje dhe një shkrim të pakuptueshëm nën të. Ajo ishte një hartë e re që mësuesi e ruante me kujdes, ndaj dhe u zemërua shumë. Klasa heshti. Pashë që Yzeiri qe skuqur. Në pushim ai m'u afrua.

— Ti e ke bërë? — i thashë. Ai s'foli. Qe bërë flakë në fytyrë.

— Ç'ke shkruar? — i thashë.

— Shkrova... — tha. Kishte shkruar emrin e fshatit. — Do të vete t'i them tani — tha.

— Mirë — i thashë. Ai u kthye pas një copë here.

— Të shau? — e pyeta.

— Ëhë, — tha — më shau, më tha se s'e di gjeografinë, fshati im binte më poshtë, ishte dhe përroi i Cullit në hartë, aty binte.

Unë qesha dhe i rashë krahëve.

Kështu mësonim çdo ditë me Yzeirin. Ai filloi të merrte nota të mira dhe unë gëzohesha shumë. Një pasdite ai s'erdhi tek unë. Të nesërmen mora vesh se i kishte ardhur nëna dhe do t'i rrinte ca ditë. Ai kishte mbathur çorape të reja leshi, në qafa ishin me kuti të kuqe dhe, kur Lena thirri: «Uaa, sa të bukura, goca!», ai u struk në bankë. Në pushim nxori nga çanta një letër të madhe dhe u skuq.

— Hani! — tha.

— Ç'janë këto? — tha Edi.

— Vadhëza, — tha Yzeiri — m'i solli nëna. — Dhe prapë u skuq.

— U, sa të mira! — thirri Doli që sapo kishte futur një në gojë.

— Ha, ha, — qeshi Spiroja — pse këto të sjell nëna ty!

— Pusho! — i tha Neta. — Budalla mbete gjithmonë ti.

— Tarallake, — shau Spiroja — kush të foli ty?

— Mirë, mos ha, po s'pate qejf — tha Yzeiri dhe çkërmiti një copë ashkël nga banka, pastaj u kthye nga ne. — Këto bëhen në këtë kohë, bëhen shumë, mbushet gjithë faqja e malit, ne ngjitemi me dhentë dhe... — Pastaj heshti. — Hani, — tha — hani.



Pas ca ditësh, në pushim i erdhi nëna. Ajo do të ishte, duket, dhe kishte ardhur ta takonte.

— Ej, ka ardhur nëna e Yzeirit! — thirri dikush. Vajzat u përulën nga dritarja. Ajo ishte atje, te dera e oborrit.

— Çuna, unë i thashë që s'lejohet të hyjë në oborr dhe ajo e hëngri, he, he! — qeshi Spiroja. — He, he! — bëri pastaj — ç'keni që më shihni kështu?!

— Qurravec, — i tha Genci — hajde mbushu, qurravec!

Yzeiri kishte dalë jashtë te porta. Nëna e tij ishte e imtë dhe e thatë, me shami në kokë dhe me fustan të gjatë, të leshtë. Ata ndenjën pak kokë më kokë e diç thoshin me zë të ulët. Pastaj ajo e puthi në faqe e në ballë dhe iku. Ai e pa gjersa ajo u largua fare. Ne bëmë gati fletoret e hartimit. Mësuese Vera shkroi temën në dërrasë. Yzeiri ishte përkulur mbi bankë me sytë tej dritareve. Klasa ra në heshtje. Pastaj unë s'e pashë më atë, se nisa të shkruaja. Vetëm nga fundi i orës e vura re që rrinte me kokë mbi grusht.

— Ç'ke, — i pëshpërita — pse s'shkruan?

— Mbarova — tha.

Mësuese Vera kishte hapur fletoren e tij dhe po lexonte. Faqet i ishin skuqur dhe sytë i shkëlqenin.

— Ç'ka zysh Vera? — pëshpëriti Linda. — Ajo po qan.

— Yzeir, — tha mësuesja — hajde këtu. — Ajo ngriti kokën dhe ne pamë se ajo vërtet i kishte sytë të përlotur. Yzeiri mbeti një hop, pastaj eci ngadalë drejt katedrës. Mësuese Vera seq i foli me zë

të ulët dhe ia mbështeti kokën në supin e saj. Yzeiri ishte skuqur dhe shikonte përdhe.

— Një hartim i tillë çdo nënë do ta bënte të lumtur. — Ajo ngriti zërin dhe tundi fletoren. Ne i kishim lënë penat.

— Zysh, — tha Neta — na e lexo, zysh.

— Na e lexo, zysh, na e lexo!

— Mirë, — tha mësuese Vera — po jua lexoj — dhe hapi fletoren.

## ÇAST LUFTE

Komandanti tha:

— Boll u bëmë. Ti, Telo, mbete për në lagjen e sipërme — dhe iu kthye atij të këshillit të fshatit:  
— Si the, o Zenun, te plaka e Lamçes? Mirë, o Telo, te plaka e Lamçes do vesh.

— Gjithmonë mua më gjen, o komandant. T'i bëj muhabet plakës së Lamçes unë?! Jo, or, jo, shkoj me shokët, më mirë.

— Telo! — iu hakërrua komandanti dhe mustaqet iu drodhën. — Hajde, nisuni! — shtoi pastaj me të butë. — Më pesë të sabahut, te rrapi.

— Hi, hi, hi, ta mblodhi, na-a-a! — qeshi Gaçja sikur hingëllinte dhe u fsheh nga vështrimi i vëngër i komandantit.

Teloja priti sa u ndanë gjithë shokët e çetës nëpër baza pastaj, me atë të këshillit, u nis për në lagjen e sipërme. S'flitnin. Teloja shtrëngonte automatikun dhe ndiqte zhurmën monotone që bënin opingat e llastikta në baltën e monopatit.

«Të paktën të më kishte lënë me xha Fejzon, tha, dy vetë ishin atje. Eh, xha Fejzoja, qerrata plak që është, apo s'tregon histori nga ato të turkut.»

Dhe inati i iku përnjëherësh e një buzëqeshje

si prej fëmije iu ndeh nëpër të gjitha tiparet e fytyrës.

«— Dëgjo, mor bir, — thoshte xha Fejzoja — mirë qe je trim, si Selami e Zigur Leloja je, mirë... po pse, mor i paudhë, pse kërkon të shkosh si qeni në vreshtë. «Trimi i mirë e me mend në kokë», kësh-tu thosh dhe kapedan Zaçja, i ndrittë shpirti i ndrit-të. E ç't'u desh të bëje marifete atje në postkuman-dë?! Mirë, mor, jahu, mbarove aksionin, bukuri, jo po doje t'i zografisje një palë mustaqe të mëdha fo-tografisë së Duçes ti! Po sikur... ç'janë, ore, këto hynere që bën?! Ah, mor bir, je i ri ti... kur isha unë... Dale, ore, dale, ku vete?

Teloja qeshte dhe i shkiste nëpër duar. Dje qe nxehur shumë xha Fejzoja me të. Pasi goditën auto-kolonën gjermane, ku Teloja për qime shpëtoi dy he-rë, xha Fejzoja, tek pastronte armën, e thirri:

— Pa qasu, pa qasu tëhu, o kokëgdhe. Mor, po sa herë...

— Ohu, lëmë, o xha Fejzo, lëmë, më paç ura-tën, se s'ta kam ngenë!

Xha Fejzoja s'priti e i vërviti kutinë e duhanit.

— Ptu!... Uratën e sat ëme, jezit i jezitit!

U shqyen së qeshuri të gjithë partizanët. Telo-ja ia mbathi e që dje s'i kishte dalë në sy.»

— Sa vjeç je? — e pyeti fshatari dhe e pa me një shprehje të butë e të dhemshur.

— Nëntëmbëdhjetë, ka ca ditë që i mbusha. Pas përleshjes me larot e Veip beut, m'u kujtua — dhe buzëqeshi. Buzëqeshi dhe fshatari.

— Nga të kemi?

— Nga qvteti jam... Ajo shtëpia atje është?

— Ajo. Një plakë e ve'me, nënë Xikoja rri. Plakun e ka maleve, me Brigadën e Parë... Sosëm

— foli Zenuni. — O nënë Xiko! Nënë Xiko! Pa dil një çikë — thirri pastaj.

\* \* \*

Teloja u ngroh e u çlodh pak. «Plakë e fortë», mendoi dhe shikonte plakën që vinte e vinte për t'i bërë bukën. Telos i qe lidhur gjuha. Plaka i lëshoi tepsinë përpara dhe u ul në cep të shiltes. Ai zuri të mbllaçitej ngadalë. Në vatër ra një urë zjarri. Plaka u ngrit dhe e ujdisi. U ul prapë e nisi të dridhte furkën. Herë pas here ngrinte kokën e shihte profilin e tij të hequr.

— Po ha, mor bir, ha... sa të ri të paska nëna, a ka të tjerë ditëzeza?

— Jo, i vetëm jam.

Plaka tundi kokën dhe në atë çast rrudhat iu dukën më të thella dhe fytyra më e fishkur e më e zbetë. Atij i vinte gjumë. Pas një çasti u përmend. Plaka po e vërente. Kishte aq dhemshuri e vëmendje në sytë e saj, saqë atij iu duk se pa nënën e tij atë çast. Buzëqeshi.

— Më zuri gjumi — tha.

— S'ka gjë, bir... qenkâ lodhur shumë, ja, të shtron nëna.

Dhe u ngrit plaka... Prapë iu var koka mbi gjoks. Ashtu përgjumësh ndjeu pëshpëritjen e plakës: «Ah, luftë, luftë e zezë, harram qumështin e nënave, o të ligj, që na shkelët vatrën!»

Mendimi i brodhi larg. Njëpërmjet krismave e flakëve të luftës, njëpërmjet asaj ndjenje, atij dufi në çastet e sulmit, dhembjes për shokët e rënë, ai shikonte diçka të turbullt e të pakapshme. E, megjii-

thëse e tillë, ajo ishte diçka e këndshme, e përshkuar nga tufa të bujshme drite... Bridhte rrugëve me automatikun krahëve dhe çdo gjë i dukej ndryshe. Një zë vajze. Kush ishte ajo? Infermierja ezmore e me sy të bukur që e mjekoi atëherë, apo Esmaja, çupa e mëhallës që nëna ia kishte vënë syrin; apo Liria, shoqja e vogël e çetës, së cilës Teloja i kishte mësuar gjithë llojet e armëve?! S'e dinte. Ecte... ecte. «Nënë, nënë!» foli përgjumësh e u përmend. Plaka po i hiqte kollanin.

— Bjer, bir... ja, mbulohu me këtë. Të zgjon nëna pa gdhirë, mos ki merak... të keqen nëna — dhe shkoi matanë me ato këmbët e lehta që s'ndiheshin fare. Teloja vuri kokën mbi jastëkun e bardhë, që mbante një aromë aq të këndshme e të dashur, një aromë të këndshme sunduku, aromë shtëpie. Mendoi për plakën. Dhe i pa përsëri rrudhat, vështrimin e saj që derdhej plot dhëshuri mbi të. Mendimet iu fashitën e iu zbehën. «Javën që vjen do të futemi në brigadë, do të jemi ushtri tamam.» U vërtit në krahun tjetër. Komisari i kishte vënë dorën në sup e i kishte folur për ditët që do të vinin. Dhe ai ndiente se si rritej e rritej dhe malet i dukeshin të vogla si togje dheu. Ai e shikonte komisarin në sy. Kaq fuqi buronte vallë nga vështrimi i tij, nga dora që i mbështeti në sup?!

Përsëri e pa vetën rrugëve të çliruara të qytetit. Ecte dhe i dukej se qëndronte, ndërsa gjithçka përreth lëvizte, lëvizte. Ai shikonte se si njerëzit qeshnin e brohorisnin, por nuk dëgjonte asgjë. U ndien të shtëna. Teloja buzëqeshte në gjumë. Një plasje aty afër drodhi xhamet e dhomës. Hapi sytë dhe brofi. Rrëmbeu automatikun e kollanin dhe shtyu kanatin. Një shtëpi digjej në lagjen e posh-

tme. Kërceu në sofat e u mbështet te ca gurë të mëdhenj nja 50 metra larg portës, rrëzë një fiku gdhenja-gdhenja. Sapo kishte nisur të zbardhte. Poshtë, te çesma, dalloi helmëta gjermanësh. «Dreq, tha, paskam mbetur këtej, i vetëm». Pa u ndje një zë i çjerrë në atë gjuhën e urryer. Shtiu. U dëgjua klithma.

«Ashtu, tha, vafshi shëndoshë!» I shkoi ndër mend të çante e të bashkohej me shokët. Vuri re se torbën e karikatorëve s'e kishte. Shau veten.

Pa hijet e gjermanëve që ngjiteshin nga poshtë. Plumbat këputën fletët e thata të fikut mbi kokën e tij. U përkul. Te porta kishte dalë plaka. Ai shtiu mbi hijet që ngjiteshin.

— Bir! — thirri nënë Xikoja e rendi drejt tij. Plumbat fishkëlyen në pllakat e sokakut.

— Bir i nënës, harrove këto — dhe i zgjati torbën. Për një çast mbështeti kokën te supi i saj. Gishtërinjtë e saj u drodhën nëpër flokët e tij. Në anën e përtejme, te qafa, pa flakët e armëve. «Shokët e çanë rrethimin, tha, tani...» Një plumb e preku shkarazi në shpatull. I dogji. Shtiu përsëri. Fshiu djersët me mëngë dhe pa njolla gjaku në të. «Edhe kjo u desh,» mendoi... Pas një ore ai qëllonte përsëri. «Ndoshta, tha, xha Fejzoja s'do të më shajë më këtë radhë.» U përpoq të buzëqeshte. Njomi me gjuhë buzët e thara e të plasaritura. Iu morën mendtë. Vegime të turbullta e të shkëputura. Mbi 19 vjetët e tij lufta kishte mbështetur peshën e saj të rëndë. Dhe ai e mbante, sepse duhej mbajtur kjo peshë. Një urrejtje e pushtonte dhe i griste kraharorin për këta njerëz të huaj me atë theks metalik... Peizazhi u lëkund. Dhe ato silueta me kaska, poshtë nëpër gurët, iu lëkundën e iu duk sikur u

zgërdhinë me të. Shtiu. Ishte gdhirë. Ata qenë fare afër. Përsëri shtiu. Automatiku i ngeci. Pa karikatore. Buzëqeshi. Qe buzëqeshje e çuditshme kjo. «Po tani? . . .» tha. Po plakën që po vinte drejt tij. Atë çast kishte kapur granatën e madhe.

— Nënë, — thirri — largohu, nënë! — S'e njohu zërin e tij. Plaka ra mbi të. Në lugjet e thella të faqeve të saj shkisinin lotë.

— Bir i nënës; bir i nënës!... — dhe mundohej t'i mbante gjakun e plagëve.

Gjermanët panë se si ai djalë i gjakosur, mbështetur te një plakë, çemberi i zi i së cilës valavitej nga era, u ngrit mbi ta. Lëvizjet e tij qenë të ngadalshme. Në dorë kishte një granatë të madhe. Dhjetëra armë u shkrehën. Një oshëtimë e fuqishme drodhi ajrin. Flakë. Mbi ta ranë gjithë drurët, pemët, malet, gjithë ai relief i ashpër shkëmbor.

...Dhe lapidari aty, tek ata gurë, është për nënë Xikon dhe partizanin Telo nëntëmbëdhjetëvjeçar.



## TINGUJT E NATËS SË BARDHË

Mezi e shkëputëm Andrenë. E kishte mbërthyer për jake Fatin dhe po e shkundte fort. Ama edhe neve na kishte ardhur atje ku s'mbante.

— Ptu, — shante Andrea — kështu i lë shokët ti, mor kodosh, ë? A kur s'të..

Binte borë. U futëm në kasollen tonë. Ishim të uritur dhe hapëm konservat. Fati rrinte i ngrysur mbi shtratin e tij. Kishim dy ditë pa ngrënë. Vendi, ku bënim matjet, ishte larg. Me vete kishim çadrat, Fatin e lamë që të furnizohej e të na sillte ushqimet. Prit... e hiç: Kur u kthyem (rrugës u merakosëm se mos i kishte ndodhur gjë), ky karafili na tha se s'shkohej dot nëpër gjithë atë borë dhe se, bile, edhe ne duhej të ishim kthyer më parë. Atëherë iu lëshuam...

Hëngrëm. Unë dhe Andrea ndezëm cigaret. Maksi dhe Nikoja s'e pinin. Ngadalë-ngadalë të ftohtët s'po e ndienim më.

«Mirë që paska ndezur sobën», mendova. Pastaj zumë të flisnim për punën e dalngadalë të gjithëve zuri të na zbriste inati. I pari që qeshi, ishte Maksi.

— Po të të shikojë njeri nga pas ty, Titi, —  
tha — dukesh sikur po nxjerr tym nga koka.

— Bjeri, bjeri! — thashë unë e thitha cigaren.

Andrea qe shtrirë ashtu, i madh, i rëndë dhe, kur luante, shtrati kërciste «kërc-kërc». Një ditë ishim grindur për këtë kërcitje, nga se shkaktohej, si dilte tingulli zanor nga një forcë mekanike, e s'mbaj mend se ç'tjetër. Po binte muzgu. Ndjeva mërzë.

— O, po ndizeni atë radio, — thirri Nikoja —  
ç'prisni.

— Ë? — pyeti Maksi. — Bateritë? Mirë, qenkemi rehat. — Nikoja zuri të fishkëllente. E pashë një herë ashtu vëngër, sikur të doja t'i thosha: «Na gave kokën.»

— E po... u mërzitëm — u shfajësua.

— Ti çoç fishkëllen dhe bukur, mor jahu — i thashë. Më shkuan sytë te kitara e Fatit, varur në mur.

— Fati, bjeri, o, bjeri ca, se për nder s'kalohet kjo kohë.

Pashë jashtë nga ajo copë xham i vogël. Qe errur dhe në fytyrë s'dalloheshim dot. Ai s'm'u përgjigj.

— Hajde pra, — tha Maksi — bjeri, se na mbiu në veshë kjo uturimë «vu, vu».

— S'kam qejf — foli ai ftohtë dhe heshti.

— Ore, je në të ti, apo jo, — thirri Andrea — merre kitarën. se... ja këtu ma ke sjellë sot. Dëgjove? — Më erdhi të qeshja me Andrenë.

— Më lini, ore, rehat, — u përgjigj disi i zbutur Fati — s'jam në qejf. I bihet kitarës kështu?

— Merre, Fati, na le pa bukë, tani na jep ushqim për shpirtin — u përpoqa të bëja shaka. Andrea u ngrit, mori kitarën nga muri dhe ia lëshoi në gjoks.

— Hajde, — tha — çohu, je, s'je në qejf, bjeri për qejfin tonë. Zëre se na e ke borxh, borxh tamam na e ke! Çohu! Hajde!

— Më lër, — klithi Fati — qenke i çuditshëm, mirë, i bie, kështu doni ju? Na — U dëgjua një akord i mbytur.

— E, ashtu — tha Andrea dhe u shtri. Më erdhi prapë për të qeshur. Nikoja kishte mbuluar fytyrën me pëllëmbë, qeshte dukej, se shtrati i luante. Flaka hidhte një dritë të kuqe mbi mure. I hodha një dru zjarrit. Kitara lëshonte ca akorde të rënda e të zvaritura. «Do të na mërzhitë, mendova, që t'i themi: «Lëre, se na çave kokën.» Pashë jashtë. Errësirë e bardhë. Sa e bukur ishte kjo! Vendi dallohej deri tej te gryka, ku ngrihej një shkëmb i madh shtufi që Maksi e quante kafe «Flora». Kishim më tepër se një muaj këtej. Fshatarët kësaj ane ishin njerëz të mirë e të dashur. Por mamaja ama ishte e mërzhitur dhe thoshte se tani kisha bredhur mjaft me ekspeditat dhe duhej... po, po, mamaja e hidhte fjalën për nusen. Ç'është e vërteta, dhe unë s'isha plotësisht i qetë, nganjëherë diç më mundonte. Rregullova batanijen te këmbët. Dëgjova kitarën. Papritur m'u duk se këto akorde u shkonin shumë ambientit, asaj nate të zbardhur nga bora, gjendjes sime shpirtërore. Flaka qe shtuar në sobë. Pashë siluetën e Fatit. Ai ishte përkulur mbi kitarë dhe mbi kokën e tij njolla e flakës lozte në mur. Vura duart nën kokë. Tani s'ndieja asgjë, veç kitarës. Nga kjo zgavër druri vërtitëshin pa fund tinguj, tinguj, ca të shkurtër e ca të prerë, ca tingëllues e që dridheshin në qetësinë e nderë të natës. Oh, ç'ndjenjë ishte kjo?! Tingujt, njeri më shumë e tjetri më pak, kanë hapësirë. Dhe njeriu kurdoherë ka qenë i prirur për hapësira

të mëdha. Atëherë e ndien pushtetin e pafundësisë dhe nuk e lidh veten me fijet e ngushta të meditimeve personale, por me diçka tjetër... ndoshta me meridianë, paralele... ndoshta më tej. Sa qenie e bukur dhe e komplikuar është njeriu! Ai është krenar si asnjë qenie, ai dashuron si asnjë qenie, ai urren si asnjë qenie, është i fortë e stoik si asnjë qenie, është i thyeshëm e delikat në shpirt si asnjë qenie. Me këmbët e mbështetura mbi këtë dhé të dashur, ai u kthen fytyrën erërave. Bota është e madhe. Netve ndritin yje dhe nebulozat e mjegullnajat, me atë dritën vezulluese blu, nëpërmjet hapësirash të pafundme, të ngjallin në shpirt kurdoherë një mallëngjim të pashpjegueshëm. Dhe globi vërtitet e vërtitet. Një mbrëmje, lart te stanet, gjetëm një bari. Ai qe shtrirë me duart nën kokë e shikonte yjet. Kur na pa, u turpërua dhe i erdhi rëndë. Njerëzit janë të ashpër këtej e s'i shfaqin kollaj ndjenjat. Pastaj na tha se u kishte vën emra yjeve, emrat e kopesë së tij.

— Ja, — tha — atij ylli që del gjithmonë vonë, një hosten mbi majën, i them Berka. Berka është delja më e bukur e kopesë, e njihni? — tha. Ne e pyetëm se pse ia kishin vënë kështu emrin.

— I ngjan — tha .

— E nga e kupton se i ngjan?

— Ku di unë, — tha — po ja... i ngjan — dhe, nën dritën e zjarrit, pamë se u skuq prapë.

Fati ishte përkulur mbi kitarë dhe mbi kokën e tij njolla e flakës lozte në mur. Kur isha fëmijë dhe lexoja libra, më formohej shembëllimi i një bote të tillë. ngjyra-ngjyra, plot reflekse e kontraste që të ngjallnin klithma mahnitëse, shembëllimi i një bote të tillë si tani nga tingujt. Poo... e qan ai. Eh, Fati,

Fati... ti e mban mend, të gjithë u nxehtë kur ti i the Maksit: «...Lëre, politikë do na bësh, politikën e di unë.» Ishte dita kur na kishte mbaruar afati dhe ti deshe të ikje. Çudi si është kjo punë! Njeriu që ndien dhe bile prodhon bukurinë e tingujve, si është e mundur që vetë të mos ndiejë bukurinë e vërtetë të të jetuarit?!

Turma e tingujve shpërndahej e mblidhej. Bënte figura, figura të çuditshme si gjuhëzat e flakës që hidhnin vallen e tyre në mur. Ata kërcenin të lirë e të pabindur në vallen e tyre tekanjoze, kërcenin si kristale të padukshme, si kristalet e borës, me forma të ndryshme, të paimagjinuara. Ata dridheshin e dridheshin, formonin shtjella e vorbulla ku ti zhyteshe e ndiejë kënaqësinë më të madhe.

Pata të nxehtë, zbërtheva xhupin. Tingujt herë-herë holloheshin e thoshe se do të këputeshin diku, kur ja, mblidheshin prapë dhe, para teje, dilte imazhi i një lumi të fuqishëm, pastaj ti humbje dhe shihje përpara një oqean të tërë. Tingujt ngadalë po zbuteshin. Po, ata e lanë atë valle plot teka, gjerësia e tyre u rrit. Ata u futën brenda mendimeve të mia dhe mua m'u duk se aty-këtu, ndonjë shqetësimi im për ato që thoshte mamaja, ishte i kotë. Të gjitha do të shkonin mirë. Ne kishim një detyrë të madhe këtu. Pas nesh vinin dritat, makinat e reja, këtyre anëve me relief të ashpër. E ndjeva veten të lehtë, të lehtë. Më dukej se shikoja nga një majë mali me një shikim të tillë depërtues që nënshtronte mjegullat e largësitë. Fati rrihte telat. Me ata pesë gishtërinj ai kishte lidhur një botë të madhe, hapësirë, sa shumë hapësirë dhe diej. Shikoja larg. Po, ne kishim vështirësitë tona dhe hallët tona, bile edhe gabonim ndonjëherë. Por, kur ngjiteshe

kështu në maja të tilla, këto të gjitha dukeshin kaq të vogla, kaq të parëndësishme. Eh, Fati, Fati! Zgavra e drunjtë kumboj dhe heshti duke u shuar ngadalë. Ai mbështeti ballin mbi drunë e saj. Vetëm atëherë e vura re Andrenë që rrinte në cep të shtratit, pranë tij.

— Dëgjo, Fati — mundohej të ulte zërin Andrea — mos guxo kurrë të veprosh si sot dhe t'i bësh të tjerët të mendojnë se në shpirtin tënd ka qoftë dhe një për qind poshtërsi, dëgjon? Një njeri si ti, që... që ndien kështu si ti, që i bie kitarës kështu, duhet të jetë i pastër, si... si një pikë loti, dëgjon? — dhe e tundte nga supet. U përpoqa të buzëqeshja. Zëri i trashë i Andresë mbushte kasollen, kurse ai kishte përshtypjen se po pëshpëriste.

— Ç'ke, Fati, — tha — ç'ke? Hajde, mos u bëj budalla tani. — Fati dëneste me kokën zhytur në jastëk. «Po, mendova, Andrea e tha mirë atë, ashtu është.» U çova. Vura një cigare në buzë.

— Ndize! — i thashë Andresë. — Ndize! — i thashë dhe Fatit dhe ia ngrita kokën nga jastëku. — Hajde. ti je shoku ynë — dhe e shkunda nga mjekra e njomur.

## HARTIMI I MATURËS

Klasa zien. Gimi vërtitet midis bankave me stilograf në dorë:

— Një pikë bojë, një pikë bojë, u fika, gjysmën e mbretërisë për një pikë bojë.

— Ha, ha, edhe sot s'e ke mbushur stilografin? Na, or shkatarraq, na, pa s'e dua atë farë mbretërie!

— Hapni dritaret, hapni dritaret! Frymëzimi s'është plesht të hyjë nga vrima e çelësit — thërriste Tosi.

— Uf, mi goca, katër herë më ka dalë gjumi sonte natën, ja... ta shihni, ju, po s'u fika unë sot.

— Pusho pra, Merita, pusho, se kështu e ke ti gjithmonë, mirë do dalësh. — Elsa hesht dhe shikon jashtë.

— Mori fund, kjo është tema, e di unë, ma tha djali i xhajës, hë, mor... ai, e njeh ti, Gimi. Kjo është tema, e di unë — thotë Hysniu dhe përplas pëllëmbën mbi bankë. Hapet dera. Klasa ngrin. Një pjesë çohet në këmbë.

— Hëm, hëm! — kollitet Pirroja. — Mirëmëngjes, të dashur nxënës, mirëmëngjes!

— Ik, ore!

— I poshtri, na ngriu gjakun, ha, ha, ha!

— Shësht... shësht... erdhën.

Në klasë hyn Meli, mësuesja e letërsisë, nëndrejtor Gaqoja dhe një burrë tjetër, siç duket, nga seksioni.

— Mirëmëngjes!

— Mirëmëngjes!

— Qenkeni shpuzë sot, me sa shoh, ë? Hajde, Meli, mos i mundo. — Dhjetëra sy ndjekin çdo germë që lë shkumësi mbi shkëlqimin e dërrasës së zezë. «Si e mendoni të ardhshmen dhe rolin tuaj në të..» Pëshpëritje.

— Hajde, bombë fare.

— Ik, ore, ik, ore, me gjithë atë djalin e xhaxhës, na e bëre mendjen çorbë fare.

— Ja, mor vëlla, si kjo po, si kjo e desha.

— Kujdes! — porosit mësuesja. — Kohë keni, mos dilni nga tema, mos u nxitoni!

Pak nga pak klasa zhytet në qetësi. Ndihen hapat e nëndrejtor Gaqos. Mësuesja dhe ai nga seksioni shkojnë të japin temën në klasën tjetër. Elsa ka mbetur ashtu, me stilografin te buzët. Shikon shokët. Dikush ka nisur të shkruajë me kokën ulur, dikush ka ngulur vështrimin diku, i përqëndruar.

— Elsa, Elsa, kam shënuar ca shprehje të njerëzve të mëdhenj, — pëshpërit Merita — po të duash, të jap ndonjë, do?

Elsa tund kokën.

— Jo! — I vjen për të qeshur. «Maturante, thotë, jam maturante dhe ja... provimet e fundit.» Shikon bankën e saj, banka e dytë nga dritarja. Kujtimet janë gjëra interesante, ato janë si ata filmat pa zë që i riprodhon me ç'shpejtësi të duash.

Dielli del që pas kthesës së murit dhe rrezet e tij vërshojnë midis bankave.



— Hë pra, tani, po, — merr frymë thellë Gimi  
— e shihja që diçka më mungonte, po se çfarë...

— Qetësi, djem!

Elsa lë stilografin dhe vë kokën e saj të bukur në mes të duarve. «Si ta filloj?» Nga kati i tretë duket oborri plot diell. Ca fëmijë të vegjël ndjekin njëri-tjetrin. Fije të bardha resh janë përhapur në atë qiell të kaltër qershori. Ndihet një zhurmë aeroplani. Pas pak ajo i shquan. Janë dy, fluturojnë çift në lartësi të madhe, duke lënë pas fjolla të bardha që zgjerohen gradualisht. «Nesti?! Po sikur të jetë ai?! mendon. Ai e di që sot kam hartimin.» Dhe i duket sikur e sheh atë në kabinë, me shlemofonin në kokë, ashtu siç e ka në fotografi. Dhe ai i thotë: «Mos u tremb, mackë! Nëse do të bëhesh gruaja e një piloti, s'duhet t'ia dish fare nga provimet.» Dhe qesh. Qesh dhe ajo. «Çudi, thotë, si ndodhi gjithë kjo... i miri im, i dashuri im!»

Para dy vjetësh në një lojë që bëhej me kartolina, ajo mori një kartolinë me qiell të kaltër, të kaltër, ku vezullonin krahët e një avioni mbi konturet e murrme të maleve. Prapa shkruhej: «S'e di kush je dhe si je ti. Sidoqoftë, qofsh e lumtur dhe e pafsh lumturinë nga lartësitë tona, nga lartësitë e pilotit!» S'e dinte se ç'e shtyu t'i shkruante letër atij djaloshi pa e njohur akoma. Pas ca kohësh ai u bë i dëgjuar për një vepër heroike. Në atë kohë, ata kishin shkëmbyer bashkë disa letra dhe ajo ndiente t'i rrihte fort zemra, kur lexonte në gazetë emrin e tij. Kur e ftuan në qytetin e tyre bashkë me një shok, u organizua dhe një takim në shkollë. Pastaj ai pyeti për të. Ajo shkoi drejt tij dhe i dha dorën. Qenë të dy të skuqur e të hutuar, por ai e mori shpejt veten.

«Më fal, Elsa, i tha, s'e mendoja se mund të ishe kështu... kaq e bukur, kaq... si të them, e mirë.»

Ajo ishte skuqur dhe më shumë. Shoqet e ngacmuan. U takuan prapë të nesërmen. Pastaj ai iku në repart.

Togu i letrave në komodinën e saj shtoej. Nganjëherë e merrte malli shumë dhe mendonte për të. Kështu e gjeti një natë e ëma. Ajo e përkëdheli, e puthi. Para dy javësh ai kishte ardhur tek ata në shtëpi dhe, megjithëse tani e njihte mirë atë si të guximshëm, atij disa herë i ishte marrë goja kur fliste me të atin e saj. «Më falni, sh... shokë Kristo, nuk... nuk mundem, n... nuk mund të pi më, nesër kam fluturim.» Të nesërmen kishte ikur pa gdhirë. Ajo s'u përmbajt dhe e puthi. E panë edhe nëna, edhe Goni i vogël, kur e puthi. Për një kohë të gjatë ajo ndiente në mollëzat e gishtërinjve fëshfërimën e xhakaventos së tij.

— Elsa, moj budallaqe, s'ke shkruar fare ti?! Iku gjysma e orës, unë i mbusha dy faqe — flet Shpresa ngadalë. Hysniu lëshon stilografin dhe shtriqet ashtu mbi bankë. Seç e pyet Pirroja.

— Më ler, — ia ktheu ai — tani po fluturoj në të ardhshmen.

Elsa hedh fjalën e parë, fjalinë e parë: «Një hartim për të ardhshmen, është një hartim për lumturinë.» Mbi vijat e letrës, mbi shtresat e gishtërinjve të djersitur, të mbetura tek-tuk në fletore, dynden mëngjese me diell, gulçe motorësh, lëvizje njerëzish, fishekzarë, buzëqeshje. Ajo shkruan dhe shikon një vajzë me kominoshe që bredh skelave dhe komandon uljen e soletave. Flokët i ka lidhur pas dhe duket sikur dielli dhe era e lehtë e përshkojnë tërë trupin e saj të brishtë. «Shoqja inxhinieri, shoqja inxhi-

niere... ju kërkujnë... një oficer.» Ajo vrapon drejt tij. «Nesti, Nesti im.» Punëtorët e rinj e shikojnë me vërejtje. Xha Taqoja i shkon gjuhën kartës së cigares. «Ëhë, djalë, po, djalë... ç'i ka ato shenja? Pa dale... pillot, pillot qenka,» dhe vë buzën në gaz. Kurse ajo rend drejt tij.

Elsa merr frymë. «E humba fare,» psherëtiu ajo. Hedh sytë nga dritarja. Rruga e saj. Këtej ajo vjen në shkollë. Kalojnë makina. Një shofer i bie borisë, nxjerr nga kabina trupin muskuloz dhe i thërret dikujt që i ka zënë rrugën. Njerëzit lëvizin, lëvizin me shpejtësi. «Njerëzit sikur lëvizin më shpejt tani, thotë ajo, çudi, si s'më kishte shkuar ndër mend më parë, sikur ka më tepër gjallëri e dinamizëm në ta tani... kurse unë... kurse unë nga këto vite të shkollës vetëm ditë me diell mbaj mend... sa çudi...» Dhe zhytet përsëri në temë. E ardhshmja është nesër, pasnesër... muajin tjetër, vitin tjetër... vitet e tjera; ka njerëz, ngjarje, çaste. Ajo shikon si nëpër një mjegull të butë, të këndshme, skelat e objekteve, veten e saj, fragmente pune, rrëke shiu që i rrjedhin në fytyrë, vinça që tundin qafat e gjata, xha Taqon që i vë dorën në sup, zëra, një mbledhje, sekretari i Partisë i dorëzon diçka të kuqe, zëra, urime.

«Ah, mama, sa e lumtur që jam! Ajo zë sytë me dorë. Dhe tani e ndien veten akoma më të fortë; dritës së diellit i është shtuar një tjetër më e fuqishme, drita e Partisë. Dhe ajo e ndien këtë duke ecur ashtu me kominoshe, duke menduar për problemet, për punën. Fjala e Partisë ushton edhe nga gjoksi i saj, ushqehet edhe nga gjaku i saj. Ditët e ardhshme bien mbi njëra-tjetrën si fasha drite, njëra më e ndritshme se tjetra, ashtu si fashat e dritave të makinave, mbi murin e errët të dhomës tënde të gju-

mit. Dhe ajo shkruan dhe buzëqesh. Dhe Nesti buzëqesh, dhe shokët e saj të punës buzëqeshin. Reflekse, kryqëzime rrugësh, hapësira. Ajo shkruan. Dhe Merita shkruan, ndërsa letra me thëniet e njerëzve të mëdhenj i është zhubrosur aty nën bërryl. Shkruajnë dhe Maksi, Iliri, Pirroja, Shpresa e Vjollca! Në fytyrat e tyre ka rënë një çehre e bukur e frymëzuese. Elsa shkruan, shkruan. Gërmat i hapen, shkrimi i bëhet i gjerë dhe fjalët i mbeten të përgjysmuara, ajo do të flasë shumë, do të thotë shumë. Në klasë dëgjohen hapat e nëndrejtor Gaqos. Elsa tani s'e ka mendjen aty. Ajo s'e shikon një zog të vogël e të bukur me push të verdhë e sy të shkëlqyer, që çukit diçka në parvazin pranë saj. Ajo është përpirë e gjitha nga një ndjenjë e bukur dhe e fuqishme. Ndien paaftësi për t'i thënë të gjitha. Ajo merr frymë thellë, thellë. Dhe shkruan.

## ROJA E DASHURISË SË MADHE

Pastaj ai më tha ta dridhja një nga qesja e tij prej plastmasi. Po unë rrallë kisha pirë duhan të dredhur dhe i zgjata paqetën time.

— S'i pi dot ato, — tha — janë të buta. Ndeza një nga të miat, kurse ai mori me gishtërinjtë e trashë një shuk duhani dhe e shtroi mbi letrën. Hesh-tëm një copë herë.

— Nuk jam kaq i sertë unë, jo, — tha ai — po ai djalë ma pruri atje ku s'mban. — I shkoi gjuhën letrës dhe u ngrysi në fytyrë. Unë thithja cigaren dhe shikoja me vëmendje çdo tipar të atij burri. Ishte roja i kooperativës. Dikush ishte ankuar për të dhe më kishin dërguar mua të shkoqisja çështjen. Puna që se ai kishte gjetur natën dy të rinj dhe që sjellë keq me ta. Djali që u ankua, thoshte se i kishte sharë me fjalë të ndyra.

— Kur ndodhi kjo? — pyeta unë.

— Javën që shkoi — tha ai. — Dëgjo, more shok, ore, unë nuk jam i humbur e prapa botës, as konservator, siç tha ai karafili, nuk jam, jo...

— Mirë, — i thashë — ti mund të ishe treguar më gjakftohtë me ta.

Ai më pa drejt në sy. Kishte sy të butë e të

përhimtë dhe mua s'di pse m'u mbush mendja se ky njeri duhej të këndonte bukur.

— Në qytet je rritur ti?

Bëra «po» me kokë.

— Po yt atë?

— Fshatar ka qenë — thashë.

— E mirë, pyet atë atëherë, ta dish. S'them se jeni të ligj ju të qytetit, po e drejta është se ca gjëra s'i dini mirë. Ja, të mos ketë furra miell për të gatuar bukën që bleni ju, nxeheni dhe shani. Mirëpo buka nis që këtej. Na bie bretku ne këtu, o shok. I thonë fabrikë, po fabrikë pa çati. Sa e ëmbël, aq dhe e hidhur është toka. Kam një mbesë në qytet, e ka shtëpinë në katin e pestë. Mban lule në ballkon, i ujdís e i ujit, i këputet shpirti për to. Po ç'janë ato? Pesë rrënjë lule janë. Kurse ne këtu na dridhet zemra për çdo filiz që mbin arave. Ka edhe të ligj, s'them që jo, po njeriu që është njeri, duhet ta nderojë djersën e tjetrit. Ti s'e njeh Zeqon, agronomin tonë. Nga qyteti është dhe ai. As Velinë s'e njeh ti, që bën bé për grurin. Nuk i njeh ti, jo. Nejse. Po pa më thuaj, ore, si të isha gjakftohtë, ë? Ata të dy, djali me çupën, kishin ndenjor në grurë, aty te rendimenti i lartë. Ishte vonë, po kish hënë e dukej si qe rrëzuar gruri në një copë vend të mirë ku qenë ulur. Tani nuk them unë, të rinj janë ata, edhe ne vetë ashtu kemi qenë njëherë. U vlon zemra... po u vlon o u vlon, po pse, Zeqo agronomit nuk i vloka, a? Pse, nuk është i ri Zequa, që s'shkoi fare këtë javë në shtëpi, që një muaj ka fejuar? Këtë më thuaj mua ti. Jo, or shok, se s'është llaf ky. Ti thua gjakftohtë, po sytë ku i kishin ore, nuk e panë grurin që ish bërë për drapër? Këtë më thuaj ti, ku i kishin sytë që u plaçin atje tek janë.

Ai shau dhe pastaj e zuri kolla, një kollë e fortë duhani.

— Mirë, — thashë — i shpije në kryesi të paguanin dëmin dhe udhë e mbarë.

— S'ish puna te dëmi... s'më more vesh, jo. Le që ç'kryesi, ish natë, të thashë. Mor, po unë vetëm i shava. Po atyre u erdhi si çudi. Çupa, ç'është e drejta, uli kokën, kurse ai m'u kthye si kapadai. «E punë e madhe, tha, se u prish dy pëllëmbë grurë.» Më tha edhe se unë qenkam me të vjetrën, qenkam koservator, s'e dashkam rininë e një tog si këto. Hyt, i thashë, sikter që këtej, jezit i jezitit... O... o po e kërkonte ai, pa unë s'jam i sertë, or, jo. Qenkam kondra dashurisë, tha. Pse, të duash djersën e mundin e njeriut, s'qenka dashuri, a? Më thuaj ti, a bëhet dashuri mbi dashurinë? E po dëgjomë mua, një dashuri që shkel mbi një dashuri tjetër, është o e gënjeshtërt, o e lehtë nga mendtë, ta them unë këtë. Ndaj dhe i shava më shumë, për këtë.

Ai shoi bishtin e cigarës pas plisit ku qe ulur dhe mori frymë thellë. Në rrugë zhurma e makinave rritej e humbiste përsëri ngadalë. Ai thërrmonte një copë plis në duar e s'fliste. Ndenja dhe një copë herë me të dhe pastaj i zura dorën fort e dola në rrugë të gjeja ndonjë makinë. Po mendoja për atë burrë: «A bëhet dashuri mbi dashurinë?» Sa bukur e tha këtë! Vërtet që ashtu ishte.

Grunjërat ndanë rrugës përkuleshin nga era. Ato qenë në kohën e dyllit, siç thonë, dhe unë mendova se këto ditë aty do të zhurmojnë autokombajnat. Ktheva kokën pas, po roja kishte humbur larg e ishte shkrirë me grurin. Dhe, befas, s'di si më erdhi në mend se këtë roje mund ta quaje roje të dashurisë, po, roje të dashurisë më të madhe, të bukës. Kështu ishte.

## MINIATURA

1.

Të dy partizanët qenë shkëputur nga shokët. Tri herë u përpoqën të hidhnin përroin e thatë e të tri herët bënë zjarr me gjermanët. Lekoja kishte një plagë në shpatullën e majtë, kurse Ndinit i qenë copëtuar keq këmbët e mezi i hiqte zvarë. Në fshatrat e asaj zone ishte gjermani dhe ata shkonin monopateve. Qenë të uritur. Ishte e treta ditë kjo. Ecnin dhe s'flitnin, «Si bëhet njeriu!» mendoi Lekoja. Nganjëherë, të hedhësh një fjalë, qenka më e lodhshme se të hedhësh një bombë.» Ata po dilnin në qafë. Befas, përpara u hap deti.

— Oh, nëne, — tha Ndini — oh, deti, ë? — dhe u mbështet ngadalë në tokë me trupin të zgjatur andej nga frynte ai fllad i freskët.

— Deti! — tha Lekoja. Ai mori frymë thellë dhe u shtriq. Pastaj i theri shpatulla dhe ajo ndjenjë kënaqësie iu përzje me dhembjen e hidhur.

— Sa i madh, ë? — tha Ndini. — Si qenka kësh-tu! — dhe qeshi si fëmijë. — Është shumë thellë aty, ë?... O nëne, sa i bukur, gjer ku vete ky?

Ndini rrinte ashtu mbështetur mbi bërryl dhe fytyra i kishte marrë një shprehje të tillë sikur po



matej të thithte gjithë atë masë uji të kaltër që u qe shpalosur përpara. Lekoja qe shtrirë dhe shikonte me vëmendjen në gropën e gjoksit të tij, ku një mizë dheu bënte përpjekje për të dalë nga djersa që i kishte mbytur kraharorin. Kishte kaluar mesi i ditës dhe dielli kishte nisur të thyhej lart.

— O Leko, po ty, këtej të shpunë për në Itali, ë?

— Këtej, — tha Lekoja dhe buzëqeshi — me anije. Kur erdha pastaj, u fsheha në hambarin e një peshkarexhe.

— Jo, more! — u çudit Ndini. Heshtën të dy për një hop.

— Mirë, po andej Itali është e gjitha, ë? — tha Ndini.

— Italia, poshtë është Greqia, pastaj këtej është Afrika. Lloj-lloj vendesh janë.

— Hej! — tha Ndini. — Sa e madhe është bota!

Lekoja e pa. Ndini i kishte sytë pothuajse bojë deti me ca nuanca gri. «Ç'mendon ai, tha Lekoja me vete, ç'mendon?»

Ndinit i kishte rënë bustina mbi bar dhe flokët i loznin nga era.

— Ky bashkoka gjithë dherat e botës, ore! — tha Ndini. — ...Sa i bukur! — tha pastaj si me vete. Lekoja lëvizi dhe u afrua pranë tij. Dielli i vakët i marsit u ngjallte një ndijim të këndshëm mbi shpatulla.

— Dëgjo, Leko, — tha Ndini — ne nuk luftojmë vetëm për tokën tonë, edhe për këtë luftojmë, ë? Edhe për detin.

— Po, — tha Lekoja — edhe për këtë luftojmë, Ndini. — Të dy shikonin larg. Që poshtë vinte dhe

shuhej në veshët e tyre oshëtima. Ajo gjuhë e përjetshme diç u thoshte dy partizanëve të kapitur.

## 2.

Atëherë qenë kohëra të vështira. E vjetra qe sulmuar e goditur keq nga të gjitha anët, por ajo, nga re, që kthyer në mjegull dhe endej në jetën tonë, midis shtëpive, midis njerëzve, midis fshatrave, midis qyteteve. Shekulli akoma s'e kishte mbushur gjysmën e moshës së tij. Atje në Kovesh, Dodë Deliu rrinte e priste te shkëmbi i vetmuar. Ishte ftohtë dhe gishtërinjtë në opinga s'i ndiente fare. U dëgjuan hapa. Ai mbështeti faqen pas pushkës dhe i shkuan mornica si ta kishte mbështetur pas akullit. Nuk binte shi, por kishte gjithë ditën që retë, të nxira si me blozë, venin e vinin nëpër qiell, nxituar nga një shqetësim i etur. Përreth ishin malet. Ata rrinin bashkë, sup më sup. Vetëm shkëmbi i vetmuar sikur qe shkëputur prej tyre. Dukej sikur vështrimi i ngrysur i maleve i thoshte: «Ti je i përgjakshëm, je mizor, vetëm të rrish gjithë jetën.» Njeriu u duk në shteg. Dodë Deliu mori frymë thellë. Ca shkarpa kërcitën dhe ai që vinte, ngriti kokën.

— O Ndrecë Pjetri, — thirri Doda — a e mban mend Marash Deliu? Të bën selam e të pret t'i vesh. Hajde, fal me shëndet!

Plumbi i parë e zuri Ndrecë Pjetrin me dorën në pushkë. Malet vetullngrysurat të shtatë plumbat i bënë shtatëdhjetë krisma. Jehona klithi si një shpend ogurzi. Ç'mund të bënin tjetër malet, veç se t'i binin çangës së hapësirave? Ai qe mbështetur te një dru i përzhitur nga rrufeja dhe mbahej te gdenjat e trun-

gut. Pastaj ra ngadalë. Xhokja i qe skuqur nga gjaku. Edhe gjer poshtë nën gju, nga poturet e leshta, i rridhte një pizgë e hollë. Vendi kundërmoi erë barut. Dodë Deliu u afrua. Gryka e pushkës digjte. I ndenji dy hapa larg dhe e pa. Hodhi armën në krah. Kur u kthye, dëgjo i rënkimin e tjetrit.

— Bjermë këtu në gjoks, o Dodë Deliu, se plumbi më ka marrë në ije e s'dua të vdes ashtu... — mezi mundi të shqiptonte i plagosuri. Vrasësi vuri dorën në armë instinktivisht. Vështrimet u përplasën. I rëni kafshonte cepin e mustaqeve dhe përpiqej t'u zinte frymën rënkimeve. Larg bubulliu. Dodë Deliu tha:

— Falur të goftë gjaku, o Ndrec Pjetri! Qenke burrë. Po jetove, jeto!

I rëni shihte malet e s'fliste. Dhe malet shihnin ata të dy dhe s'flitnin. Dodë Deliu çapiti dy orë rrugë me Ndrecë Pjetrin në kurriz. Gjaku i lau të dy. Në kullën e tij, sa e panë, gratë vunë kujën. Po ai u flaku vështrimin e tij të ngrysur dhe i meku të gjitha.

— Pllakosjani plagët me hirrë e më gjalpë të tretur — thirri.

Dhe jetoi Ndrecë Pjetri.

### 3.

Ata qenë tre vetë në tryezë. Qenë djem të rinj. Pinin birrë dhe qeshnin. Ai që qeshte më shumë e që rrinte në mes, befaz u ngrit e dikë thirri me dorë. Pastaj u tha shokëve:

— Pritni, tani do shihni gallatë — dhe u shkeli

syryn. I ardhuri u dha dorën të treve dhe u ul si me drojtje. Dukej që në moshë pak më i vogël se ata.

— Kamerier! — thirri ai që qeshte më shumë.

— Gim, — iu kthye pastaj atij që erdhi — ia lage sot përgjegjësit, ike më parë se të lihej puna, ë?

— Jo, mora leje, ashtu kisha diçka — tha ai.

— Punë zemre, ë? Eh, qerrata! — Ai që qeshte më shumë, i luajti syryn dhe u shkeli këmbën shokëve, nën tryezë. Gimi buzëqeshi dhe tundi dorën.

— E dini ç'greh është ky? S'i del bosh kurrë — vazhdoi ai që qeshte më shumë. — Kamerier, katër birra e katër meze, hajde, se mos mban kalamanjtë me bukë Gimi.

— Vajzave u pëlqejnë leshverdhët — tha ai që ishte djathtas. Qeshën të tre. I ardhuri vuri buzën në gaz përsëri. Këmbët nën tryezë luajtën.

— E ke një ti, kot s'të shoh nga mëhalla ime, jo. — Ai që qeshte më shumë, tundte gishtin dhe pinte birrë me gllënka të mëdha. — Hajde, pa na i trego, si e rregullove... a qerrata, për nder s'ikim këtej pa na e thënë. — Këmbët nën tryezë luajtën. I ardhuri piu birrë dhe u mundua të buzëqeshte.

— Sekret profesional, s'e thotë — tha ai që s'kishte folur fare gjer atëherë.

— Kamerier, katër birra!

— Hë, pra, Gim, para një jave ti më lexove dhe një vjershë ku flisje për dashurinë tamam si ata poetët, hë pra. — Ai që qeshte më shumë, u shkeli përsëri këmbët atyre që kishte anash. Gimi tani e kishte shumë vështirë të buzëqeshte. Fytyra e tij tani ishte si një qiell ku grumbulloheshin parreshtur re. Ai e ktheu gotën e tij.

— Oho, eks! Eh, ç'bën dashuria! — tha ai që

rrinte djathtas. I ardhuri vuri duart mbi tryezë dhe u mbështet në shpinën e karriges.

— Dëgjo, — i tha atij që qeshte më shumë — thashë se mund të bëheshim kunetër të mirë, po s'qenka gjë. Jot motër më do dhe e dua. Ja pjesa ime, pini dhe nga një birrë për shëndetin tim dhe për atë që dua unë. — Përplasi të hollat mbi tryezë dhe doli.

Ata të tre mbetën të shtangur. Këmbët nën tryezë s'luajtën më.

#### 4.

Ai ishte tren që vinte nga Laçi. Koha ishte e keqe. Shumë udhëtarë qenë të mërzhitur. Shkreptinte. Në xhame, pikëlat e shiut linin ca trajektore të lakuara që hapeshin nga era dhe pastaj mbuloheshin nga të tjera pikëla. Lulet e diellit, të mbjella djathtas, kishin ulur kokat.

— Janë pjekur — tha një plak.

— Jo, — qeshi një djal i ri — mbajnë zi për diellin, prandaj rrinë ashtu, turivarura.

Një grua mundohej të largonte fëmijën nga dritarja dhe, sa herë që shkarkesa griste peizazhin e murrme të reve e të rrëmbente sytë, ajo rrëqethej dhe nga goja i shpëtonin ca tinguj, sikur thithte diçka. Dhe atëherë, shumë nga udhëtarët panë ata të dy, një vajzë e një djalë, 50 metra larg vijës së hekurt, nën lulet e diellit që pikonin. Mund të qe ashtu siç thuhet nëpër këngë, traktoristi dhe brigadierja, agromomi dhe mësuesja e fshatit, brigadieri dhe mjelësja... po kjo s'kishte rëndësi. Sa herë shkrepinte, ajo i tulitej në gjë si një zog i lagur. Shiu u rridhte në fy-

tyrë, në cepat e buzëve. Atij i qe ngjitur këmisha në shpatulla. Rrinin ashtu në këmbë dhe dukeshin si një përmendore e vërtetë e dashurisë. Udhëtarët heshtën. Në një mot tjetër, ata dy çapkënët e vegjël do të fishkëllenin. Ai burri serioz do të mbulonte pamjen e tyre me gazetën e hapur e do të thoshte nëpër dhëmbë: «Të pacipë!», kurse kjo nëna këtu do të mbyllte perden që të mos shihte vajza e saj. Por tani asnjë nga ata që i panë, s'luahti e s'foli. Vetëm kur treni kaloi fushën, një plak psherëtiu e diç tha mbyturazi. Ndoshta tha: «Eh, rini, rini!»

Derdhej shi. Ata mbetën pas nesh. S'kishte diell, por mijëra diej-lule kishin varur kokat përmbi ta.

## 5.

Montatorët kishin mbrëmjen e fundit në kantier. Në mensë ishin rregulluar tryezat. Drejtori i kantierit mbajti një fjalë të shkurtër, pastaj u ngritën dollitë. Xhezoja, që dimër e verë përvishte mëngët, tha:

— Tani për dama do të caktojmë ca shokë që... domethënë të lozin rolet e tyre. Natyrisht duhet gjetur se kujt i përshtatet ky rol. Ja, për shembull Nesti, Isufi... edhe Coli nuk del damë e keqe. Ta hedhim në votë.

Montatorët qeshën, kurse Coli e gjuajti Xhezon me një copë qepë. Leni u skuq. Leni ishte e vetmja vajzë midis montatorëve. Djemtë bëheshin mbi pesëdhjetë. Unë iu afrova asaj te veshi dhe diçka i thashë. Ajo qeshi dhe më goditi në sup. Pastaj filloi orkestra.

— Shoqja Leni, — Arbeni kishte marrë një pam-

je solemne — sot ju është ngarkuar një detyrë e vështirë që mund t'ju lodhë më shumë se ndërtimi i krejt objektit.

— Mirë, — ia preu Leni — meqë ma qake hallin, që të lehtësohem pak, me ty s'do të kërcej, mos m'u lut, apo s't'i bën copë këmbët ti.

Shokët qeshën me të madhe, kurse Arbeni vuri duart në kokë. Pastaj për Lenin filloi maratona. Montatorët ia merrnin nga duart shoku-shokut dhe ajo rrotullohej e rrotullohej duke qeshur dhe flokët i hapeshin pas. Në qoshe të sallës kërcenin dy-tri çifte djemsh.

— Ej, — thirri Maqoja — ju, ju atje, kategoria e tretë! Mësoni, o burra, djem, mësoni. Duhet kualifikim, pa të vini te Leni.

Leni e la Xhezon dhe shkoi të merrte Nduen. Ai e pa dhe u skuq.

— Jo, jo, — tha — s'di, për ideal s'di. — Iu shkëput Lenit nga duart dhe shkoi pas tryezave. Ajo e ndoqi pas.

— Hajde, buf, hajde, — thërriste Arbeni — ngrehu, ore, të thonë, merr vesh, vij në dhe e lutin bufin.

— Ngrehu kërce, se të nxorëm jashtë!

— Ngrehu de!...

— Ore, po nuk...

— Mirë, mirë, hajde, se mësojmë bashkë — i tha Leni dhe e tërhoqi. Ndueja rrinte si kërcu dhe të gjithë qeshën. Ndenja dhe ca, pastaj u ngrita të ikja. Falënderova dy-tre prej tyre për ftesën, i bëra shenjë me dorë Arbenit e Lenit që kërcenin dhe zbri-ta shkallët. Rruga për në qytet ishte e shkretë dhe unë zura të fishkëlleja. Pashë një siluetë përpara

dhe nxitova hapat. Kur jam i gëzuar, s'kam qejf kurrë të eci i vetmuar. Ishte një djalë i vogël.

— Po ti, — i thashë — ç'bën kaq vonë, ti?

— Prisja motrën, — tha — ajo ka mbrëmje.

— Domethënë je vëllai i Lenit, ë?

— Ëhë, — tha ai dhe më pa në sy — babai bëhet merak — shtoi pas ca.

— Po pse s'e prite?

— Më erdhi gjumi, pastaj nesër do të ngrihem herët, se kam pastrimin e klasës.

— Do të të shajë babai.

— Le të shajë, do t'i them...

— Ç'do t'i thuash?

— Ja, do t'i them... «Ajo ka shokë shumë, ç'duhem unë aty?» Pse, si thua ti, ë?... — Unë i ngava flokët.

— Mirë, — i thashë — kështu thuaji babait. — Ecëm ca.

— Ata janë të gjithë të mirë — tha djali.

— Kush? — e pyeta.

— Ata, pra, montatorët. E njeh Xhezon ti, si i thyen hekurat ai, si shkrepëse, e ke parë? — Unë qesha.

— Di këngë ti? — i thashë.

— Ëhë, — tha — di.

— Mirë, — thashë — hajde këndojmë bashkë ndonjë këngë.

— Mirë — tha ai.



— Besoj se ke shumë punë këtej — fola unë. Operativi i zonës qeshi.

— Ti kushedi ç'ke dëgjuar, — ma ktheu — ke dëgjuar plot gjëra; ë? Kjo është vërtet një zonë me njerëz të ashpër e të sertë që janë shquar për gjakmarrjen. Por tani koha ka ndryshuar. E, megjithatë, do pasur kujdes, kufiri është afër këtu e njerëzit janë dhe kufitarë, shumë nga ata kanë armë. Mund të ndodhë që ngrënë krye zakonet e lashta dhe ndonjëri harron se ka ligje, ka organe kompetente për të sqaruar apo dënuar dikë. Atij i kërcen ai gjaku i vjetër dhe rrëmben pushkën. Por vetë populli është bërë më shpirtmadh dhe vetë ai i parandalon shumë krime sot.

Operativi u zgjat drejt çakmakut tim dhe ndezi cigaren.

— Ecim ca më këmbë, — thashë unë — sa ta rregullojë Teloja makinën.

— Mirë — tha. — O Telo, — thirri pastaj — përpara jemi ne.

— Mirë — tha Teloja.

Operativi thithi dy-tri herë cigaren.

— Ja, — tha — e di si ndodhi me Dedajt? Një djalë i ri shtypi me zinxhirë djalin trevjeçar të Zefit. Ç'është e vërteta, siç doli dhe nga shqyrtimi i mëvonshëm, traktoristi s'kishte pasur ndonjë faj të madh. Sakaq lajmi u përhap. Dedajt janë fis i gjerë, bëhen shtatë a tetë shtëpi. Unë isha në Curraj dhe, sapo më njoftuan, ia mbatha me nxitim nëpër një udhë dhish. Po bëj vite këtej dhe i marr vesh me erë gjërat. Tre-katër burra nga fisi kishin marrë pushkët e po kërkonin traktoristin. Kishin parë në vatër

të kulturës dhe poshtë te mensa. U doli përpara Ndue Pjetri, një komunist që i dëgjohet fjala në fshat.

«— Ndalni, he burra, — thirri — ç'bani kështu, se ka kush merret me këtë punë. — Por Dod Dedaj s'dëgjonte. Po ta kishin gjetur, mund të përfundonte keq puna. Mos u çudit ti! Kështu janë njerëzit, të mirë sa të duash, por u kërcen nganjëherë. Pas pak erdhi vetë Zefi. U mbloodhën mjaft njerëz. Dedajt dukeshin të papërmbajtur dhe gati të shpërthenin.

— Qetësohuni, burra, — briti Zefi — ai që kërkoni ju, është në shtëpinë teme.

— Çka je tuj folë, mor? — ngriti zërin Doda.

— Po, — tha Zefi — ai asht ke unë, padashje e bani, ia kam falë gjakun dhe s'e prek kush për pa ba pushkë me mue.»

Dedajt heshtën dhe ulën kokat. Në atë kohë mbërrita dhe unë. Turma aty ziente. Fshatarët flitnin me zë të lartë.

— Ç'bëni kështu, more, — u thashë — na turpëruat fare.

Prenga, më i vogli i vëllezërve, tundi kryet:

— Lene, lene, o shoku Hil, — tha — na e dha vetë Zefi një dush që...

Dedajt e tjerë u përpoqën të buzëqeshnin, por kokën s'e ngritën. Pastaj s'kishte burrë t'ia merrte traktoristin Zefit.

«S'e jap, thoshte, keni me e dënue.»

Mor, po, kështu, mor, po ashtu, mezi iu mbush mendja. Kështu pra...» Operativi flaku bishtin e cigares. Pas u ndje zhurma e makinës.

## 7.

Kishim kohë që ecnim. Ora ime tregonte pesë e njëzet, por ajo disa herë ishte zhytur në dëborë dhe unë e dija se, kur i ndodhte kështu, ajo gënjente me 10-15 minuta. Shoku im ecte përpara.

— Kemi dhe dy ngjitje, — tha ai — u lodhe?

— Jo — thashë unë dhe m'u duk sikur s'thashë të vërtetën. Ndalova mbi një sop dhe nxora frymën me forcë. Avulli u drodh e u shua ngadalë në ambientin e ftohtë. Përreth gjithçka ishte mbuluar nga dëbora. Dielli kishte hyrë në grykën midis dy maleve dhe pjerrësia e rrezeve të tij bënte që të krijoheshin ca reflekse me të vërtetë fantastike. Futa një shuk dëbore në gojë.

— Mos ha borë, — tha shoku im — nuk të bën mirë.

— Kam etje — thashë.

— Diku aty përpara është një përrua, pi atje. Hodha skitë në krahun tjetër dhe ndoqa gjurmët e shokut. Përroi ishte afër. Ujët lëvizte me shpejtësi midis peizazhit të ngarkuar me dëborë, sikur të don-te t'i shmangej atij rrethimi të bardhë.

— Bukur, ë? — tha shoku.

— Bukur! — thashë.

— E, — thirri shoku im — djem, pihet ky ujë?

Përtej qëndronin dy çuna të vegjël dhe na shikonin me vërejtje. Njëri ishte më i gjatë se tjetri dhe kishte një sëpatë në dorë. Mua m'u mbush mendja se do të ishin vëllezër. Të dy ata heshtën një hop. I vogli shikoi atë më të madhin.

— Pihet, — tha më i madhi — ne aty pimë.

— Mos pi shumë, — tha shoku im — jemi të nxehtë e na bën dëm.

Piva dy grushte. Më dukej sikur më digjnin duart. Shoku im sa lagu buzët. Kapërcyem matanë dhe u afruam te djemtë që rrinin pa lëvizur, ashtu siç i pamë në fillim.

— Jemi mirë në këtë rrugë për në kamp? — pyeta unë. Djemtë përsëri panë njëri-tjetrin në sy.

— Ç'jeni ju? — tha i madhi.

— Diversantë — tha shoku im dhe u mundua t'i jepte fytyrës një shprehje të egërsuar. Djali i vogël qeshi. I madhi vetëm vuri buzën në gaz, pastaj mori përsëri shprehjen e parë. Djali i vogël vazhdonte të qeshte. Qeshte e kollitej lehtë. I madhi i ra me bërryl. Ai prapë s'pushoi.

— Çipi! — i thirri me të ashpër i madhi.

— Poo... diversantë. Pse, thonë diversantët se janë diversantë, ë? — tha shpejt e shpejt i vogli. Kishte zë të këndshëm e si të ngjirur.

— Pusho tani! — tha i madhi. Ai na pa përsëri me vëmendje.

— Ju shkoni për ski, ë?

— Ne do djegim kampin. — Shoku im skërmiti dhëmbët. Nëpër flokët e tij kishte kristale të pashkrira dëbore dhe grimasa që bëri ishte kaq e bukur, sa dhe unë s'e mbajta të qeshurit.

— Oh, oh! — qeshte djali i vogël. Kësaj here qeshte dhe i madhi.

— Mirë e keni rrugën, — tha — vetëm aty sipër bjerini përmes pishave, se ju del më shkurt.

Unë i përkëdhela flokët djalit të vogël që kishte futur turinjtë nën krahun e të vëllait. Supet e tij dridheshin nga të qeshurit. Ne hodhëm skitë në krah. Shoku im bëri nja dhjetë hapa dhe u kthye.

— A shkoni në shkollë, o çuna?

— Vemi, si s'vemi — thirri i vogli.

— Bëjini të fala Basriut. — Ai tundi dorën dhe eci.

— Pse, ku e njeh mësues Basriun ti? — tha i madhi.

— Në ushtri, kemi qenë bashkë — thirri shoku dhe s'e ktheu kokën. Pas u dëgjua të qeshurit e djemve.

— Ej! Kështu si e keni nisur ju, do t'ju zërë nata.

Unë u tunda dorën djemve dhe eca pas shokut. Kur u gjitëm sipër, ata të dy dukeshin tek nxinin mbi dëborën e bardhë dhe rendnin nga shtëpitë e fshatit. Shoku im qeshi. Qesha dhe unë. Ne hymë përsëri përmes pishave. Dielli sapo humbi pas grykës. Dëbora kishte marrë tjetër nuancë. Tani dukej si një masë e hirtë dhe e shkrifët.

— Nxitojmë — tha shoku. — I shikon dritat? Atje është.

— Nesër do mbajë kohë e mirë — thashë unë dhe ngrita kokën lart e pashë qiellin.

## 8.

— Si thua, ti, ë? — pyeti kushedi për të satën herë shoferi. — Ajo do të mbajë inat, ë? Mbase s'do më flasë me gojë fare.

Ai shtrëngoi buzët dhe goditi me pëllëmbë timonin. Unë buzëqesha.

— Po të jetë pa mend në kokë, — thashë — kështu do të bëjë, por, në qoftë kështu, atëherë më mirë për ty.

— Ajo është vajzë e mirë, — ndërhyri shpejt ai — nuk e njeh ti, ajo...

— E po mos e ki merak, atëherë.

Një copë herë heshtëm të dy. Ai kishte mbësh-tjellë me pëllëmbë timonin dhe vështrimin e mbante përpara në rrugën e lagur ku dritat e makinës for-monin një brez të ndritshëm lëvizës.

— Një fakt, unë e pashë që atë çast, ajo u vrenjt disi, po s'kisha ç'bëja. I thirra: «Liri, Liri!», po ajo ishte kthyer e po shkonte drejt një makine tjetër që po vinte. Një vend kisha vetëm, s'kisha ç'bëja. Plaka ish plakë, mor jahu, kohë e keqe ish, kushedi ç'hall kish ajo pastaj, s'mund ta lija atë aty. Ja, thuaj, si do bëje ti?

— Njëllë, — thashë — mëgjithëse mund të ki-sha shkuar me vrap e t'i thosha kështu e kështu është puna.

— Hej, dreq! Po ja, për këtë më vjen inat, plasja më vjen. Pse, mor gdhe, nuk shkove t'i thoshe?! Nuk e di se si m'u duk po të shkoja t'i thosha, m'u duk vetja si..

— Nejse, — thashë — mos u mërzit fare, ti the që i paskeni shtëpitë në një shkallë në pallat, kollaj, atëherë, do ta takosh prapë dhe do t'i thuash.

— Eh, mor vëlla, s'ia njuh kokën ti asaj, jo. Kur ishte në shkollë dhe shkonte me shoqet në mëngjes, kaq herë frenoja dhe i thosha ta çoja unë, kur më binte rruga andej. Pse, dëgjonte? Kurrë. Asnjëherë s'hipte. Mbaroi shkollën. E caktuan mësuese këtej nga shkojmë tani. Vjen në shtëpi të shtunave. Ngji-tet shkallëve me vrap duke tundur çantën: «Ç'kemi, Tosi? më thotë, kur qëlloj aty. Hajde, shofer i dallu-ar, nxënësit e mi e kanë prerë fotografinë tënde nga revista dhe e kanë vënë në mur.» Unë skuqem e i them ndonjë llaf kot. Rrallë më qëllon rruga këtej. Nja dy të hëna e kam çuar unë. E keqja është se

këtë radhë i thashë vetë: «Mund të bëj një rrugë andej nga ju. Po qe kështu, të gjej te rruga në të dalë,» i thashë. Ajo u gëzua, se e pashë që i shkëlqyen sytë. Më nduku flokët siç bënte kur ishim të vegjël dhe iku me vrap. Mora ngarkesën dhe, kur u afrova në të dalë të qytetit, e pashë atë që larg. Nja 50 metra përpara saj ishte ajo plaka. As unë s'e di si frenova. Binte shi, plaka qe lagur dhe dora e saj m'u duk si një semafor i çuditshëm e urdhërues. Ajo qe nisur për tek unë, por pa plakën dhe u kthye drejt një makine tjetër. Kur kalova atje, s'e pashë. Ndoshta ishte futur në një nga dyqanet. — Ai kaloi mollëzat e gishtërinjve mbi kapakët e syve dhe mblodhi buzët.

— Po të jetë se është vajzë e mençur dhe, nëse ti s'do kishe marrë plakën, po atë, ajo duhej të të përbuzte ty.

Ai s'tha gjë.

— Ti e do atë?

Ai më pa në sy dhe buzëqeshi. Vura cigaren në buzë dhe pashë për shkrepësen. Ai ndezi dritën e kabinës. Vetëm atëherë vura re se në kabinë ishin tri-katër fotografi mësuesesh me nxënësit. Unë qesha.

— Mos është ajo në ndonjë nga këto? — thashë.

— Jo — tha. Qeshi dhe ai. Pastaj heshtëm. Të dy i kishim ngulur sytë atje përpara, tek ai brez i ndritshëm rruge.

## 9.

Te banaku i lokalit të vogël buzë rrugës vinin udhëtarë e shoferë, pinin diçka me nxitim dhe iknin prapë. Në rrugën e lagur shkonin makina. Bana-

kieri mezi i dëgjonte klientët përmes zhurmës së motorëve. Mbështetur te një nga tryezat e larta, një burrë i thyer shikonte jashtë dhe mbante një gotë përpara.

— Bjer, o shi, bjer! — tha një djalë që rrinte më këmbë pranë xhamit. — E prishi fare plazhin. Tri ditë do rëra të thahet.

— Na prishi kallamoqin, — tha burri i thyer dhe ktheu gotën — more vesh ti, kallamoqin, se pa kallamoq s'ka plazh.

Djali doli. Burri i thirri në emër dikujt që hyri në lokal. Tjetri mori një gotë dhe vajti te tryeza e tij. Ai i kishte këpucët të përbaltura dhe duarve, gjer në kyç, i kishin mbetur dregëza balte të tharë. Një copë herë u dëgjua të folurit e tyre dhe gërvima e të qeshurit.

— Eh, or Çome, eh, s'të gjen gjë ty, or, jo — thoshte ai që kishte ardhur. — Ti je për të marrë e për të të hedhur kudo ku luftohet në botë me të ligjtë, ja, atëherë ta shihnin ata se me kë luftonin...

Ata çokën gotat.

— ...tani s'më dhemb më, e kam mirë tani, — thoshte Çomja — ishte kirurg i zoti ai.

— Më mirë që e bëre, kaq kohë të thosha: «Hiqe, o Çome, hiqe.»

— E di, or, e di, se vetëm keq kisha prej tij, po dëgjo... edhe se si më vinte, sikur më vinte dhe keq ta hiqja atë plumb, sikur më kujtonte shumë gjëra ai plumb. — Çomja kaloi pëllëmbën e ashpër mbi fytyrën e tij të zhubravitur.

— A e mban mend Kriston, o Ndreko? — Ai vuri pëllëmbën e tij mbi dorën e shokut. Heshtën të dy.



— Po Pandin? — shtoi ulët Ndrekoja. — Ha-xhiun, Miston, eh...

Ata ngulën sytë mbi gotat.

— Kështu mendova, — tha Çomja — kështu mendova kur më shpinin në operacion. «Ta heq, thashë, këtë plumb të vjetër, se çdo shok i rënë, thashë, është një plumb në veten time, plumba që të therin e të dhembin, po që kurrë s'do të doja t'i hiqja prej vetes.»

— Ashtu është, vëlla, — tha tjetri — ashtu është. Heshtën gjatë;

— E me, ç'thotë puna, si vini? — pyeti Çomja.

— Mirë, po kjo kohë na prish ca punë. Kur të mbaron pushimi ty?

— Kam dhe ca ditë, po do filloj që nesër. S'më rrihet kështu. Plasa. Më thotë gruaja...

Në bisedën e tyre u fut përsëri zhurma e rrugës. Që nga xhami i veshur me avull dukeshin se si ata të dy qeshnin për diçka e godisnin njëri-tjetrin krahëve.

## ROMA ZDROMA

Edhe sot e kësaj dite nuk e di pse e thërrisnin Roma zdroma. Ca thoshin se emrin e vërtetë e kishte Romeo. Po të ishte kështu, atëherë ky do të ishte Romeoja më interesant në botë, me atë kokë të qethur e xhunga-xhunga. Qe shumë i prapë Roma zdroma. Kishte pas vetes një tufë kalamajsh, të cilët i sundonte në mënyrë të çuditshme. Mëhalla e tij ishte afër stadiumit. Ne të gjithë na kishte marrë shumë inat. Kjo ndodhi që atëherë kur qeshëm me të. Ishte ulur në mes të shokëve të tij dhe diç u fliste. Ato ditë kishte dalë nëpër kinematë një film i ri. Roma ishte i pari që i shihte filmat, bile edhe ata që ndaloheshin për fëmijët nën 16 vjeç. Kur kaluam afër, po thoshte:

«Ene, kështu kalamoja... nji t'qitë shpatën ene fup mbi kalë... ija...»

S'na u mbajt të qeshurit. Ai na përqeshi dhe, sa shkuam më tej, «Zjarri!» thirri. Një turrë gurësh fluturoi drejt nesh. Ia mbathëm me vrap. Pra, që atëherë, mëhallën tonë e kishte shumë zët Roma. Kur dukej nga ana jonë, hapej alarmi sikur po vinte Çingis Khan me hordhitë e tij. Roma zdroma s'linte pemë në kopshtin e çerdhës, vriste pëllumbat tanë

dhe bënte gurgule të madhe në sheshin ku ne loz-  
nim. Kishte vetëm nënën në shtëpi. E quanin Bihane,  
por ai i thërriste «ije». Roma zdroma ishte nja dy  
vjet më i madh se ne. Në shkollë vetëm emrin kishte  
në regjistër. Edhe kur vinte, mësuesit detyroheshin  
ta nxirrnin jashtë. Të gjithë ia kishin hequr fillin.  
Bile, atëherë thanë se do ta shpinin në Shkollën e  
Edukimit. Ishte një shkollë e tillë në atë kohë. Kur  
bënim prapësira, nënat na trembnin me të, si me go-  
golin. Babanë Roma nuk e kishte. S'dihej gjë për të.  
Ca thoshin se kishte qenë partizan, ca thoshin ba-  
llist. Pas Çlirimit, nja dy vjet, vinte më të rrallë në  
shtëpi. Pastaj qe zhdukur fare. Atëherë kishte lin-  
dur Roma. Nënën e kishte të shkuar nga moshja.  
Kishte dalë nga kontrolli i saj dhe s'e pyeste fare  
tani. Në një nga ato ditë, kur u hap fjala se do ta  
shpinin në atë shkollën andej, Roma zdroma bëri  
një vërshim në mëhallën tonë. Ndjeva zhurmë në  
ballkon. Kur dola, pëllumbin tim të bardhë, me të  
cilin mburresha aq shumë, e gjeta tek përpëlitej me  
puplat të gjakosura. Poshtë Roma zdroma bërtiste:

— E... e patë çar nishoni, kalamoja, ej... — dhe  
tundte llastikun e tij. Renda me vrap jashtë. Thirra  
shokët dhe u vërsulëm drejt tyre. Ne ishim më shu-  
më dhe ata ia mbathën nga Lana. Më ishin mbushur  
sytë me lotë nga inati. Kur Roma po merrte kthe-  
sën e lulishtes, fshiva sytë me mëngë dhe i lëshova  
një gur përpara. Roma thirri:

— A... a! — dhe u kthye e na shau me rrënjë e  
me degë. U trembëm. Atij i shkonte gjak, por zuri  
të shtinte me llastiqe dhe s'iu afruam dot. Ikëm. Të  
nesërmen dëgjova se Roma ishte betuar se do të hak-  
merrej. Ca ditë s'e pamë fare. Një vajzë e mëhallës  
së tij na tha se në shtëpi të Romës kishin ardhur

dy makina dhe prej tyre kishin zbritur tre a katër oficerë madhorë dhe nja dy civilë. Nëna e Romës kishte qarë. Ata kishin ndenjur rreth gjysmë orë e pastaj kishin ikur. Bihania e përbotur i kishte përcjellë gjer te dera e qe përfaquar me të gjithë. Liloja na tregoi se babai i kishte thënë që i ati i Romës qe trim i madh. Ai, teksa kryente një detyrë, kishte rënë heroikisht. Dy ditë Roma zdroma se ku u zhduk. Pastaj thoshin se kishte thënë së ëmës që qante: «Mos qaj, ije, më ke mua ti.» Thoshin gjithashtu se Roma rrahu një shok që kishte thyer me llastiqe një poç elektrik të shtyllës. Ca kohë ramë rehat prej tij. Të gjitha ato që thuheshin për të, na dukeshin të habitshme. Një ditë erdhi në shkollë. Orën e dytë e nxorën jashtë, se i shkuli gërshetat një çupe që i kishte përmendur Shkollën e Edukimit. Kur mbaruam mësimin, te dera e madhe e shkollës më zuri për krahu.

— Ej, — tha — ti, (Roma zdroma s'i fliste njeriu në emër) kom i çik punë me ty.

U tremba. «Muhabeti i gurit», thashë me vete. Më kishte zënë nga mënga, por sytë i mbante ulur. Tërhoqa krahun.

— S'kam punë me ty — i thashë dhe u bashkova me shokët.

— Ptu! — pështyu Roma zdroma pas meje.

Kaluan ca ditë. Nëna më kishte dërguar për një punë. Afër stadiumit, aty te një qoshe, më dolën shokët e Romës. Ai vetë qe aty më tej. U mata të kthehesha.

— Mos luaj! — tha ai që ne i thoshim «Kuqo».

Ata kishin tendosur llastiqet. Mbeta keq. «Do më rrahin», thashë. Po më binin djersë.

— Më lini, — u thashë — do ta keni keq.

Roma tha:

— Merreni përpara!

Desha të thërrisja, por më erdhi zor. Askush s'po dukej në rrugicë atë çast. Dy prej tyre më shtynë. Kundërshtova, por ata më hoqën nga krahët. Më shpunë gjer prapa stadiumit. Në verë, në kampin ditor, aty ne loznim. S'po kuptoja ç'kërkonin të më bënin.

— Lëshojeni — tha Roma zdroma. E vura re që ai i shmangej vështrimit tim. Kjo më trimëroi. E mblodha veten.

— Ç'doni? — thashë. — Rrugaçë!

Kuqoja m'u hakërrua.

— Lëre! — tha Roma. Heshtje. — Shiko, — tha pastaj Roma — ...ti je në shtabin e çetës...

Unë po e shikoja në sy me vëmendje. Ai thyente një shkop nëpër duar.

— E, çfarë? — thashë.

— M'boni ene mu pionier, — tha — baba im ka qenë komunist.

«Krahu!» krisi shkopi i thyer. Ai ishte skuqur në fytyrë.

— Ose do ta bëni, ose... — klithi një xhuxh afër meje — ai ka qarë, merr vesh ti... Roma...

— Pusho, Çap, mistrec dreqi, pusho! — thirri Roma. E gjitha kjo më erdhi shumë papritur. U turbullova. Befas ndjeva të më vinte keq, shumë keq për të.

— Ti s'e ke merituar të jesh pionier, — i thashë — por, nëse...

— Mirë, — tha — e di, e di...

— Do t'u them shokëve të shtabit — thashë.

— Mirë, — tha — ... dhe... dhe, po pate nevojë... po të ngau kush... thuaji Romës. Kalamoja, lëreni! — iu kthye pastaj shokëve. Kuqoja më përcolli gjer te rruga.

— Ej, — tha — shiko, futeni, ka dy ditë që s'ha gjë fare. I ati i kishte lënë një copë letër, një shok i tij ia solli.

Ktheva kokën. Roma zdroma qëndronte atje lart dhe thyente shkopin në copa të vogla. Desha t'i thërrisja e t'i thosha se ai do të bëhej pionier, por i tunda dorën dhe ika me vrap.

## VAJZA ME PANTALLONA VISHNJE

Ne të dy ndezëm përsëri nga një cigare. Ishte ditë e bukur me një diell të vakët dimri.

— Këtu te ju ka vajza të bukura — i thashë.

— Eh! — bëri ai.

— Pse bën «eh», e them me gjithë mend, le që s'them vetëm unë, të gjithë thonë se ky qytet ka vajza të bukura.

— Ti i sheh vetëm nga jashtë, mirë, unë s'them që s'ka vajza të bukura, si kudo, ka edhe këtu, mirëpo mund të njohësh një vajzë më nga afër dhe pastaj mund të mos të duket më e bukur.

— Ohu, — thashë unë — ti ke mbetur përsëri ai romantiku dhe idealisti i vjetër i shkollës.

— Jo pra, s'është aty puna.

— Pse, ku qenka puna?

— Po ja...

— More, po lëri katikulet, ç'lidhje ka kjo, jo bota e brendshme, jo... po të jetë e bukur, është e bukur dhe pikë.

— Mirë, më lër të të them diçka tani, për atë vajzën me pantallona vishnje që të pëlqeu aq shumë.

— Po që për atë, fol sa të duash, ajo ishte me të vërtetë gjë e rrallë.

— Po, po, e rrallë!

— Mos përqesh!

— Mirë, s'të përqesh.

— Nëse fillon teorizimet, më mirë mos më trego gjë fare, merr vesh?

— Ëhë! Ajo vajza është fqinjë me gjyshen time. Më ka mbetur zakon që në fëmijëri që shpesh, të paktën dy herë në javë, do të shkoj te gjyshja. Vjet ajo ishte maturante. Meqë shtëpinë e kishte ngjitur me të gjyshes, natyrisht që do të njiheshim. Ajo dinte të buzëqeshte bukur dhe kishte një elegancë të përsosur në të gjitha lëvizjet. Por ti e di që mua këto s'më bëjnë shumë përshtypje.

— Po, e di që ti murg ke qenë gjithë jetën.

— Kështu. Unë e ndihmoja për ndonjë mësim të vështirë që kishte, kurse, kur më kërkonte, i sillja edhe ndonjë libër që i duhej. Isha përpjekur disa herë të bisedoja me të diçka më nga afër, diçka për atë, se si e kuptonte ajo jetën, ç'pasione e ç'dëshira kishte. Ajo lëshonte klithma ekzaltimi, veçanërisht kur flitnim për letërsinë, por kuptohej shpejt se këto klithma nuk ishin për letërsinë e vërtetë, por për lulka krejt bajate e të dorës së dytë. Njëherë asaj i duhej për koment një vjershë. Unë kisha nja dy gazeta në dorë.

«— Mos ka ndonjë aty? — pyeti ajo.

— Shiko në koleksionin e «Zërit të popullit» — thashë unë.

— Mund të gjej gjë aty?

— Posi, — bëra shaka — «Zëri i popullit» ka dy vjet që ka nga një faqe letrare çdo numër. Pse, s'e di ti?

— Jo, jo, e di, po thashë... kushedi...»

E kupton ti, unë e nisa thjesht për shaka, pa



menduar se do të zbuloja diçka. Ajo mund të ecte bukur dhe mund të rregullonte përkryer frizurën e flokëve që të të mahniste ty dhe dikë tjetër, por ama... Nejse, dikur ajo më kërkoi t'i pregatisja një hartim. E di ti, gjithmonë temat e hartimit mund të parashikohen. Nuk desha. I thashë se mund ta ndihmoja me ndonjë material a me diçka tjetër, po jo t'i bëja hartimin. Pastaj m'u lut gjyshja dhe, ashtu pa qejf, iu vura punës. Shkrova dy hartime për dy tema të ndryshme. Herën tjetër, kur shkova andej, ajo mend m'u hodh në qafë. Hartimin ia kishin pëlqyer shumë dhe kishte marrë dhjetë. Ia kishin lexuar në të gjitha maturat e shkollës. Rrija përpara saj. I vija re lëvizjet e buzëve, dridhjet e qerpikëve, atë mimikë të përkryer e me diçka fëmijërore që s'mund të përshkruhej. Ajo përplaste herë pas here pëllëmbët e zëri i kumbonte. Më tregonte se si ia kishte mburrur mësuesi hartimin dhe sa ia kishin pëlqyer shokët e klasës. Natyrisht, ajo kishte një ndjenjë shumë dashamirëse për mua.

— Edhe shiko, — tha — tani s'do më lësh në baltë, ë?...

Unë përpiqesha të buzëqeshja. Se përpara meje s'kisha vetëm një pikturë ku artisti ishte treguar me të vërtetë mjeshtër. Përpara kisha një njeri, një vajzë ku vlonte jeta. Nën atë bluzë të hollë, që i derdhej supeve, pleksej një dëshirë aq e natyrshme dhe aq njerëzore. Kjo vajzë jetonte rininë e saj, moshën më të bukur. Natyra s'kishte kursyer për të në pikëpamje të bukurisë fizike. Pastaj çdo brez kalon ditë më të bukura se brezi paraardhës; ja, ne vërtet kaluam mirë, po kush erdhi pas nesh, kaloi edhe më mirë akoma. Bota është e madhe dhe e gjerë. Vendi

ynë shkon në rrugë të bukur. Pra me të gjitha këto predispozita, a nuk gjetka dot në veten e saj kjo vajzë, kaq ndjenjë dhe mendim sa të ndërtojë një hartim sado të thjeshtë?! A nuk mundet ajo të vërë re poezinë e vërtetë të jetës dhe të mos priret pas çikërrimave? Çdo brez zëvendëson tjetrin. Thashë se, ai që vjen, e jeton jetën më bukur se ai që shkoi, por jo vetëm kaq. Atij i rritet hapësira e interesave, e dijeve, e dëshirave, e preokupacioneve. Kurse kjo vajzë e bukur s'e lexon gazetën, s'ka interes se ç'ndodh e ç'bëhet dhe botën e percepton përciptas. Pra, me këtë sy po e shikoja atë. Kurse ajo përsëri fliste e qeshte. Qeshte e lumtur me kënaqësinë që i kishte sjellë vlerësimi i hartimit. Kjo gjë e zbente edhe më shumë tek unë. Sepse kjo vajzë e bukur, duhej, më kupton, duhej patjetër që me vitalitetin e saj, të kuptonte poezinë e të jetuarit, ndoshta vetëm për këtë, të justifikonte bujarinë e natyrës ndaj saj, ja, ndoshta vetëm nga kjo, në mos nga tjetër gjë, sepse që ishte e bukur, kjo s'ishte aspak merita e saj. Mendo tani, ajo do të martohej, do të hynte në jetë tamam, njerëzit mund ta respektonin thjeshtë, vetëm për hir të bukurisë, njerëz si ti e kam fjalën, dhe mund të zinte në jetë një vend që ndoshta s'do ta meritonte. Është krim të bësh kaq pak në jetë, më beso.

Shoku im heshti. Ai ishte i emocionuar dhe duart i dridheshin.

— Po pastaj? — pyeta unë.

— Pastaj hiç, të gjitha këto u përpoqa t'ia thosha asaj, por kushedi, mbase nuk ia thashë ashtu siç duhet. Ajo nuk më foli më.

Ne heshtëm.

— Ti i thua me pasion gjërat, por i thua disi turbull. — thashë unë.

— Unë kisha të drejtë — tha ai.

— Ndoshta.

— Jo ndoshta, po kështu është tamam, kisha të drejtë.

## S H O F E R I

Kisha disa ditë që rrija në atë hotel, në N. Në fillim besdisesha, por më vonë u mësova dhe, bile, më pëlqente ai ndërrim i përnatshëm i njerëzve në dhomë. E, me të vërtetë që kishte diçka interesante këtu. Njerëzit vinin në atë qytet të Veriut, njerëz të ndryshëm në moshë e profesione, inspektorë, mësues të zonave të thella, gazetarë. Gjithkush kishte shqetësimet e veta, manitë... dikush fliste shumë e dikush s'fliste fare, dikush tregonte bukur enekdota e dikush ankohej për lagështinë e madhe të këtij qyteti.

I mbështetur në shtrat lexoja diçka. Qeshë i kapitur dhe e ndieja që duhej të flija. Ora kishte kaluar nga dhjeta,

«Qenka zog nate ky mysafiri i ri», thashë dhe shova dritën.

Gjithmonë, kur shkoja me shërbim, më pushtonte një ndjenjë kënaqësie dhe gjumi më zinte shpejt, se gjumi i zë shpejt njerëzit e lumtur. Midis perdes së dritares, në faqet e mureve e në tavanin e dhomës, projektoheshin dritat e rrugës, disa të palëvizshme e disa që bridhnin murit e zhdukeshin së bashku me zhurmën e makinës në rrugë. Kur kalo-

nin shumë makina, kombinimet e dritave ishin akoma më të bukura e të çuditshme dhe, ashtu i përgjumur, të dukej se shikojë diçka nëpërmjet një kaleidoskopi të madh, bile jo kaleidoskop, por diçka tjetër... Dera u hap ngadalë dhe po ngadalë u mbyll. Silueta e njeriut eci në majë të gishtërinjve drejt shtratit e filloi të zhvishej në errësirë. Një karrige kërciti.

— Dreq! — shau ai dhe pa nga unë.

— Mirëmbërëma! — i foli. — Po të duash, ndize dritën, unë s'kam fjetur akoma.

— Tungjatjeta, shok, — tha ai — si je? — Kishte zë të trashë e të plotë, por mundohej të fliste ulët. — Fli, fli, se zhvishem edhe kështu pa dritë — dhe u fut në shtrat.

Heshtëm një copë herë. U zgjata drejt xhaketës e mora paqetën. Duket, edhe atij i kishte shkuar mendja, se ndjeva zhurmën e shkrepëses. E nderëm dhe qeshëm. Në flakë të shkrepëses pashë vetëtimthi profilin e tij; duhej të ishte djalë i ri, nja 25 vjeç. Kishte fytyrë të gjatë, flokë të shkurtër që i uleshin mbi ballë.

— Siç duket s'na u fjetka — tha ai.

Filluam të pyesnim njëri-tjetrin.

— Jam shofer, — tha — kam sjellë makinën këtu për riparim kapital, nesër do ta marr. Thonë se i punojnë mirë këta të N-së, si thua ti?

— Po, — i thashë — mirë i punojnë — ndonëse s'dija gjë.

Më doli gjumi fare. Bisedonim dhe unë e ndieja që na shkonte muhabeti. Se është gjë e çuditshme kjo; mund të të ndodhë që me një njeri mos të të bëhet të shkëmbesh dy fjalë. «Kohë e mirë», thotë ai. «Behar fare», i thua ti dhe hesht.

Dhe ashtu, në mes atyre fashave të bardha të

dritës, që bridhnin mureve të dhomës, ne kaluam nga legjendat e motshme deri te hidrocentralet, nga luftërat e popujve deri te markat e makinave. Kaluam nëpër qytetet e fshatrat tona, nëpër mendimet e shkrimtarëve, nëpër aksionet e rinisë.

— Para dy vjetësh kam punuar atje, — tha ai — në hekurudhë, me gjithë një shokun tim të ngushtë. Kishim makina të reja... Pastaj unë ika andej...

Koka e kuqe e cigares së tij përshkoi energjikisht një trajektore të lakuar.

— Pse? — i thashë. — S'të pëlqeu atje?

— Jo, more... jo se s'më pëlqente... Po duheshin shoferë në Vaun e Dejës. Dëgjo... pak më parë ne folëm për malësorët, në fakt unë atje e njoha botën e tyre të brendshme, një botë me fantazi të madhe. Ishte një brigadë me djem e me vajza nga Kukësi. E si të të them, or babë... më vjen Ceni, një shoku im, një ditë e më flet për njërën prej tyre, për Dilën.

«— Është e bukur, Shabë, — më thoshte — është e bukur dhe mua s'm'i hedh sytë kurrë, po bëhet flakë, kur i afrohem — e dër-dër-dër të tjera.

Unë isha shtrirë e rregulloja diferencialin.

— Në drejt të vesh, më lër rehat! Zbrazu — i thashë. Pastaj: — Si është puna?

— Hiç, o Shabë... ajo më do. E pashë në sy.

Është djalë i pashëm shejtani. Shokë, shokë të ngushtë, po megjithatë më vinte inat kur qeshte ashtu, duke thënë se Dila që e bukur, që kështu e ashtu. Drejt ta hajë, edhe unë doja një vajzë, por më zinte turpi, kur edhe ndonjë tjetër thoshte për të se ishte e bukur, pa le ta thosha vetë.

Pas ca kohësh u bë një mbledhje e fortë e bri-

gadës së Kukësit. Dila i kishte shkruar letër shtëpisë ku thoshte që do të martohej me atë që donte e jo me atë tjetrin, me të cilin e kishin fejuar. Në fshat bëri bujë kjo gjë. Por Dila që e vendosur. Në këtë kohë më erdhi Ceni. Unë po rruhesha. Ai, dër-dër-dër, seç po më thoshte për një gjeometre flokëverdhe, «të mahnitshme», siç thoshte.

— Ore, — i thashë — ç'dërdëllis? Po Dila?

— Ohu, Shabë, s'e njeh Dilën ti. Pse, mos do martohesha me të unë? Dila është e shekullit të kaluar. E-he!»

E lashë briskun dhe fshiva shkumën me peshqir. Më beso, kurrë s'e kam ndier në gjoks atë nxehësi si atëherë, sikur po më digjej barut brenda. Mendja më bridhte nëpër botën e atyre malësorëve, që zbrisnin nga malet e ndesheshin ballë për ballë me të renë, atë luftë të ashpër e të vështirë që duhej të bënin ata për të tërhequr drejt maleve të tyre gumëzhitjen e rrugës, sirenat e anijeve e të trenave, rrapëllimën e motorëve, flakët e portokallta të saldimëve, zërin madhështor të socializmit. Në këtë rrugë të vështirë, ata kishin çaste të vërteta lufte, ndaj dhe hezitonin e trembeshin nganjëherë. Ja, kështu dhe Dila. Çfarë zhgënjimi po pësonin ajo, shoqet, fshati. Në sytë e tyre Ceni isha unë, ishte tjetri, ishte dhe ti, or babë. S'ishte puna për një dashuri të thjeshtë, kupton? Tani ndoshta dhe e kam gabim, or babë, po kështu e kam unë. Mund të jesh i ligu i vetes, mund të kesh vese që të dëmtojnë ty vetë, nuk thashë se është mirë kështu, jo, por ama të ndërhysh në jetën e një tjetri, t'i prishësh jetën, ëndrrat, s'durohet, kjo është poshtërsi. Një jetë ka njeriu, more, e kupton apo jo? Ja, lexoja atë librin e atij Nikolla Ostrovskit. Ai është hero, o babë. Pa mendo një herë,

sikur të gjithë njerëzit e botës të ishin kështu, ja, si ai, ë? Ehu!...

Bëri një pauzë. Sustat e krevatit kërcitën.

— Të mërzita, — tha — ë? — Hej dreq! — shau.  
— Kështu e kam këtë dreq zakoni, në mbledhje mbaj nga një shok afër, që të më tërheqë nga mënga, kur fluturoj nga tema.

— Jo, — i thashë — vazhdo, mua më pëlqen kështu.

Ngrita më lart jastëkun dhe hodha batanijen mbi shpatulla.

— Edhe... — vazhdoi ai — po... Nuk e di se ç'i thashë Cenit, diçka të rëndë i thashë, se u zverdh i gjithi në fytyrë. Bile çudi si e mbajta veten e s'e godita. Ndoshta ngaqë m'u kujtua fytyra e tij, kur ishim fëmijë të vegjël. Unë jam rritur me të, e kupton ti? Dy ditë s'më doli fare para sysh. Në atë kohë Vau i Dejës kërkonte shoferë... ishim tre shokë që shkuam. Kështu pra...

Më hodhi një cigare.

— Ndize! — tha dhe e ndezi dhe vetë.

Heshtëm një copë herë. Befas e ndjeva veten shumë të afërt me këtë njeri. Heshtëm.

— Po ai... — thashë — shoku yt?

— Eh, — rënkoi — ...s'e kam takuar, këtë Vit të Ri më kishte dërguar një kartolinë. Kishte shkruar një parullë që e përdornim që në fëmijni. Për Dilën një shok më ka thënë se ka shkruar në teknikum. Tani... si çudi duket, por unë do të dëshiroja shumë, që... E di, më kanë thënë se ai kërkon shpesh të shkojë me shërbim andej. — Heshti. — Ajo e donte shumë, kështu më duket mua... dhe kështu është, si thua ti, ë? Se, që një vajzë, të braktisë gjithë normat dhe ligjet që drejtonin jetën e saj dhe t'i hyjë një jete të



re... po, po, ajo e donte shumë atë. Kushedi... ë?  
Ndoshta... Eh, të thashë që unë fluturoj shumë, ohu...  
— tha dhe heshti. — Shiko, — tha pastaj — Ceni  
nuk është njeri i keq në shpirt, e njoh mirë unë... po...

Sustat e shtratit kërcitën. Vura duart nën kokë  
dhe po mendoja për të gjitha këto. Njollat e dritave  
në mur qenë rralluar. Nuk e ndieja veten të qetë.  
S'e dija se ç'mendonte, por kisha një dëshirë të en-  
desha rrugëve...

...Të nesërmen ai kishte ikur shpejt. Mbi tav-  
llën e duhanit ishin bishtat e cigareve që kishte  
pirë. Zbrisja shkallët dhe kisha një ndjenjë sikur  
diçka më mungonte. Më dukej e çuditshme, që, me  
atë njeri, që m'u bë aq i dashur në atë dhomë të  
vogël hoteli, unë mund të takohesha diku, mund të  
udhëtoja bile në makinën e tij dhe të mos e njihja  
që qe pikërisht ai. Me këtë ndjenjë përshëndeta spor-  
telistin plak, i dhashë një cigare dhe, duke dëgjuar  
llomotitjen e tij për motin, shfletova regjistrin  
e hotelit. Sytë më mbetën mbi ata rreshta të shkruar  
shtrembër: «Shaban Rustemi, shofer.»

## K E N G A

Ajo e ndiente veten mjaft të lumtur dhe rruga nga vendi i punës në sektor s'e lodhi fare. Qeshte me të gjithë dhe këndonte e linte përgjysmë të gjitha këngët që dinte. Te burimi u hodhi nga një grusht ujë Valit e Nashos, mori nga një të sharë prej të dyve dhe fluturimthi u fut në fjetore.

— Avash, mi gocë, sikur të paskan hedhë benzol në gjak sot — qeshi Luli, komandantja e brigadës.

— A e matët, Luli? Hë pra... si?

— Pregatituni, goca, sot flamurin e kemi ne. Keq më vjen për Fredin tënd, Lejda, por... s'ke ç'i bën.

— Është imi sa dhe yti, moj komandantja ime bukuroshe, po prit të ta puthë pak Lejda faqen. — Vajzat qeshnin.

Kishte tri ditë që brigada e dytë, ku ishte Fredi, ai djali i gjallë, ezmer e me sy depërtues, u kishte marrë flamurin. Brigada e tyre kishte shumë vajza, kurse e dyta më shumë djem. Kjo qe bërë shkak për të folur në sektor se flamuri s'vinte më midis tyre.

— Hiqeni, goca, ma hiqni, se s'iu dilka kësaj sot — thërriste Luli.

Lejda u hodh mbi shtratin e saj.

— Oh, moj mama, — tha — sa qenkam lodhur!  
I kaloi përpara syve gjithë dita, dielli mbi tarra-  
cat, gjymi i ujit, këngët. Një mpirje të këndshme  
ndiente në gjithë trupin dhe s'i bëhej të çohet. Një  
rreze dielli hynte nga një e çarë e fjetores dhe në  
të rrinin pezull grimca të vogla pluhuri.

— Shiko, — tha ajo — sa pluhur, po të mos ishte  
rrezja, do të dukej sikur ishte ajër i pastër.

Një hije serioziteti ra mbi fytyrën e saj të bu-  
kur. Si i kishte thënë ai gazetari? «Jo çdo e qeshur  
është mendjehetësi, është mirë që njeriu të qeshë  
gjithmonë, por ama dhe çdo hap, çdo veprim në je-  
tën e tij ta bëjë të matur, në sensin pozitiv gjith-  
monë.» Ajo kafshoi gishtin. Copëra mendimesh i ka-  
lonin në kokë ashtu gjysma-gjysma.

«Sidoqoftë, ç'të keqe ka këtu, — tha ajo — s'ka  
asnjë arsye për të thënë se ai s'është djalë serioz»  
— dhe shkundi dorën sikur të kundërshtonte dikë.

— Lejda! — e thirrën.

— Hë.

— Hë, ç'hë, moj, s'të hahet ty? Shpejt, se në  
katër fillojnë provat. — Ajo ishte solistja më e mirë  
në atë qytezë vullnetarësh. Hëngrën dhe, gjysmë orë  
më vonë, qenë mbledhur të gjithë te salla.

— Si je sot, Lejda? — pyeti Josifi, fisarmoni-  
çisti nga Korça.

— Lëre, sot është zhivë fare, por është ngjirur  
duke thirrur e duke qeshur — ia priti Vali. Ajo bu-  
zëqeshi. Do të këndonte një këngë të re për një shoqe  
të saj të ngushtë, që para dy javësh qe ndarë për-  
gjithmonë nga gjiri i tyre. Këngën e kishte kom-  
pozuar Josifi. «A do ta arrij dot?» mendoi. Iu kujtua  
Lida, shoqja për të cilën ishte kënga. Mallëngjimi i  
zuri grykën.

— Ç'thotë artistja jonë, si shkojnë provat? —  
Ishte zëri i Fredit ky. Ajo i buzëqeshte me vësh-  
tirësi.

Në një mbrëmje Fredi e kishte marrë dy herë  
në vallëzim. «S'ke pse çuditesh që të mora prapë, i  
kishte thënë ai, këtë nder ia bëj vajzës më të mirë  
të aksionit.» Kjo s'i kishte pëlqyer. Në përgjithësi diç-  
ka s'i pëlqente te Fredi, po, se ç'gjë ishte kjo pikë-  
risht, s'dinte ta shprehte. Kishte kohë që rrinin bash-  
kë këtu në aksion. Një natë, kur kishin mbetur pas  
shokëve, tek ktheheshin nga fshati, ai u përpoq ta  
puthte. Ajo s'e la. «Pse, Lejda, tha ai, unë e di që ti  
më do. Pse?» Edhe kjo s'i kishte pëlqyer. Shoqet  
e dinin, po s'e ngacmonin kurrë. Njëherë Lida e  
kishte parë drejt në sy.

«— Lejdush, nuk ke asgjë për të më thënë? Ajo  
qe skuqur dhe kishte ulur kokën.

— Lida, unë s'kam gjë me të. Vetëm më pël-  
qen dhe...

Lida e kishte tërhequr nga vetja.

— Mirë, moj kukull e vogël, vetëm ki kujdes,  
nuk zgjedh këpucë apo copë për fustan — dhe e kish-  
te puthur.»

Ishte ora e shfaqjes tani. Atë e kishin mbërthyer  
shqetësimi dhe emocioni i zakonshëm. Vullnetarët  
heshtnin. Fredi ishte përballë saj dhe i buzëqeshte.  
Dy shokët anash shikonin Lejden dhe pastaj Fredin  
me një ndjenjë inferioriteti. Nisi këngën. Ishte e pa-  
sigurt në çastet e para. Shihte fytyra të përqëndrua-  
ra, muzgun, ngjyrën e detit që po errej, xha Mihalin,  
teknikun e brigadës me mjekrën e mbështetur në  
grusht.

— E dashur Lida, — tha — e dashur shoqja ime.  
— Dhe pa sytë e saj, buzëqeshjen e saj, ndjeu zërin e

saj, bisedat e tyre për jetën, punën e dashurinë. Nga ngashërimi zëri i dridhej shumë në atë qetësinë karakteristike para mbrëmjes. E arriti refrenin. Heshti. Kompleksi i vajzave e kapi këngën dhe zërat e tyre formuan një sfond madhështor tingujsh. Këta tinguj ishin heroikë e, megjithëse në ta ndihej dhembja, s'ishin të përvajshëm. Ajo shikonte përsëri fytyra të përqëndruara. «Po ky, po ky, oh!» Fredi i buzëqeshte dhe i dërgonte të puthura me majat e gishtërinjve. «Sa i paturpshëm, oh, mamaja ime!» Diçka i dhembti në kraharor. U përpoq të mos shihte andej. Figura e xha Mihalit me konturin e tij të kërrusur ishte shprehje e një pikëllimi të madh. «A mundet, vallë. që një njeri i mirë të mos ndiejë dhembje në këtë çast, por ta ketë mendjen te sytë e një vajze?! Oh!» rënkoj ajo. E urreu. Në rrethin e ndjenjave, dashuria dhe urrejtja janë më të thellat e më të kundërtat. Por, ndonjëherë, ato vetëm një kufi mikroskopik i ndan midis tyre.

Vazhdoi përsëri këngën. Ndiante një siguri më të madhe në vetvete. «Më fal, Lida, tha, s'ishte kjo dashuria.» Këndonte. Silueta e saj në mugëtirën e mbrëmjes, me ato pantallona e me atë shall aksioni, zëri i saj i ngrohtë e tingëllues, gjithë qenia e saj e përpirë nga zjarri i ndjenjave, ishte si një premtim i madh që i jepej dikujt. Duart e erës loznin me flokët e saj. Tej oshëtinte deti. Ajo ngjitej lart, lart. Ishte çasti kur synon drejt një maje mali dhe, pasi ngjitesh atje, e ndien kraharorin të përshkueshëm nga gjithë flladet dhe erërat dhe vetja të duket e lehtë, sa e lehtë! Zëri i saj heshti dhe u mbështet i lodhur në sfondin e kompleksit. Dëgjoj duartrokitjet. Zhurmë. Radhët e fundit u çuan në këmbë. Ajo çau me vrap anash vullnetarëve.

— Të lumtë, Lejda, e thave fare, sot gjithë mbrëmjen me ty do të kërcej. — Fredi e kishte kapur nga krahu.

— Më lësho! — klithi ajo. U panë në sy. Ai ngriu dhe duart iu varën poshtë. «Ti mund të mos jesh i poshtër, thoshte vështrimi i saj, por mua m'u neverte. Mos m'u afro kurrë.» Ajo humbi me vrap midis ullinjve.

Lejda ndjeu t'i përplasej në fytyrë freskia e mbrëmjes. Qau. Qau ngadalë e butë, me kokën mbështetur mbi një trung tërë zgavra.

— Lejda, ç'ke, moj vogëlushe, mos qaj, kukull e vogël. — Luli që e kishte ndjekur pas, ia mori kokën në kraharorin e saj.

— Mos qaj, pra, ne të gjitha e kishim shoqe atë. — Por Lejda vazhdonte të qante, mbyturazi, me ngashërim, për Lidën dhe për diçka tjetër. Eh, si është shpirti i një vajze! Në një shteg në xhungël, ti shikon vetëm atë që ke përpara në atë shteg. Mund të ndodhë që aty pranë të ketë shtigje të tjera dhe ti, fare afër tyre, s'di ç'bëhet atje. Të dyja shoqet rrinin të përqaftuara. Luli s'e dinte se me këta lotë shoqja e saj e bukur e delikate që dinte të qeshte gjithmonë, nuk tregonte dobësi, s'e dinte se, me këta lotë, ajo përcaktonte më saktë rrugën e saj që nga ëndrrat vazhërore deri në bilancin e fundit jetësor, përcaktonte qëndrueshmërinë e saj në atë ngjitje të gjatë, të bukur e të vështirë, që quhet jetë.

## NATË NË HOTELIN MALOR

Duhej të shkruaja një tregim. Duhej patjetër të shkruaja një tregim. Ndonjëherë kështu të ndodh, mund të mos kesh asgjë të përcaktuar mirë në kokë dhe prapë... Binte shi. Shikoja jashtë xhameve të hotelit. Ky ishte një vend klimaterik dhe hoteli kishte çati karakteristike si në vendet ku bie borë e madhe. Unë isha i vetmi klient në hotel atë natë. Kjo më dukej pak si e çuditshme. Binte shi. Pikat mbledheshin në halat e pishave dhe, pasi zmadhoheshin e shkëlqenin, binin poshtë në tokën e lagët. Të gjitha pishat në koren e trungut kishin nga një të prerë. Me sa dukej, u kishin mbledhur rëshirën.

I thashë Jasharit të më sillte një teke raki.

— Miloti e ke?

— Miloti — tha.

— Mirë, sille dopio.

Ai rregulloi mbulesën e tryezës.

— Kur është kohë e mirë, — tha — këtu është bukur, kurse kështu... s'ke ç'bën fare. Le po i dhashë dhe letrat Dik kokëmadhit. Di të luash ti?

— Jo — i thashë.

— O, parmbrëmë lojtëm gjer pas dymbëdhjetës me një oficer, ja kështu binte shi. Edhe mbrëmë po

kështu ra. Është bërë shiu si puna e çesmës, me sustë; fillon nga ora katër pasdite dhe shkon gjer nga njëmbëdhjeta, dymbëdhjeta. Është burrë shumë i mirë ai oficeri.

— Ç'donte këtej? — thashë.

— Është këtu matanë qafës me ca ushtarë, bëjnë punime. Burrë i vjetër, o derëbardhë, ushtarët janë djem të rinj, ndaj vjen dhe nganjëherë këndej.

Jashtë mjegulla kishte zbritur poshtë fare dhe krihej midis pishave si tym i dendur.

— Duhet të ketë ujë këtej — thashë.

— Ou, në dimër ndodh që vijnë mu te xhamet ndonjëherë. Eh, ç'kohë është atëherë për gjueti!

U ndje një makinë. Dikush zbriti dhe po vinte me vrap midis mugëtirës e shiut. Shqova makinën që u nis e po ngjiste të përpjetën.

— Oho, Koçoja, — tha Jashari — ai oficeri, erdhi prapë, sa mirë bëri, është muhabetçi i madh.

Jashari u ngrit dhe ndezi ekspresin. Oficeri hyri dhe, te dera, shkundi pikat e shiut, përplasi fort këmbët dy-tri herë dhe hoqi kapelën.

— O Jashar, ore, po na mbyti fare ky shiu!

— E, e, — bëri Jashari — po ç'kemi, Koço, si ke qenë?

— Falemnderit, mirë. Si je? — më tha mua dhe më zgjati dorën. U ul përballë në tryezën time. Kjo m'u duk e natyrshme. Duhej të ishte midis 40 a 50 vjeç.

— Sot ke ardhur ti? — tha.

— Sot, — thashë — ti duhet të jesh nga Korça.

— Hajdeee, me predhën e parë, andej jam, nga fshatrat, po, ohu, kam ikur që i vogël.

Folëm ca për gjëra të përgjithshme, ç'punë bënim, ku banonim...



— Po hajde, o Jashar, hajde — tha.

— Ja, — tha Jashari — t'i them Sulës t'ju bëjë ndonjë gjë për darkë.

Pothuaj qe errur fare. Midis pishave dallohej atje lart livadhi rripa-rripa që ditën dukej aq i gjelbër.

— Drurë të bukur pishat — i thashë.

— Të bukur, — tha — pishat janë drurë të vërtetë ushtarë, të tjerët janë rezervistë.

E kuptova dhe buzëqesha.

— Bukur e the, — i thashë — shumë bukur!

Folëm për gjëra të ndryshme. Kuptohej që qe i lodhur.

— Kam qenë në shumë qytete, — tha — kështu e ka puna jonë. Tani kam nja pesë-gjashtë vjet që jam këtu. S'luaj më tani. Më thanë të shkoja në Peshkopi, me ngritje. «Falemnderit, u thashë, mirë jam këtu.»

«Punë dreqi, thashë me vete, një oficer që i trembet të ftohtit, që e ka mbërthyer rehati e s'e lëshon, a bëhet ky personazh pozitiv në një tregim? Po kështu, duket burrë i mirë.»

Seç më kapi një mërzitje dhe fillova të mendoja për temat e ndryshme, për tregimet që kisha shkruar dhe për mjeshtërinë e të shkruarit të tregimit. Oficeri po fliste e po qeshte me Jasharin. Seç thoshin për një shofer të urbanit që bënte përditë këtë rrugë. Shiu ishte shtuar. Shkreptinte shumë. Oficeri tregoi nja dy histori. Pastaj foli për një makinë që kishte rënë një ditë më parë në një rrugë ushtarake.

— Qe djalë i mirë shumë, — thoshte për shoferin — xhevahir djalë. Duke vdekur qe dhe: «Më falni, ore shokë», u thoshte të tjerëve që ranë tok me

të. Ata qanin, të tre kishin plagë të lehta, njëri kishte nxjerrë krahun. Eh, ç'djalë i mirë që ai shofer!

Po shkrepinte shumë. Një radio me bateri që kisha me vete, riprodhonte zhurmën e çdo shkarkese por, ngaqë kënga më pëlqente, po e duroja. Oficeri shau shiun.

— E teproi, — tha — na prish shumë punë ky drej.

U ngrit dhe mbështeti ballin te xhami. Befas një fashë e kuqe çau aty pranë errësirën. Krisma që shumë e fortë. Një nga xhamet ra copë-copë dhe zhurma e tij bëri që të zgjatej përshtypja e rrufesë. Pa e kuptuar, kisha mbyllur radion. Dritat qenë fikur.

— Hajde kalibër, hajdeee, — tha Jashari në të errët — bah, sa e fortë!

Ndeza çakmakun. Jashari, duke u mbajtur pas tryezave, erdhi me ca fenerë në duar. Oficeri s'fliste. Cigarja i ndizej e i shuhej.

— Ra matanë qafës — tha pas pak.

— Ëhë, — tha Jashari — kësaj s'ke ç'i bën, jo, kjo të vret, për nder.

— Ej! — thirri Sula nga kuzhina. — O Jashar, bjer një fener, se ju lashë pa darkë!

— Erdha! — tha Jashari.

— Ra përtej qafës — tha prapë oficeri.

— Jo, more, do të ketë qenë larg, nga mali, po të gënjen rrufeja, duket sikur bie afër — tha Jashari. — Ndizu, mor i shkretë, hë!

Feneri bëri një dritë të zbetë. Jashari ndezi tjetrin.

— Jo, jo, e pashë mirë unë, — tha oficeri dhe shtypi fort në tavëll gjysmën e cigares — e pashë mirë, aty ra.

— Ku? — thashë unë.

— Aty ku punojmë ne, aty ra — dhe u drejtua nga dritarja.

— O Jashar! — thirri Sula.

— Plaç! Erdha, të thashë.

Oficeri mori kapelën.

— Do iki. Më jep një fener, o Jashar — tha pas pak.

— U çmende, — tha Jashari — rri, o Koço, se s'dilet në këtë gamet.

— Ke telefon këtu? — thashë.

— U prish e s'prunë më — tha prerazi Jashari.

Oficeri mbërtheu këmishën.

— Janë djem të rinj, — tha — kushedi... Kam lënë një oficer atje, po dhe ai djalë i ri është. Duhet vajtur — tha dhe bëri nga dera.

— Gabim — tha Jashari.

— Jo, jo, do iki — tha dhe në zërin e tij dukej këmbëngulja.

— Prit, na, Koço, na xhupin tim atëherë, ja...

Jashari u fut pas banakut.

— Do ta kesh vështirë — i thashë. Ai vetëm tundi dorën.

— Ishte shumë e fortë, e mallëkuara, në Mir-ditë më ka vrarë një shok, edhe mua më shurdhoi për ca muaj atëherë.

Pas pak ai doli dhe nën dritën e fenerit të tij pashë se shiu ishte i dendur e i rrëmbyeshëm. Jashari po e shihte që nga dera.

— Budallallëk bëri — tha — ...po ndoshta ka përgjegjësi, ë, si thua?

— Kushedi, — thashë — po, edhe po të ishte aty, rrufeja prapë mund të vriste njeri, po të binte aty. Po... më mirë që shkoi.

— Eh! — rënkoi Jashari dhe shkoi nga kuzhi-

na. Pashë nëpërmjet xhamit. Drita e fenerit po humbte midis shiut dhe pishave. Dhe unë mendova për atë oficer. Shiu përplasej të xhami. Kohë pas kohe era në plasat e dritareve dhe të dyerve bënte «vuuuuu, vuu» dhe të lindte përshtypja se gjithë ajo masë e errët dhe e lagët ishte një qenie e gjallë e shqetësuar. Përsëri mendova për tregimet, për heronjtë e tyre, për atë që personazhet janë njerëz të gjallë dhe pikërisht këtu është bukuria e tyre.

Pastaj afrova fenerin pranë vetes dhe shkrova këtë tregim.

## N Ë O Q E A N

Kishim hyrë në gjirin e Biskajës. Nga kuzhina vinte erë e mirë.

— Djem, djem, më lini rehat, xhanëm... ore, e lashë fare, për nder.

— Hë, hë, se ashtu thua ti... xha Azbi, thonë se ti ke bërë hallvë edhe në Stamboll për atë, mor... thuaje, mor... sulltan Selimin, ë?

— Ha, ha, ha!

— Hilmiu doli me vrap i ndjekur nga një bisht preshi që i hodhi xha Azbiu. Anija ecte mirë. Shikoja djathtas me dylbi brigjet portugeze që po mjegulloheshin. Zagushi.

— Do të fillojë, më duket — tha kapiteni. — Kështu e ka këtu... ore, ç'është kjo erë e mirë?

— Xha Azbiu po bën hallvë, kapiten.

— Jo, ore... ha, ha!

Dallgët shtoheshin. Horizonti po nxihej. Megjithatë në kupë të qiellit dielli ndriçonte i mekur.

— Diell i sëmurë, — tha kapiteni — duhet të dalim nga gjiri. Me tërë forcën!

— Si urdhëron, me tërë forcën!

— Majtas, dhjetë gradë!

— Majtas, dhjetë gradë!

Hyri komisari. Anija po lëkundej keq. Pamja po ndryshonte rrufeshëm. Çdo gjë u nxi. Retë qenë ulur dhe dukeshin që ja... dhëmbët e dallgëve do të gërvishnin masat e tyre të murrme e sfungjerore.

— Filloi, Miço — tha komisari.

— Filloi, — tha kapiteni — djall, na mbeti hallva e xha Azbiut.

Qeshëm.

— Vini re! Siguroni bakaportat, shtrëngoni kavot e kicët. — Kapiteni mbylli tubin.

Anija dridhej nga çdo goditje dallge. Pamja e errët që kishim përpara çahet herë pas here nga zigzagët e rrufeve. Mbi xham u përplasën rrëketë e shiut dhe të dallgëve. Pasi binte dallga, mbeteshin konturet e shkumës.

— Këto, po, këto janë dallgë, shoku zëvendës, — më tha Gjini — për nder, s'ka për të më besuar njeri se kam parë të tilla.

Gjini e kishte lundrimin e parë në oqean. Dallgët qenë të mëdha, vinin të rralla, po, kur vinin, kalonin nëpër gjithë anijen, nga bashi në kic. Poshtë, motoristët qenë mbytur në djersë. Me ta që dhe inxhinieri, gjysmë i zhveshur, i shtrirë nën tubat e ushqimit. U çua.

— Hë, — i thashë.

Bëri me dorë.

— Do ta hedhim. S'besoj të na lënë në baltë. Defektin e të majtit e eleminuam.

Anija mori kren. U rrëzuam.

— E fortë, — tha inxhinieri — det si ky s'kemi çarë ndonjëherë.

— Do ta çajmë! — thashë.

Dola duke u mbajtur. Dallga më ra mbi gjithë mushamanë. Po kulloja ujë.

— Keq, — tha kapiteni — gjysmë orë, s'kemi bërë as një milje. — U përkul te tubi telefon.

— Ç'kemi ndonjë gjë, Nasi?

— Një anije angleze dha SOS, duhet të jetë diku përpara.

— Mirë, dëgjo. Lajmëro qendrën: «Jemi në Biskajë. Po kalojmë stuhi. Gjendja e anijes, normale.»

— Ja tek është — thashë — ajo anglezja. — Me dylbi shquhej një njollë e errët përpara.

— Po... tanker është. Është ajo që kaloi para nesh në Gjibraltar, 40-mijshe.

Ishte e vështirë të ruaje ekuilibrin. Anija kërcente mbi dallgët si lëvozhgë arre.

— Shoku kapiten, e pamundur, timoni s'manovrohet dot. — Timonieri fshiu djersët me mëngën e bluzës.

— Përpiqu të ruash drejtimin. Gjysmë force!

— Si urdhëron, gjysmë force! — Pamë njëri-tjetrin në sy. Ra zilja.

— Nga porti kërkojnë hollësisht gjendjen, shoku kapiten.

— Transmeto: «Moral i rregull. Do ta hedhim.» — Iu kthye komisarit: — Thuaju ndonjë gjë djemve, Telo.

Komisari iu afrua gypit.

— Vini re! Gjithë ekipazhit. Shokë, anija jonë po kalon një provë të vështirë. Kërkohet prej të gjithëve guxim, saktësi në detyrë e moral i lartë. Atdheu pyet për ne dhe kërkon të dijë gjendjen tonë. Me vendosmërinë që ka edukuar te secili Partia, me unitetin tonë të pathyeshëm, patjetër do të fitojmë. Komunistët le të japin shembullin personal në qëndrueshmëri dhe optimizëm. — Komisari mbylli gypin. Vrojtuesi thirri:

— Bordi i majtë, një anije! — Kthyen kokën.

— Ajo është — tha kapiteni. Mori dylbitë. —  
Po... ajo që the ti, Telo.

— Qenkan trembur, — thashë — është 15 herë më e madhe se jona dhe kërkohet ndihmë. — Sapo mbarova fjalët, tankeri u çua më dysh i kapur në dy kulme dallgësh, në distancë afër 200 metra. Më shpëtoi një thirrje. Komisari mbuloi fytyrën me duar. «O nënë!» pëshpëriti Gjini afër meje. Mbi dallgët s'dukej gjë hiç.

— E tmerrshme, — tha kapiteni — ky fenomen ndodh rrallë, nën anije formohet një farë depresioni, eh...

Të vinte çudi kur mendoje se si u zhduk ajo anije gjigante për më pak se një minutë. Aty pranë u dukën tri njolla që afroheshin. Zilja.

— Shoku kapiten, nga kryqëzorët amerikanë transmetohet se janë gati të na rimorkiojnë.

— Janë të bazës së Baleareve — tha komisari. U pamë të tre në sy. Kapiteni iu afrua tubit.

— Sektori i motorëve, si shkon puna?

— Në rregull, kapiten, po mundohemi t'i dalim përpara çdo avarie. — Inxhinieri u kollit. Kapiteni m'u kthye mua.

— Të përcaktohet vendndodhja!

— Si urdhëron!

U pamë prapë të tre në sy.

— Mirë, — tha kapiteni — alo, Nasi, transmeto se s'kemi nevojë për ndihmë. Kemi çarë stuhi më të vështira se kjo. Ashtuuu? — Pastaj pa komisarin.

— Pse s'je rruar, o Telo?

— Shiko veten, o derëbardhë, oreee... — Qeshëm. Shkova te shturmani.

— Jemi në... Kemi bërë vetëm një milje e gjys-



më nga fillimi i stuhisë. — Jashtë diçka kërciti.

— Po thyhet direku i vogël!

U vërsula shkallëve.

— Kujdes! — thirri kapiteni.

Azizi, Hilmiu e Gjini po përpiqeshin atje. Kishin hedhur tri kavo rreth.

— I vëmë dy traversa anash! — thirra. Na mbuloi dallga. U mbajta fort. Pastaj ndjeva një dhembje therëse dhe asgjë më.

Kur hapja sytë, në kabinë binin rrezet e diellit. Kokën e kisha të rëndë. U përpoqa të buzëqeshja. Kapiteni fërkonte mjekrën me dorë dhe buzëqeshte.

— Paska pushuar — thashë.

Doktori pa orën.

— Vazhdoi plot 4 orë e 31 minuta. Stuhi qe, jo shaka.

Hyri Nasi.

— Shoku kapiten, radiogram. Si je tani, shoku zëvendës?

Buzëqesha.

— Na urojnë — tha kapiteni dhe i zgjati radiogramin komisarit. — Harruam fare, — shtoi pastaj — haje, se t'u ftoh, le që e ftohtë halet kjo. Ka bërë një hallvë xha Azbiu, lëre! Dhe shih sa ta ka mbushur ty.

Mbi komodinë pjata avullonte. Përreth oqeani zhurmonte lehtë si një foshnjë e pafajshme.

## HOMO SAPIENS

Dielli ishte ngjitur mbi kodrat dhe toka e sapo-lëruar avullonte. Kjo ishte një frymëmarrje gjigante.

— S'po mban mirë prilli, jooo, — tha Mete Ballëmadhi — diell gënjeshtar ky, duket që në surrat. Haj, haj, oreee! — u bëri pastaj qeve dhe i shpoi që të ktheheshin majtas. Kooperativa i kishte tokat të shpërndara nëpër pjerrësira dhe atyre që lëronin, u takonte të punonin larg njëri-tjetrit e tërë ditën të mos shkëmbenin fjalë me njeri. Ndoshta këtej e kishte dhe Mete Ballëmadhi zakonin që shpeshherë i shprehte mendimet me zë. Rreth e rrotull pamja hapej e hapej gjer larg. Mbi shpatet e kodrave dhe poshtë në fushë këmishat e fshatarëve zbardhnin mbi fondin e dherave. Aty nënë të lëronte Fania. Parmenda i kuiste dhe dëgjohej gjer sipër. — Ptu! — bëri Mete Ballëmadhi. — Mos çajë kokën burri? Gërr-gërr. Qysh e duron, xhanëm?

— O po, shtrëngoje, ore, shtrëngoje! — thirri befas. «Oo, oo, oo», ia bënë kodrat me radhë.

— Ç'thua, o, ç'thua? — Fania fshiu djersët dhe vuri dorën mbi vesh.

— Shtrëngoje, të thashë, shtrëngoje! Dëgjon, ore?! «Eee», bënë përsëri kodrat.

— E ç't'i bëj unë, o? — thirri Fania me sytë gjysmë të mbyllur.

«U bëfsh lëmsh ti me gjithë parmendë!» shau Metja me vete dhe i ktheu shpinën. Nguli hostenin dhe çapiti drejt një dardhe në krye të arës. Nxori nga torba shishen e dhallës dhe hoqi nja dy gllënka. Pastaj kërkoi në xhepa kutinë e duhanit. «Dhemb, moj dorë, dhemb ti», tha. Ngriti mbi bërryl mëngën e këmishës. «E nga m'u shti kjo gjë e ligë, ore? Të ma ketë ngrënë gjë, jo, ta kem vrrarë gjëkund, jo, or, jo. Hiqu, lanet, hiqu!» Ia nguli sytë bërrylit të enjtur. Qimet aty ishin rralluar dhe mishi qe bërë mavi. Po ta shtypje me gisht, zbardhej, pastaj bluja vërshonte dhe e mbulonte prapë. Që andej dhembja përhapej valë-valë në krejt trupin. Ai e mendoj njëherë vendin e dhembur si ajo kuçedra nëpër përralla që hidhte flakën nga goja, pastaj s'i pëlqeu kjo, deshi të mendonte ndonjë gjë me gjermanin e luftën, por prapë s'i pëlqeu. «E ç'ke, o qerrata dorë që dhemb, ç'ke? tha Mete Ballëmadhi. Lipset vajtur në qytet, tha, lipset vajtur. U bënë dy javë që thanë doktorët, të shohim ç'do kullundrisin tani. Ai drodhi duhanin. Eh, doktor po doktor kishim ne, atje në mal, ore, doktor me hallë. Si s'e kam pjekur një herë, xhanëm, ku të jetë vallë?!»

Mete Ballëmadhi shtroi pallton e vjetër ushtarake dhe u mbështet mbi të. Dheu avullonte dhe ai u mbush me frymë. «Po vjen behari, po vjen. Dardha kishte lëshuar lule. Eh, moj çupë, tha Mete Ballëmadhi, mos të të gënjejë prilli, moj çupë.» Lulet dridheshin nga era e lehtë. Lastarët e hollë të dardhës fërgëllonin dhe atij iu duk sikur dardha këndonte një këngë me zë të hollë. Shtriu njëren dorë mbi plisat e copëtuar ndanë palltos dhe tërhoqi dheun e

njomë. Një mizë dhe i eci mbi faqen e parruar. Ai e zuri me dy gishtërinjtë e zverdhur nga duhani dhe e lëshoi lehtë pranë trungut të dardhës. Milingona u mblodh kruspull e s'lëvizti më. Mete Ballëmadhi u përkul mbi të dhe e ngau me një fije bari. «E po s'të paçë faj, de. Milingona s'lëvizte. Pse je kaq e dobët, moj e gjorë!» Ai hoqi një herë duhan dhe u mendua një hop. «E ç'kundon kështu, o Mete ziu! Tymi i shkoi keq dhe ai u kollit. Ptu!» Eh, o Mete Ballëmadhi! Ç'të gjeti ty, njeri mos gjettë! Po pse, or jahu, kështu do t'ia hedhësh vetes sate ti, në të dhemb dora?!» Ai u rrudh nga dhembja dhe bëri «Ooo!». Afër dëgjohej cicërima e një zogu. «Nuk të shaj, moj dorë, nuk të shaj, se më ke bërë hyzmet. Po edhe unë hyzmet të kam bërë, moj e uruar. Luftuar e punuar tok kemi. Qysh t'i harrosh të gjitha kështu, ë? Ai pa retë dhe qiellin. S'bëhet grurë aty, or jooo, as misër s'bëhet! Eh, or dhé, të qofshim falë ty.» U kthye brinjas dhe mbështeti faqen mbi plis. Ndjeu vlagën dhe psherëtiu i kënaqur. Mbi mustaqet e qimet e mjekrës mbetën kokrrizat e dheut. «Pa hë, i tha vetes, ha atë kafshitë dhe ngrehu tani. S'i vinte fare për të ngrënë. O po s'më shkon, o, s'më shkon», e zgjati zërin. E vuri veten të mbllaçitej me zor. Një lule e dardhës i ra në prehër. Ai e mori në pëllëmbë dhe e kundroi nga afër. Pastaj e shtrëngoi dhe gishtërinjtë iu njomën. «Ruhu, moj çupë, tha Mete Ballëmadhi, ruhu, moj bijë.» Dardha fërgëllonte e gjitha në erë dhe atij prapë iu bë se ajo këndonte. I theri gjithë ana e trupit dhe deshi të thërriste, por bëri vetëm «Uu» dhe u ngrit. «Mirë, pa hesht tani! Nesër do të të shpie në doktor. Dëgjove? Hesht tani! T'i bëjmë dhe këto dy ara që na mbetën.» U vuri dorën turinjve të qeve dhe diç u nanurisi me zë të ulët.

Kjo ishte një përzierje fjalësh pa kuptim, që ai ua thoshte kurdoherë atyre me një zë të dhemshur që s'dukej si i tij.

— Haj, haj, de, o burra! — thirri pastaj.

— Mete ore! — Fania kishte vënë duart si bori.

«E, e, e,» bëri jehona.

«Mirë ka punuar qerratai, mirë ka punuar», tha Metja.

— Hë! — bëri pastaj, më shumë për vete se për të.

— A të dhemb më, ore, a të dhemb?» «Ëmb, ëmb, ëmb», bënë kodrat.

Mete Ballëmadhi i tundi dorën e shëndoshë dhe rëndoi mbi dorezën e parmendës. Kafshoi cepin e mustaqeve. «E po mirë, de, mirë, e thamë një herë. Nesër, nesër do të të shpie. Ç'ke që bën lënjë tani?»

— Haj, haj!

Plugu çau dheun dhe ai thithi avujt e ngrohtë. Pas mbeti gjurma e bukur kafe që dallohej kollaj nga braza e hapur një çikë më parë.

— Haj, o burra, haj! — thirri Mete Ballëmadhi.

\* \* \*

Qyteti ishte i madh e i bukur. Ishin orët e mbrëmjes dhe kishte shumë lëvizje dhe zhurmë.

«Mirë e kanë stisur këtë qytet, tha Mete Ballëmadhi. Feks i tëri nga dritat». Ngriti mbi sup pallton ushtarake hedhur krahëve dhe bëri më tej.

— Ku ka hotel këtu, o djem? — pyeti.

— Turizmin do? — tha njëri nga ata, një djalë i gjatë me prenka.

— Hotel të jetë, de.

— Ja, o xhaxho, atje tej, ajo ndërtesa e madhe — tha një tjetër.

— Ajo që feks, o?

— E, ajo që feks — qeshën me dashamirësi djemtë.

— Ju paça, o djem! — tha Mete Ballëmadhi e eci përpara. Te hyrja e hotelit një djalë po ndizte cigaren po s'ia linte era. Metja e pa njëherë në profil, pastaj i doli përpara.

— O Gani mësuesi! Gani mësuesi, ore!

— Xha Mete! Po ti, nga dole kështu?! Ke ardhur te mjeku, ë? — Mësuesi e zuri nga supet dhe sytë i shkëlqyen.

— Po, or, po. Ja, thashë të fle këtu sonte.

— Shumë mirë. Hajde, unë tani sa zura vend. Flemë bashkë. Letërnjoftimin e ke?

Ata hynë pas derës me xham dhe që jashtë dukej se si ai djali i ri jepte e merrte me duar te sporteli e diç i thoshte asaj gruas aty duke treguar Meten.

\* \* \*

Mësuesi u zhvesh dhe hyri në shtrat. Mete Ballëmadhi u ul dhe nisi të dridhte një duhan.

— Shumë harxhe bëjnë, — tha — tri elektrikë... boll është një, or, jahu. Pa shih, dy te koka, një atje në tavan... pa shih, një atje tej, katër fare.

Mësuesi buzëqeshi dhe vuri më dysh jastëkun nën zverk.

— Po mirë, mos i ndiz të tëra ti... Ç'të thanë doktorët?

— Ja, ashtu.

— Si ashtu?

— E, or... jahu, si ashtu, ja ashtu... Doktor po doktor kishim ne, ore, atje në mal. Pushkës bamp e, për të ujdalur, menjëherë të ujdaste. — Mete Ballëmadhi i shkoi gjuhën letrës së duhanit.

— Cili doktor të vizitoi, xha Mete?

— Ishte një, një Petrit, kështu më ngjan se i thoshin.

— A, a, mos e shaj! Petriti është specialist i mirë. Thonë të gjithë për të.

«I bëmë analizat, o xhaxha, tha, s'kemi ç'i bëjmë, do ta putojmë, s'ka derman, ta putojmë», tha. Kështu tha.

— Ta amputojmë, — ndërhyri mësuesi — ta presim, domethënë. Pse, ashtu tha vërtet?

— E, or, po qysh.

—« Po fol shqip, o i uruar, i thashë, fol shqip, se s'di kështu unë.

— Po ja, xhaxha, — tha ta presim, — tha — ta presim.

— Dale, or jahu, — i thashë — dale! Dhe një degë pemë të preç, njeriut i vjen keq, jo t'i preç një krah. Dale, or jahu.

— S'kemi si ia bëjmë, — thosh ai — ndryshe rrezikohesh, o xhaxho».

Mete Ballëmadhi ndezi çakmakun dhe mësues Ganiu pa se si flaka i mori dy-tri fije nga të mustaqeve.

U dëgjua një kërcitje si nga shkarpat. Metja u ra me dorë dhe thithi duhanin. Një copë herë ai ndenji ashtu i zhytur në atë vello të bardhë në të kaltër.

— Po pastaj? — tha mësuesi.

— Ehuu, pa lëre shejtanin fare. A nuk na këndon atë këngën e atij Sheme partizanit? Ma këndo! — Ganiut iu kujtua blloku i vjershave në xhep të

xhaketës dhe i kaluan vetëtimthi para sysh gjithë dita, bisedat me shokët, takimet me redaksitë e gazetave.

— E ke dëgjuar kaq herë atë, kam shkruar dhe të tjera.

— Ajo më pëlqen, e ke qarë atë fare.

— Mirë, mirë, po më thuaj njëherë, si shkoi puna.

— Palopunë, ç'e do fare...

— «Jo se kam frikë ta pres, ore, — i thashë — jo, merr vesh ti, jo se kam frikë, po më lipset, ore, më lipset. Jemi kooperativë malore ne, punojmë me qe, e nget dot me një krah parmendën ti, ja, e sheh, e nget dot? Më duhet, ndaj them dhe unë...

— Mendon shteti — thosh.

— Mor, po ç'mendon shteti... po s'menduam ne për të, ç'u kuptua. Pse, i kujt qenka shteti? S'dua pension unë, or, jo — i thashë. Po ai aty se aty. Se ç'më thosh:

— Mjekësia është shkencë, — thosh — ka rregulla, ka... pastaj thosh se unë s'bëkam dot përjashtim se dhe unë qenkam Humo Capiu. E thoshte shumë këto djallo emër. Mor, po me kë më nakatës ky, ore, thashë.

— Unë jam Mete Ballëmadhi, — i thashë — oreee. Mete Ballëmadhi, jo Humo Capiu, mos më merr jangllësh mua, o doktor. Dhe dorën nuk e pres, or, jo, se jemi kooperativë malore ne. — Ja kështu i thashë. Ndenji ca pa folur ai. U skuq gjer në veshë dhe e pa me inat një nga ato çupat fermiere që qeshte. Pastaj u ngrit e doli. E më t'u mblodhën nja katër a pesë, ca të vjetër, ca të rinj. Doktorë të gjithë. Njërit i thoshin «profesor», me syze ish, si ai yni, i mallit. Shiko andej, shiko këtej dorën, seç shihnin dhe ca fotografi.



— Xhaxha, — tha njëri pastaj, ai me gjyzlykë — do të të shtrojmë në spital ca kohë.

— Jo, ore, — i thashë — se s'rri dot aty unë».

— Nuk ta presim, — tha — nuk ta presim, mos ki merak. Po do shtruar, ama». Seç tha për ca ilaçe, për ca kura me rezera, e ku di unë. Më dhanë dorën të gjithë. Dhe ai i pari. Ai s'më shihte në sy dhe të kuqtë s'i kishte shkuar akoma. Kështuuu. Kështu puna. Tani dhe unë nuk di si të bëj. Ta pleqërojmë dhe në fshat njëherë. Po të kishim mbaruar së mbjelli njëherë, or, të shkretën.

Mësues Ganiu kishte ngrirë ashtu mbi jastëk dhe dora i kishte mbetur në mjekër. Prapë iu kujtua blloku i vjershave dhe mendoi se do të griste shumë faqe aty.

— O ç'thua ti, ë? Ç'thua ti? Të zuri gjumi, o Gani mësuesi, të zuri gjumi, ore?

— Jo, jo, — tha Ganiu — mos e bëj fjalë fare, të shtrohesh menjëherë, dëgjon, xha Mete. Nejse, e bisedojmë nesër në fshat. Pasnesër do të të nisim prapë për këtu.

— Eh, të shkretën, ore, — tha Mete Ballëmadhi — po s'rri dot shtrirë, mor jahu. Ta mendosh hollë, ashtu është, siç thonë ata. Dhe dheut, që është dhé, ia bëjnë hyzmetin dhe e shërojnë, kur sëmuret; i japin ilaçe... ilaç është plehu. E drejta është që për vetë s'mendojmë shumë, or, jo. Na duhet toka, po dhe ne i duhemj tokës. Kjo është, s'ka tjetër. Po që s'më rrihet shtrirë, për nder që s'më rrihet, or, dëgjon. Eh, eh, doktor po doktor kishim ne. Si s'e kam pjekur vallë. Ishte trim burrë. Pse, mos të shtronte nëpër spitalëra ai, ore?! Hiç, or, hiç. Kurse ky, ky, ore... tani nuk them, jo djalë i mirë mbase ish, po ja, më

nakatosi me Humo djallin mua. Mos i kisha thënë, fap krahu mua.

Mësuesi buzëqeshi. Pastaj buzëqeshja erdhi e iu tret dhe tiparet iu tendosën. Ai ngriti jastëkun më lart.

— Jo, xha Mete, — tha — ti je vërtet Homo Sapiens.

— E si qenkam unë, ore? Mor po ç'është ky lanet?

— Kështu i thonë njeriut me emër shkencor, xha Mete.

Mete Ballëmadhi la mënjanë duhanin.

— Po mirë, mor jahu, pse s'ma thosh shqip ai?! O po i kanë lënë mendtë fare ca, i kanë lënë, fol, mor jahu, shqip... E, kështu u thonë njerëzve the ti, ë, me shkencë ë?

— Kështu u thonë. Po ti je një Homo Sapiens i vërtetë, se jo kujtdo i shkon ky emër. Ty po, xha Mete.

Mësuesi shkoi gishtërinjtë nëpër flokë dhe u zgjat për paqetën. Mete Ballëmadhi kishte marrë në duart e ashpra fundin e batanijes dhe diç mendonte. Tymi i duhanit ngrihej dallgë-dallgë rreth tij.

## ERA E NËNES

Nënia më veshi trikon e leshtë dhe unë e kuptova se për diku do të niseshim.

— Ku do vemi, nëne? — thashë.

— Në teqe, të kegen, — tha nënia — në mekam, te baba Ahmeti.

— Mirë jemi këtu, nëne — thashë.

— Hesht! — tha nënia. — Baba Ahmeti është goxha burrë, ja, do ta shohësh ti. Do hash dhe hashër, dëgjon?

Kur qemë nisur për në fshat, unë e dëgjova babanë tek i thoshte nënes të mos më shpinte në teqe. Babai im i shante shpesh ata njerëz të fesë, për të cilët nënia kishte respekt. «Kurrë ndonjëherë, thoshte babai, nuk u shkulën fukarallëku dhe mjerimi me lutjet dhe nuskat e tyre. U deshën pushkët tona për këtë». Nënia s'fliste fare, po mirë nuk i vinte. «Mirë, mor bir, kishte thënë nënia, s'do ti, nuk e shpie djalin». Dhe kishte varur buzët.

Kishim tri ditë që kishim ardhur në fshat. Unë e shihja me vërejtje gjyshen. Ajo sikur që ndryshuar e që bërë tjetër. Në shtëpinë tonë, në qytet, ajo fliste me zë të butë e të ulët, sikur të kishte

frikë mos zgjonte njeri. Mua më dukej gjithmonë e vogël dhe e brishtë dhe e pyesja:

«Sa vjeç je ti, nëne?»

— Po unë jam plakë, të keqen, — thosh nënia — g'pyet për vjeç, kush i mban mend, shtatëdhjetë a tetëdhjetë». Unë futja turinjte në prehrin e saj dhe ndoshta nga të leshtat që mbante veshur, ndoshta nga diçka tjetër, ndieja një aromë të tillë që më ishte kaq e dashur dhe gjithmonë më qetësonte. Unë i thosha asaj «era e nënes». Po këtu në fshat ajo vërtet sikur kishte ndryshuar. Sapo zbritëm nga makina e hipëm në kafshët që na prisnin, asaj sikur iu bë zëri i fortë e më i ashpër.

— Nuse, — i fliste gruas së xhaxhait — pa hë, ngrehu e jepu bukë fëmijëve. Tunduni ju, të paudhë, pa hë! — u thërriste djemve të mëdhenj të xhaxhait. Të gjithë i bindeshin nënes dhe unë e shihja me çudi. Se si m'u duk, ndaj dhe s'ia kujtova që babai s'donte që unë të shkoja në teqe. Nënia bëri gati një bohçe me plaçka.

— Ç'u mbodhis dhe ky i shtënë, — tha — pa dil e shih njëherë ti, more!

Bashkimi doli jashtë, pastaj hyri me vrap dhe thirri i gëzuar:

— Erdhi, erdhi, ia njoha zënë.

Nënia kishte porositur të vinte Muçoja, kushëriri i saj nga Kreshova. Ai hyri në odë. Duart i mbante të varura poshtë, me pëllëmbët të hapura.

— Qysh jini, mirë? — belbëzoi. Së pari më zuri mua. Më ngriti lart dhe më puthi «plluq, plluq» duke më belbëzuar ca fjalë që s'i merrja vesh. Mua më shpuan qimet e mjekrës së tij. Muçoja kishte fytyrë të kuqe, flokë të përhimtë dhe vinte erë duhan.

Pastaj ai u poq me nënen. Ata u puthën dhe ai thoshte si fëmijë:

— Të keqen, moj nunù, më kishte marrë malli, moj, nunù moj!

Për një kohë ata pyetën njëri-tjetrin për njerëzit. Nënia piu një cigare. Kur pinte cigare, nënia dukej si ndonjë burrë, vrenjtej në fytyrë dhe e nxirrte tymin serbes me një hije të rëndë.

— Ç'kafshë ke sjellë? — tha nënia.

— Pelën e Sulos dhe mushkën time — tha Muçoja.

Pse s'i more pelën Veliut, apo s'ta dha qeni, ë? Dale pa më sheh.

Muçoja belbëzoi diçka dhe desh të justifikonte Veliun. Po nënia bënte «hë, hë» dhe tundte kokën. Pas ca u ngritën e dolën.

— Të nisemi, — tha nënia — se mos na zërë nata. Nuse, — i thirri së shoqes së xhaxhait — më bëj hazër ca fiq të thatë t'i marr kur të kthehem, dëgjove, moj?

— U, moj nunù, pse kaq e pate ndër ne ti?

— Do vij, të thashë, nga Kreshova, do vij të rri dhe nja dy ditë.

— Mirë, të keqen, ashtu të keqen — thoshte nusja dhe i rregullonte velenxën nënes mbi kalë.

— Muçoziu, ujdise mirë djalën se mos më gremiset, ku të mbytemi pastaj unë e ti, o i zi?!

Mua më hipën te pela e bardhë. Pela ishte e urtë dhe unë i lëmoja jelen duke u përkulur mbi të. Ajo mënjanoi qafën dhe unë e hoqa dorën shpejt.

— T'ju gjejmë shëndoshë! — tha nënia dhe u nisëm. Muçoja hiqte pelën time nga kapistra. Udha gjer në teqe ishte e gjatë dhe unë u lodha mjaft.

— Ja dhe një çikë, të keqen, — thoshte nënia — ja, se sosëm.

Në teqe arritëm me ditë. Unë shihja përreth me habi.

— Pse, kjo është teqeja, nëne? — thashë.

— Kjo, të keqen, dale pa do ta shoq.

Ishte një shtëpi e madhe dhe e bardhë, si shtëpitë e fshatit, po më e madhe. Kishte shumë pemë rreth e rrotull dhe mua më mbetën sytë te ca fiq të zinj e të rreshkët që mend binin përdhe. Nga dera doli një burrë me mjekër të zezë e me fustan të gjatë si të grave.

— Mirë se erdhe, hanko Qamilja, mirë se erdhe! Ç'të përmbysim, ç'të përmbysim? — thoshte burri me fustan, duke u përshëndoshur me nënen.

— A, dervish Teme, Temeziu, ç'je ligur këshu, or të vraftë Abaz, Aliu! — qeshte nënia. Dervishi u përshëndosh dhe me Muçon, pastaj m'u afrua mua. S'di përse më trembi pamja e tij dhe u struka në fustanin e nënes.

— Ç'ke, të keqen? — tha nënia. — Pa hë, mos ki turp, piqe dervish Temen, piqe, se e kemi tonin.

Dervishi më nduku faqen dhe i thirri dikujt e vajtën të lidhnin kuajt.

— Babai ju pret brenda, hanko Qamilja — tha ai.

Nënia rregulloi shaminë e ngriti bohçen nga toka. Ngjitëm tri-katër shkallë dhe shkelëm në një dysheme dërrase të vjetër që kërciste.

— Të keqen nënia, — pëshpëriti ajo — puthi dorën babait kur të hyjmë, dëgjon, puthi dorën, se s'është mirë.

Mua m'u skuqën majat e veshëve. Gjithmonë më bëheshin kështu sa herë që më digjnin. Hymë në

një dhomë të madhe. Unë u mahnita. Aty kishte plaçka të bukura dhe muret binin erë gëlqereje. Në krye, tek oxhaku, rrinte një burrë i madh, me mjekër të bardhë e me një si taç të gjelbër në kokë. Burri u ngrit e na doli përpara në mesin e dhomës. Kishte rroba të bukura ngjyra-ngjyra, që i derdheshin gjer në fund të këmbëve. Mbi barkun e madh i varej diçka e ndritshme në një zinxhir të hollë.

— Mirë se vini, mirë se vini — tha ai dhe zgjati dorën e mufatur. Nënja ia zuri dorën, e vuri në buzë dhe pastaj në ballë.

— Të keqen, baba, — thosh ajo — t'u bëfsha kurban, si ke qenë, baba. — Zëri i dilte i butë e i vuajtur dhe mua m'u duk prapë sikur shihja një gjyshe tjetër. Babai m'u afrua mua. Ndjeva të më kaplonte një ankth i çuditshëm.

— Nipi ky, ë? — pyeti babai. — Si je, mor bir i babait? — Ai zgjati dorën drejt meje. Sytë i mbaja poshtë dhe pa dashje vura re se ai kishte mbathur ca heqla të qëndisura. Koka më gumëzhinte «vu, vu».

— Puthi dorën babait, të keqen! — tha nënja dhe më pickoi në krah. Dora e babait po lëkundej para hurdës sime.

— Puthi dorën! — u shtrembërua nënja dhe më pickoi prapë në sup. Më dhembti sa desh thirra. M'u kujtua babai im dhe ç'thoshte ai për këta fetarë. Pastaj s'di si më erdhi dhe zura gishtërinjtë e babait me dorën time të vogël dhe i tunda dy herë lart e poshtë.

— Hë, qerrata, qerrata! — qeshi babai.

Gjyshja më pa me inat dhe diç më tha nëpër dhëmbë.

— Lëre, moj Qamile, lëre, djalë komunisti është ai — dhe qeshi hidhur e si me ironi.

— Të keqen, baba, të paçim sa malet! — belbëzoi nënia.

— A je i fortë si yt atë, — tha babai — ë, kolopuç? — Më lëmoi zverkun e më zuri nga veshët. — Pa të shohim njëherë — tha dhe me hoqi veshët lart. Diçka më kërciti. Unë vura dorën time mbi të tijën.

— Mos, të keqen, — tha nënia — mos e zemëro babanë, ai të do.

Më vinte të thërrisja e ta kafshoja me dhëmbë atë njeri. Inati më bëri të përmbahesha. Kafshova buzët dhe s'bëra gëk. Ai më ngriti lart dhe unë u vara nga veshët në duart e tij. Pastaj ai më lëshoi poshtë dhe qeshi.

— Ohoho, — tha bravo, kolopuç, gjallë yt atë qenke!

Unë s'flisja dhe shihja me inat rrobat e tij me ngjyra. Më vinte të qaja. Veshët më digjnin sikur të m'i kishte rrahur dikush me hithra.

— E po si je, o Qamile? Na harruat fare, na harruat.

— Ç'është ajo që thua, baba, për Haxhi Bektaşin që jo, pu-pu-pu, të paçim sa jeta, baba! — tha nënia.

Babai u ul në shilten pranë oxhakut. Nënia mbështeti gjunjët në cep të shiltes, përpara tij, dhe vuri mbi gjunjë pëllëmbët e saj të dobëta e plot damarë mavi. Nuk di sa ndenjëm ashtu. Erdhën tre-katër nga dervishët e tjerë e u përshëndoshën me nënën. Ata i përulëshin babait dhe, kur iknin, largoheshin praptazi. Babai diç u tha atyre. Kur fliste ai, mjekra i tundej. Dolëm nga oda. Nënia më nduku nga krahu përsëri.

— Edepsëz, — më tha, — e zemërove babanë, dhe ai tha të therin dhe dashin për ty. «Më ka er-



dhur i biri, tha, është njëloj si të vinte i ati». Mos, të keqen nënia, mos, se s'është mirë, këtu të gjithë të duan.

— Jo! — thashë unë.

— Çë, bir? — tha nënia.

— Ikim, hajde ikim, nëne. — Unë e hoqa atë nga fustani.

— Hesht, të thonë! Më turpërove, dëgjon, pu-pu-pu!

Në teqe kishin ardhur dhe pesë a gjashtë njerëz nga fshatrat përreth. Nënia më mori nga dora dhe shkuaam përtej, pas një bregu. Dy dervishë po hiqnin zvarrë nga brirët një dash. Më mbetën sytë atje. Nënia më hoqi për dore.

— Nëneee, — desh klitha — ku do vëmi?

— Po ç'ke, mor, të keqen? Në tyrbe do vëmi, ja tek është.

Ajo ishte si një shtëpi e vogël. Brenda ishin tri si djepe të mëdha. Ishin mbuluar me mëndafsh të verdhë e të gjelbër dhe te koka kishin nga një kandil. Desha t'i prekja me dorë, po m'u ngjall një ndjenjë sikur aty nën atë mëndafsh kishte të vdekur. U hoqa pas me frikë. Binte një erë e rëndë e të zihej fryma. Unë u drodha dhe u mbështeta te nënia.

— Ç'janë këta, nëne? — thashë dhe futa turinjte në palat e fustanit të saj. Atë erën e njohur e të këndshme që ndieja sa herë që bëja kështu, atë erë që unë i thosha «erë e nënes», s'po e gjeja më. Kjo më trembi dhe e tërhoqa nënen nga dera.

— Ç'ke, të keqen? — tha nënia. — Këta janë të shenjta. Hesht, se s'është mirë. — Ajo ra në gjunjë, te koka e njërit prej tyre dhe la ca të holla aty. Pastaj, nga një kamare e vogël, mori një dorë lëndë

bojëkafe, si dhé, ngjeu gishtin në të dhe e futi në gojë Pastaj më zgjati dhe mua.

— Na, haje, të keqen nënia, është syfyr, të shëron nga gjithë të ligat.

— Jo! — thashë unë e hoqa kokën pas. Nënia më futi gishtin në gojë. Ndjeva një shije të pështirë e të athët. Më zuri kolla e zura të pështyja.

— **Pu-pu-pu, — bënte nënia — ç'bën kështu, mor i paudhë, ja Abaz Ali, po këtu është vakëf, mor t'u shoftë, si pështyve këtu?!**

Dolëm jashtë dhe ajo akoma ndukte faqet.

— Ja Abaz Ali, ja Abaz! Ali! — bënte.

Unë isha hutuar fare dhe s'dija ku hidhja këmbët. Befas m'u mblodh një pështjellim i madh e mbytës në gjoks. E ndjeva veten si në një vend të humbur e të shkretë pa njeri pranë, me qenie të errëta e të frikshme që dridheshin e lëviznin përreth. Nënia ishte si e huaj për mua. Ajo nuk e kishte më «erën e nënes». Shpërtheva në të qara me dënesë.

— O nëne, nëne! Ku je? — thirra. — Hajde ikim, ikim! — dhe e hiqja atë për fustani.

— Ç'ke të keqen, korba, ç'ma gjeti djalin, ç'ke, t'u bëftë nënia.

— Ikim, ikim! — thërrisja unë dhe ndjeva të më merreshin mendtë e të zalisesha. Nuk e mbaj mend si e gdhimë atë natë. Më përkëdhelnin Muçoja dhe nënia, më thoshin fjalë të buta e të ëmbla, shikoja si në mjegull rrobat me ngjyra të babait, mishin e pjekur dhe bakllavanë. Të nesërmen ikëm përsëri me kafshët e Muços. Gjithë rrugës nënia s'foli. Më mori përpara në prehër, te pela e bardhë. Unë ndieja përsëri erën e saj.

— Ç'ke, të keqen, — thoshte ajo herë pas here

dhe më puthte — nuk të sjell më nënia. S'do ti, s'të sjell nënia, hə, të keqen!

— As ti mos vish, as ti, nëne.

— Mirë, bir, as nënia s'vjen më. Mirë.

\* \* \*

Tani unë jam rritur e jam bërë burrë. Nënia më duket sikur është po ajo e s'ka ndryshuar fare. Të duket sikur asaj s'i bëjnë gjë vitet. I lexoj këto rradhë dhe e shoh të tulatur e të mallëngjyer. Nënia ime nuk qan. Ajo nuk qan kurrë. Po unë e di se ajo do të fillojë të këndojë tani me vete me «oi, oi». Kështu i këndon ajo gjërat që e mallëngjejnë.

Tani s'ka më baba në teqe. S'ka më as dervishë. Më kujtohet se atë kohë kur ata prenë mjekrat e i hynë punës si të gjithë, nënes i erdhi keq, i mbajti inat dhe babait tim që i foli se bëhej mirë kështu, se ata dembelë e gënjeshtarë kishin qenë gjithë jetën. «Le të punojnë e të hanë me djersën e vet», kishte thënë babai im.

Mua më vjen zor tani të fut fytyrën në palat e fustanit të saj, por më besoni se shumë herë e përmbaj veten me një forcë të madhe për të mos e bërë këtë gjë. E megjithatë unë e di tani se ajo mban erën e saj, «erën e nënes». E di se ajo nuk është më e babait të teqesë, e dervishëve, e atyre qivurëve, mbështjellë me mëndafsh, ku ajri i rëndë të zinte frymën, po tani ajo është vetëm nënia ime.

## B O T Ë

As ai vetë s'e kuptoi pse depërtoi gjer thellë në qenien e tij ajo ndjenjë e lehtë pasigurie dhe pse e përshkoi e i mbështolli të gjitha fijet e ndijimeve filladi i vakët i mërzisë. Ndoshta ngaqë pa gotat e zbrazura mbi tryezë. Ose ndoshta ngaqë koha ishte e keqe dhe era ulërinte sikur imitonte shpirtrat e ligj të botës. Ndoshta ishte kjo e dyta. Shkrimtari Sergej K. kishte mbushur 50 vjeç dhe s'i vinte aspak mirë që, qoftë edhe një element i tillë i natyrës, si era, të kuiste kështu sikur protestonte. U ngrit nga kolltuku i tij i vjetër e i dashur. Pushi i gjatë e i dendur i rrobës së kolltikut, i shtypur nga pesha e tij, u ngrit ngadalë përpjetë. Me këtë kolltuk përherë habiteshin vizitorët. Ata hidhnin monedhën mbi të dhe ishte e vështirë ta gjeje pastaj nën atë shtresë të dendur pushi. Ai shkoi te tryeza dhe shtiu uiski në gotë. Në dhomën e madhe s'kishte njeri. Në divan transistori, i harruar në një stacion të largët të botës, vinte në dukje ekzistencën e tij. Ai piu dhe ndjeu llavën e zjarrtë të pijes t'i zbriste nëpër fyt. Duke vërtitur nëpër mendje grimca pa kuptim, iu duk sikur shikonte të gjitha qelizat e trupit të tij që zgjatnin duart drejt llavës së zjarrtë që derdhej në stomak.

Qelizat iu dukën të tilla siç qenë në ilustrimet humoristike të një libri mbi kromozomet dhe trashëgiminë, që kishte lexuar kohët e fundit. Mori mbi etazher kutinë e gdhendur të llullave dhe vërtiti në duar llullën e madh turke. Në datëlindjet e tij ai pinte gjithmonë me këtë llullë. Ishte një dru i bukur, punuar pastër e me shije. Koka e llullës ngjante vërtetë si çallmë turku. Ai e quante këtë llullë «koka e sulltanit». «Sa mirë është të pish duhan me «kokat e sulltanëve», tha ai dhe, duke thithur tymin e ngrohtë, ndjeu t'i largohej gjithë mërzia. Përrjashta era iu duk qesharake. Bile pati një trill. Ajo bënte «uuu» dhe ai tha: «Ky është sol mazhor, vë bast që është sol mazhor». U ngrit përsëri nga kolltuku dhe lëshoi dorën mbi tastierën e pianos. Akordet u shpërndanë të trembura nëpër dhomë si një tufë zogjsh të përgjumur kur u hedh një gur në fole. «Po, tha ai dhe buzëqeshi, mund të isha bërë kompozitor i madh». Dhe mendja i humbi nëpër një mjegull imagjinate që përshkruante rrugën dhe fatin e tij si kompozitor. Vështrimi pa dashje i mbeti mbi gotat. Kishte shumë gota. Lëngjet e ndryshme të pijeve reflektonin gjithë spektrin e dritës në kristalin e xhamit. Ai i kishte zët njerëzit që linin pije në gotë. «Pija duhet pirë me fund, tha ai, si jeta. Po, tha, si jeta. Jeta është e ashpër, e egër». Ai përulej ndaj atij «mjekërbardhit» të madh për ligjin e seleksionit natyral, por veç këtij ligji ekzistonin dhe ligje të tjera të tmerrshme. «Njeriu është në qendër të një sfere gjigante», mendoi ai. Rrezja e kësaj sfere rritet e rritet që nga lashësia. Në fillim njeriu dinte fare pak nga prodhimi, nga kënaqësitë, nga shkencat. Pastaj gjithmonë e më shumë. Por, sa më i mençur bëhet ai, aq më shumë i rriten dinakëria, veset, shpirti i keq. Është një the-

llim i njëhershëm në pozitivitet dhe negativitet. Ligji më absolut i botës është ligji i simetrisë», mendoi ai. E mira ka si hije gjithmonë të keqen. Kësaj s'i shpëtohet dot. Megjithatë meriton ekzistencën ai që lufton, që e pi me fund gotën. E mendoj veten në qendër të asaj sfere me përmasa kozmike. Sfera iu duk prej qelqi dhe ai ndjeu si po i merrej fryma e përpëlitej si një peshk i pafuqishëm në fund të një akuariumi të zbrazët e tmerrësisht të madh. Shkrimtari Sergej K. u drodh. «Koka e sulltanit» kishte derdhur një pjesë të duhanit të djegur mbi mbajtësen e taketukes. «Unë e kam justifikuar ekzistencën time, tha ai. U bëra shkrimtar i madh dhe bota më nderon. E detyrova unë të më nderojë.» Si për të zhdukur ndjenjën e rëndë të mëparshme, u ngrit dhe shfletoi edhe një herë letrat dhe telegramet e urimit. I lëshoi nga tufa e madhe këto telegrame, kartolina e letra dhe ato ranë me një zhurmë të lehtë mbi kristalin e trashë të tryezës së lartë. E rrëmbeu një duf i brendshëm dhe një kënaqësi e pshore ndjeu t'i shpalosej brenda vetes kur mendoi se nuk binin kartolinat e letrat, por binin vetë ata, dërguesit e tyre. Kjo zhurmë ishte zhurma e tyre; «kaq zhurmë kanë merituar ata, jo më shumë, tha ai. Ju kam mposhtur të gjithë, të gjithë», desh thirri. Ja si binin ata, ai Franc Kiteli dinak e fjalëhelmët, Irzhi Gali, shkrimtari i shquar «folklorizant», kritik i Xhozef Mile, që e luftoi aq shumë në fillim të krijimtarisë së tij duke u përpjekur ta zinte në «leqet e teorive të mjekërmëdhënjeve të shekullit të kaluar», Jan Pollanski etj. «Ku shkoi gjithë ajo urrejtje e tyre? Ku ishte ai ngulm, me të cilin e luftuan? Bota është e më të fortit.» Ja si binin tani të gjithë ata: «...shenjë respekti, Kancelari R»; «...të mëtejshme, Ministri

i...»; «...e jotja Y»; «...zotit dhe shërbëtorëve të tij, Kardinali Hert». Ja si binin të gjithë, shkrimtarë, artistë, burra shteti, kritikë, femra të bukura, klerikë, teoricienë. Ata përuleshin përpara tij. Përuleshin si ato kafshët e zbutura, në sytë e të cilave rrezëllon instinkti i fuqishëm i gjakderdhjes, përpara kamxhikut të zbutësit të tyre. Tufa ishte e madhe. Ai i mori ato të gjitha dhe i lëshoi përsëri mbi kristalin. I mblodhi dhe i lëshoi prapë e prapë. Tufa do të bëhej më e madhe të nesërmen, të pasnesërmen. Kishte akoma të tjera pa ardhur. Ai e imagjinonte kutinë e postës të dera e jashtme e tij se si po mbushej përsëri. Imagjinonte postierin me uniformën e zhubravitur duke hipur e duke zbritur shkallët e vilës së tij dhe ndjeu një gëzim të çuditshëm nga sharjet e postierit për të, sharje që postieri i fabrikonte diku në thellësi të shpirtit. Do të kishte telefonata, vizita të tjera, lajka, njoftime në gazeta, botime të ilustruara. Do të kishte... do të kishte... Shumë gjëra do të kishte për të. Ai kishte triumfuar. Plotësisht. Emrin e tij e shqiptonin gjithë njerëzit e kulturuar të botës. Botuesit dhe kineastët i bënë llastik shtyllat e tyre kurrizore përpara tij. Ishte i kënaqur. Ishte vërtet i kënaqur? Po, po, ishte i kënaqur.» Zhyl Lvoviçi ka grua të bukur, he, ka grua të bukur. Të gjithë e admirojnë. Mirë, le të mburret me të.» Ai kishte si kujtim prej saj dy ditë e dy net të këndshme kur udhëtonin me ekspresin e Jamalburit, tok me premtimet e zjarrta që i kishte bërë ajo për më tej. Ai ishte mospërfillës për të gjitha këto dhe i priste si të natyrshme, bile të rëndomta. Gruaja e zgjuar e Minellës, që çmohej në rrethet artistike për mendimin e guximshëm femëror, i dërgonte letra dashurie. Ajo i kishte kaluar të dyzetat dhe asnjë kozmetikë nuk arrinte

të gënjente syrin e tij tanimë. «Jeta ka vetëm një ideal, ambicionin, tha ai. Nëse nuk i vë ti duart mbi sup tjetrit për të dalë nga uji, do të t'i vërë ai ty dhe do të zvarisesh në llumin e verdhë në fund të tij, përzier me gjithfarë ndyrësish. Kurse, nëse del mbi ujë ti që ke një forcë talenti dhe mendje të shëndoshë, edhe të tjerët kanë përfitim. «Ambicioni, tha ai, e vetmja fe, i vetmi ideal.» Shkrimtari Sergej K. ndali para etazherit. Dy radhët e sipërme ishin librat e tij. Këtu ishin botimet e para me vjersha naive e të thjeshta gjer te romanet «e ngjeshura me mendimin filozofik», përkthyer në shumë gjuhë të botës. Pastaj vinin veprat e shkruara për të; këto ishin kryesisht të viteve të fundit. Kjo ishte e gjithë jeta e tij, vuajtjet, shqetësimet, fyerjet, netët me gjumin e copëtuar — si dorëshkrimet e copëtuara — shpenzimet modeste, për të cilat hakmerrej sot me luksin e tij, ëndrrat, lavdia e shumëpritur. Lavdia. «Kështu duhet jetuar jeta, tha ai. Kështu.» Në kujtesën e tij u ngrit Eld Zelmi, ai shoku gjaknxehët i viteve të shkollës, që propagandonte triumfin e ideve shoqërore ku masat hapnin e mbyllnin siparet e tablosë së historisë. Për ca kohë, ata u shoqëruan mjaft me njëri-tjetrin. Eld Zelmi ishte djalë me inteligjencë fine. Dhe Sergej K. çuditej se si ai kishte arritur të mbronte me aq pasion «ide të tilla të dyshimta». Shkrimtari Sergej K. gjithmonë kishte menduar se arti duhet të qëndrojë jashtë jetës politike direkte. Ndoshta ai mund të lidhet me politikën në pika të caktuara, por të ruajë kurdoherë pavarësinë e tij. Kjo qe pikëpamja e tij, megjithëse në situata të ndryshme, ai edhe nuk e kishte theksuar shumë këtë gjë. Atëherë ishin të rinj. Eld Zelmin e mbante mend për herë të fundit kur ai e kishte goditur me



grusht dhe Sergej K. kaq kohë qe djegur nga dëshira për t'ia kthyer atë grusht. Më vonë kjo dëshirë iu fashit. Eld Zelmi ishte vrarë diku në gadishullin e Vandergolsit. Në atë kohë atje shkuan të luftonin mjaft vullnetarë. «E ç'fitoi ai? Idetë që mbronte, u bënë vërtet të modës, dallgëzuan botën, por, dhe në s'kanë vdekur, dikur do të vdesin, kurse vetë ai... Ai mund të bëhej një artist i madh me atë sensibilitet të shkëlqyeshëm që kishte. Kështu është tha ai. Jeta duhet jetuar pikërisht kështu. 50 vjeç. Një gjysmë shekull të bujshëm e plot potere.» Rrugët kishin parë shumë katafalkë dhe shtëpitë e lindjes kishin ndër shumë klithma fëmijësh. Mos e kishte mbaruar jetën e tij ai? Në botimet e antologjive, përmbledhjeve, në veprat kritike, krahas ose nën emrin e tij, Sergej K., midis dy kllapave ishte viti i lindjes së tij. Pastaj një vizë. Pastaj një hapësirë e bardhë bosh. Ç'shifër do të shënohej aty? Ndjeu të rrëqethej së brendshmi. Hapësira e bardhë po rritej e po rritej. Ajo po depërtonte nëpër porët e tij, nëpër udhëzat e gjakut dhe fijet e bardha të nervave. Deshi ta largonte, por s'mundi. Përpara kishte rritjen vigane të asaj hapësire të bardhë. Vetja iu duk në bardhësitë e pafund të polit dhe duart iu ftohën. «Mjaft, mjaft!» thirri dhe përplasi grushthin mbi anën e kolltukut. U ngrit dhe maramendthi shkoi drejt tryezës së pijeve. Hodhi uiski në gotë. «Jam i lodhur, tha. Duhet të vete diku për pushime.» Piu uiski dhe përpara syve i kaluan vendet e bukura të pushimit. Atij i kishte pëlqyer hoteli alpin i Xherit, vilat luksoze të bregut të Kilburnit, ajri i pastër dhe freskia e fushave në Lepotnje. Ishte vjeshtë dhe stina bjonde kishte hedhur mbi këto vende tani buzëqeshjen e saj prej femre melankolike. I lindi

një ide: «Po sikur të shkoj në fshat?» Kishte mjaft vite që s'kishte qenë në fshatin e tij të lindjes, ndoshta 20 vjet, ndoshta më shumë. Iu kujtua fëminia e tij. «Do të shkoj në fshat, tha. Po u mërzhita, kthehem shpejt dhe shkoj në Runfeld», shtoi pastaj si për t'i mbushur mendjen një pjese të vetvetes që akoma s'kishte vendosur. «Jam i lodhur, tha, jam tmerrësisht i lodhur.» Jashtë era akoma bënte «uuu». «Tani është re minor, tha ai, vë bast që është re minor.»



Shkrimtari Sergej K. u zgjua me një ndjenjë të këndshme në shpirt. Muskujt e trupit i kishte të lehtësuar dhe kyçet s'i dhembnin më. Hapi dritaren dhe qimet e gjoksit iu kreshpëruan. Ajri i mëngjesit vërshoi në dhomë. Dhoma ishte e vogël, por e pastër, e lyster tani së fundi. Jashtë, pemëve sapo kishte nisur t'u binin gjethet. Përtej, një pllajë me hurma dukej sikur kishte marrë flakë. Mbi degët e atyre drurëve gjethet hidhnin një purpur mahnitës. Ky ishte fshati i tij i lindjes. Kishte shumë kujtime aty. Por tani ai kishte mbushur 50 vjeç dhe dinte t'i zotëronte emocionet. Xhamet e «Villkës» së tij luksoze, të lënë në oborr, shkëlqenin nga vesa. Ai kishte hedhur mbi të një mushama të murrme. Dy ditët e para fëmijët u vërtitën rreth veturës dhe pastaj u ambientuan me të. Dita ishte e qetë, me një diell të ngrohtë. Ndi-heshin cicërimat e zogjve dhe vinte një erë plehu. Ai u pa në pasqyrë. Për thinjat një grua i kishte thënë se, sikur të donte t'i shiste, të gjitha femrat do t'ia blinin më shtrenjt se argjendin. Ai qeshi. Nxori veglat e rrojes dhe shkumoi fytyrën. Mendjen akoma

e kishte te kapituajt e fundit të romanit të ri. Megjithëse ia kishte ndaluar vetes çdo punë këto kohë, prapë kthehej e kthehej në zgjidhjen e romanit. Kritiku Lopez kishte lexuar tre kapituj dhe kishte mbetur pa gojë një copë herë. Pastaj kishte thënë: «A e di, ndoshta njerëzit e kanë shpikur zotin vetëm për të thënë: «O zot!» Ja, dhe unë tani dua të thërres: «O zot! Kjo është mahnitëse, Serxh!» Shkrimtari Sergej K. ishte mësuar me gjëra të tilla, por kishte qeshur se i pëlqeu shprehja e Lopezit. Qe i sigurt për efektin e librit të vet. «Arti është hipnozë, i tha ai vetes, një hipnozë e ëmbël që depërton te njerëzit nëpër gjithë porët e tyre, si heliumi i lëngët në rastin e superpërcjellshmërisë.» «Jeta» rridhte në fjalitë dhe faqet e librave të tij dhe njerëzit të gjithë ngrinin, si në një botë vakuumi. Rrjedhës së jetës ai i vendoste projektorë e drita në vende që të tjerët nuk i dinin dhe merrej kështu një tablo çuditërisht mahnitëse, me imazhe e spektra fantastikë. «Kryesorja është të mos i bësh ata të arsyetojnë, vetëm t'i shtangësh, t'i mahnitësh. Kështu ata do të mendojnë për shumë gjëra dhe mendimi rezultat do të jetë zero. Le të habiten. Habia është mendimi memec. Njerëzit janë specie e çuditshme. Ata kanë aftësinë e analizës së mëvonshme ndaj ngjarjeve të mëparshme, por ngjarjet janë kaq të shumëllojta, sa që ata përsëri i marrin për të reja, duke mos qenë të tilla në esencë. Dhe ata gabojnë. Pastaj prapë e bëjnë drejt analizën e tyre, prapë gabojnë e kështu me radhë. Kjo është historia e botës, asgjë tjetër. Në mesjetë, një farë Kaliostro, me fuqinë e hipnozës tërhiqte mbretër e qeveri për hunde. Njerëzit alkoolin ndoshta e kanë shpikur në një kohë me artin. Kishin nevojë për të. Kjo është nevoja e dehjes. Alkooli është

një mjet tepër vulgar, arti, mjeti më modern. Ky është qëllimi i tij. Sepse natyra i ka dhënë imagjinatën njeriut, fatkeqësinë e tij të madhe. Sado të arrijë ai, sado të fuqizohet, dora e imagjinatës zgjatet më larg se konkretja. Ja pse ai e dëshiron dehjen. Këtu pak a shumë duhet të përfundojë romani. Mos mendo më për të tani.» i tha vetes shkrimtari Sergej K., ke ardhur për pushime. «Fshiu faqet e saporruara dhe i erdhi mirë të kalonte shpinën e dorës mbi butësinë e tyre të ngrohtë. Dera e dhomës kërciti.

— Mirëmëngjes! — tha Sergej K.

— Mirëmëngjes, Seshka! — tha plaka që hapi derën. — Të ta sjell mëngjesin, apo vjen poshtë?

— Faleminderit, teto, sille këtu, më mirë.

— Ja, ta sjell tetoja tani, mirë fjete?

— Mirë.

— Fshat këtu, more bir, fshat.

— Ëhë! — bëri Sergej K.

Tetoja plakë doli dhe pas pak solli mëngjesin mbi një tabaka, mbuluar me napë të bardhë. Shkrimtari Sergej K. nuk kishte oreks të mirë. Ai nisi të hante. I kishte thënë plakut të vjetër Tokmaç që ta priste për të luajtur një lojë damë. Plaku Tokmaç ishte shumë i vjetër. Kishte kohë që kishte mbushur 100 vjeç. Ai e mbante mend plakun që kur vetë ishte fëmijë; ja, ai ishte po kështu, me mustaqet e thinjura dhe kokën e shogët, të fshehur nën shapkë. Plaku Tokmaç lozte mirë damë. Kjo ishte një lojë dame mongole. Plaku Tokmaç kishte emër edhe në fshatrat rrotull si lojtar i zoti. Tregonin se dhe gjyshërit e tij e kishin luajtur mirë dhe kishin qenë me nam në krahinë. Një stërgjyshi i tij thoshin se kishte luajtur me vetë Çingis Khanin. Atë kohë mongolët kishin

vërshuar si llavë e papërmbajtur drejt perëndimit. Plaku flokëbardhë e mundi shumë herë Khanin e madh të stepave mbi shiltet e çadrës së tij të madhe. Qe përpjekur Khani ta mposhtte qoftë dhe një herë, po s'kishte mundur. Atëherë i kishte thënë:

«— O plak, ti je edhe i mençur shumë, se s'paske shokë në lodër, edhe trim i krisur, se asnjëherë s'më le të të mund. Mençuria dhe trimëria kurrë s'duhet të shkojnë tok te njeriu. Vetëm një njeri, o plak, ai që sundon botën, duhet t'i ketë të dyja. Zgjidh e merr pra, o me njërën, o me tjetrën. O do të të verboj që të humbasësh trimërinë, se trim pa sy nuk ka, o do të jap urdhër të ta vënë kokën në kllapa e të ta shtrëngojnë, gjersa të kthehesh në një budalla jargavitës. Zgjidh, o plak!

— O Khan i madh, — i kishte thënë plaku këmbardhë — të dyja ato që the ti, njeriut të ndershëm i kanë hije t'i ketë tok. Ti asnjë nga ato s'e ke të vërtetë, o Khan. Sa për mua, unë i dua o të dyja, o asnjë.»

Khani mizor u ra pëllëmbëve dhe pas pak koka e përgjakur e plakut u rrokullis para shilteve prej kadifeje. Nga gryka e prerë gurgullonte gjaku dhe dilnin ca tinguj të ngjirur: «Ngh, ngh, ngh.» Thoshin se Çingis Khani, me kafkën e plakut, dha urdhër t'i bënin një palë gurë me shpresë se do të ishte i pamundshëm me to. Por njëherë atij iu faneps sikur gurët e damës bënin: «Ngh, ngh, ngh» dhe që ajo ditë kurrë s'luajti damë. Kështu thoshte ngjarja që tregonin. Shkrimtari Sergej K. e kishte dëgjuar që fëmijë këtë. Atëherë plaku Tokmaç u mësonte fëmijëve damën. Kur u rritën disi, ata loznin me të. Plaku Tokmaç i mundte të gjithë djemtë e rinj të fshatit. Shkrimtarit Sergej K. i kujtohej mirë ajo dëshira

e marrë që e përvëlonte për ta mundur atë plak ironik e vështrimtallës. Plaku Tokmaç djemtë e tjerë i linte ta mundnin ndonjëherë më të rrallë, por atë kurrë s'e kishte lënë. Ai i mendoi këto dhe i erdhi për të qeshur. I erdhi për të qeshur ndoshta edhe nga mendimi se plaku Tokmaç ishte i vetmi që ai kishte dashur ta mundte, por kurrë s'e kishte mundur, qoftë dhe në një fushë dame, qesharake në lidhje me fushën e gjelbër të artit e të letërsisë. «Plaku Tokmaç është plakur shumë tani, tha shkrimtari Sergej K., e kanë lënë mendtë dhe, ndoshta, kushdo mund ta mundë tani.» Ai hodhi një pulovër krahëve dhe doli në rruqën kryesore të fshatit. Thithte llullën dhe ndiente se si e shikonin me bisht të syrit vajzat e reja, mbledhur aty mënjanë.

— Mirëmëngjes, o plak! — tha shkrimtari Sergej K.

— Mirëmëngjes, batjushka! — tha plaku Tokmaç.

— Mos më thuaj batjushka, o plak!

— Mirë, o bir, si të duash ti. Lozim brenda, apo jashtë?

— Lozim jashtë, më mirë, ja aty, nën pemët.

— Çupë! — thirri plaku Tokmaç. — Pa sill një robë ta shtrojmë, hë më paç uratën. — Mbesa hyri me vrap brenda.

— Ti do më mundësh tani, o bir, unë jam plakur shumë, ti, thonë, je bërë i zoti, merr rrogë të madhe. Sa rrogë merr?

— S'i le një herë këto, o plak, gjithë jetën një-lluj mbete.

— Qysh the, o bir? Nga ky i majti s'dëgjoj gjë hiç.

— Sipas meritës, thashë, ai që është më i zoti, merr më shumë.

— Po, po, mirë e ke, ja, ju të zotët t'ju çojnë në Hënë a gjetkë ku s'ka njerëz. Kush do t'i këndojë ato që shkruan, ë? Ç'zotësizeza është ajo pa njerëz?!

Shkrimtari Sergej K. qeshi. «Shumë po e zgjat ky plak, tha. Pse, vallë, s'i kam pëlqyer kurrë unë atij?»

Ata vunë kutinë e damës nën mollët e kopshtit. Shkrimtari Sergej K. mori një nga gurët dhe e afroi ta shihte mirë. Iu kujtua ajo historia e lashtë e Çingis Khanit.

— Janë zaje lumi, — tha plaku Tokmaç — ca të bardhë, ca të verdhë. M'i mbledhin nipërit.

Ata vunë gurët e nisën të loznin

Plaku Tokmaç e mundi shkrimtarin Sergej K. Vunë gurët prapë. Plaku Tokmaç mori në dorë «kokën e sulltanit».

— Hej, ç'dru, — tha — ç'dru i bukur është ky, demiragaç i vërtetë! Kështu i thonë këtij druri. Rritet në pyjet e Gjolikirit.

— Mbushe e pije një me të. — tha shkrimtari — pihet mirë.

Plaku Tokmaç e afroi te hunda, pastaj e la mënjane.

— Jo, — tha — kam timen. — Nxori llullën e tij të përzhitur. — Dëgjo, batjushka...

— Mos më thuaj batjushka, o plak!

— Si të duash, o bir... Që ta paçë fjalën, llulla kurrë s'parfumoset, s'shkon duhani me parfumin, jooo!

Një copë herë ata heshtën me sy mbërthyer në tabelën e lojës. Shkrimtari Sergej K. ndjeu t'i rrihte fort një damar në qafë. «Ky është plak i çmendur, tha, unë duhet ta mund. Pastaj do të tallem me të.» Shkrimtari «hëngri» një gur.

— S'e lojte mirë, o bir, — tha plaku — ai gur nuk hahej. Ti gjithnjë makut ke qenë. Kur zinit peshq në lumë, kur ishit cërrakë, t'i gjithnjë doje të merrje më shumë se shokët, kur i ndanit. Eh, eh. dhe ti ai që ke qenë, je.

Plaku tundi kokën dhe mustaqet e bardha iu shkundën si dy copa dëbore e shkrifët.

«Po unë zhytesha më shumë se të tjerët.» tha me vete shkrimtari **Sergej K.**

**Plaku e mundi përsëri. Luajtën prapë dhe prapë e mundi.** «Ky është një plak i çmendur,» tha shkrimtari **Sergej K.**, çmenduria nganjëherë karakterizohet me bllokimin e shumë qendrave nervore dhe me hiperaktivizimin e disa të tjerave.» Një valë e nxehtë filloi t'i ngjitej përpjetë gjoksit shkrimtarit **Sergej K.** Ai prapë solli ndër mend atë etje dhe pasion titanik që e gllabëronte dikur në rini për ta mundur këtë plak të shogët. Sa e urryer i bëhej kjo fytyrë përballë tij, kjo fytyrë, çarë nga plugjet e viteve, këta sy si të shpëlarë e me një pamje të papërcaktuar. kur plaku **Tokmaç** i lëshonte ato shigjetat helmngjyera të ironisë. Ishte po e njëjta gjë dhe tani. «Por unë tani jam njeri i madh i botës», desh thirri shkrimtari **Sergej K.** Por s'është e thënë që t'i të jesh i parë në gjëra të tilla kaq pa rëndësi, tha një pjesë e trurit diku brenda tij. Unë duhet ta mund patjetër, e mbyti atë zë të pakët ulërime e brendshme. duhet ta mund patjetër. Ai nguli vështrimin në katrorët e lojës. Ndiante ca rrahje të shurdhra kudo brenda. I dukej sikur zemra e tij godiste dhe atje, në qafë, në pulpa, në kyçe. Iu duk sikur katrorët po zmadhoheshin. Sikur kishte qytete dhe njerëz aty, pa fytyrat që binin me tufën e letrave të urimit. Plaku **Tokmaç** këndonte një këngë me zë të zvargët. Kën-



donte mbyturazi dhe fjalët s'i merreshin vesh. Shkrimtari Sergej K. zuri të djersitej.

— E ç'të kam bërë, o plak Tokmaç, që më urren?  
— e shpërtheu me zë mendimin ai.

Plaku e la këngën dhe e pa drejt.

— Hiçgjë, o bir, ç'do t'i bësh ti një plaku të gjorë si unë? Po të bëje keq, s'do lodhesha të lozja me ty. Nuk ke bërë keq ti, jooo, se s'ke qenë i zoti as të bësh keq. Ke qenë vetëm një smirëzi e hiç. Iriqi gjambat i ka jashtë, ti i ke brenda. Popullin dhe njerëzit kurrë s'i ke vënë në hesap. Ja, kështu.

Shkrimtari Sergej K. u ra gurëve.

— Plak matuf! — thirri ai. — Plak i çmendur i mesjetës!

Plaku Tokmaç mblidhte gurët e këndonte me zërin e tij të shuar. Shkrimtari Sergej K. u drodh dhe iu morën mendtë. Ai s'kishte zemër. Zemra e tij po i shpërndahej, po i grimcohej. Ai e ndiente atë të rrihte në çdo skaj të trupit, në çdo qelizë. Ajo bënte një zhurmë të tmerrshme. Ajo bënte «bum, bum, bum». Po e shponin miliona gjilpëra. Jo, ishin gjemba. «Janë gjemba e iriqit, tha. Po ç'do iriqi këtu? Oho, iriqi, po.» Qelizat zgjatnin ca tentakula të çuditshme. Ato ishin të uritura. Ato po hanin njëra-tjetrën, po hanin mendimet e tij. Fusha e bardhë e trurit kishte mbetur e zbrazët. Oh, mendimi i tij! Ç'ishte kështu kjo fushë e bardhë? Sytë iu lbyrën nga bardhësia. Nën emrin e tij, Sergej K., vihej një kllapë, pastaj një vizë, pastaj një vend i bardhë. Dikush shënonte një shifër dhe mbyllte kllapën.

— Mos, — thirri ai i llahtaritur — mos e mbyll!

— E po, s'do të lozim gjithë ditën, de — tha plaku Tokmaç dhe u ngrit duke rënkuar.

Shkrimtarit Sergej K. iu drodh toka. U mbajt te trangu dhe u ngrit.

— Batjushka, harrove llullën, dëgjon?

Shkrimtari Sergej K. nuk dëgjonte. Ai thoshte ca fjalë nëpër dhëmbë dhe sytë i ishin zbutur. Ecte me zigzage në rrugën kryesore dhe linte pas një dallgë pluhuri. «Koka e sultanit» ishte rrëzuar mënjarië mbi bar. Plaku Tokmaç shikonte möllët e këndontë atë këngën e tij.

## PASQYRA E LËNDËS

Shërbimi në N. . . . .	3
Heroikisht . . . . .	8
Yzeiri . . . . .	14
Çast lufte . . . . .	19
Tingujt e natës së bardhë . . . . .	25
Hartimi i maturës . . . . .	31
Roja e dashurisë së madhe . . . . .	37
Miniatura . . . . .	40
Roma zdroma . . . . .	58
Vajza me pantallona vishnje . . . . .	63
Shoferi . . . . .	68
Kënga . . . . .	74
Natë në hotelin malor . . . . .	79
Në oqean . . . . .	85
Homo Sapiens . . . . .	90
Era e nënës . . . . .	99
Botë . . . . .	108